

Begzad BALIU
Onomastikë dhe identitet

Prof.asc.dr. Begzad BALIU
Onomastikë dhe identitet

Recensues
Prof. dr. Bahtijar Kryeziu

Shtëpia botuese ***Era***, Prishtinë, 2012

*Botimin e këtij libri e ka përkrahur Drejtoria për Kulturë e
Komunës së Prishtinës*

Begzad BALIU

**ONOMASTIKË
DHE
IDENTITET**

Era

Prishtinë, 2012

Bardhës, Erës, Enit,
fëmijëve të mi!

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE E RECENSUESIT.....	11
HYRJE	15

I

ONOMASTIKA E KOSOVËS - NDËRMJET MITEVE DHE IDENTITEVE.....	19
I. 1. Onomastika si fat	19
I. 2. Onomastika dhe origjina e shqiptarëve.....	21
I. 3. Onomastika dhe politika	24
II. 1. Etnonimi kosovar.....	27
II. 2. Ruajtja e homogjenitetit	29
II. 3. Toponimi Kosovë dhe etnonimi kosovar	30
III. 1. Konteksti shqiptaro-sllav i toponimisë.....	35
III. 2. Ndeshja: struktura e toponimisë.....	36
III. 3. Struktura shumështrësore e toponimisë së Kosovës	39
III. 4. Konteksti	40
III. 5. Standardizimi i toponimisë dhe gjuha.....	43
III. 6. Standardizimi i toponimisë - goditja më e fuqishme e mitit serb ndaj Kosovës.....	44

IV. 1. Antroponimia - një luftë tjetër për Kosovën dhe identitetin shqiptar.....	47
IV.2. Paradigma toponimike e antroponimeve	49
V. Përfundime	60
L i t e r a t u r a.....	62
EMRI I DARDANISË NË STUDIMET GJUHËSORE TË PROFESOR ÇABEJT	65
Historia.....	67
Aspekti gjuhësor	72
Emri i Dardanisë dhe fisi i pirustëve.....	81
The name of Dardania.....	86
SHQIPËRIA, KOSOVA DHE GJUHA SHQIPE NË BOTIMET ENCIKLOPEDIKE	88
Hyrje.....	89
Shqipëria	91
Kosova	93
Gjuha shqipe	101
Në vend të përfundimit.....	107
POLITIKA E STANDARDIZIMIT TË TOPONIMISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR	110
(Political standardization of toponymy in the Western Balkans)	110
Hyrje.....	110
GJENDJA E TOPONIMISË NË GREQI.....	113
Toponimia me theks në Çamëri	113
GJENDJA E TOPONIMISË NË SERBI.....	116
Toponimia si trashëgimi kishtarë dhe shpirtërore mesjetare	116
Përpjekja e dështuar shtetërore.....	120
GJENDJA E TOPONIMISË NË KOSOVË.....	123

Struktura e toponimisë	123
Demitizimi i toponimisë së Kosovës	125
Struktura shumështrësore e toponimisë së Kosovës	127
GJENDJA E TOPONIMISË NË MAQEDONI.....	129
Standardizimi i toponimisë në ish-Jugosllavi dhe prova e parë në Maqedoni.....	129
GJENDJA E TOPONIMISË NË AREALIN SHQIPTAR TË MALIT TË ZI.....	130
GJENDJA E TOPONIMISË NË SHQIPËRI.....	132
Standardizimi gjatë sistemit komunist	132
Literatura	135
Summary	140

HOMOGENITETI KOMBËTAR I ONOMASTIKËS SË ARBERESHËVE Të ITALISË (Pikëpamjet e Eqrem Çabejt).....	142
Përkushtimi i përhershëm.....	142
Historia.....	146
Veçoritë gjuhësore dhe historike të emrave të arbëreshëve në Greqi dhe Itali.....	155
Përfundim.....	165
National homogeneity of the onomastics of arberesh of Italy (According to Eqrem Çabej's viewpoint)	166

II

NJË KONTRIBUT I VEÇANTË PËR STUDIMET ONOMASTIKE SHQIPTARE.....	170
KËRKIME NË ONOMASTIKËN E GJEOGRAFISË ANËSORE TË SHQIPES	182
FITONIMIA DHE ZONIMIA E DUSHKAJËS.....	199

III

BAZA EPIKE E LETËRSISË SHQIPE DHE LIRIZMI I VONUAR I SAJ.....	208
POEZIA: PËRMASA, SHENJA DHE KUFIJ ONOMASTIKË	221
POEZIA SI PËRJETIM HISTORIK DHE ESTETIK.....	229

PARATHËNIE E RECENSUESIT

Hullitë e mbara të studiuesve tanë të parë të onomastikës, (që nga gjysma e dytë e shekullit XIX, me mbledhësin e pasionuar të folklorit shqiptar, Thimi Mitko: Shih, *Alvaniki Melissa*, Aleksandri, 1878), për fat të mirë po ndiqen nga një numër i mirë studiuesish tanë, siç është rasti edhe me veprën e gatitur për shtyp të Prof.asoc.dr. Begzad Baliut *Onomastikë dhe identitet*.

Vepra *Onomastikë dhe identitet* që së shpejti do të shohë dritën e botimit, me korpusin e lëndës onomastike, të dhe jashtë Shqipërisë londineze, pa dyshim se përbën një kontribut të çmuar në fushën e albanologjisë në përgjithësi e të onomastikës në veçanti.

Lënda e veprës *Onomastikë dhe identitet*, e qëmtuar me pasion dhe profesionalizëm të dalluar nga dr. Begzad Baliu, mbështetur në një literaturë të veçantë - ajo e gjuhësisë – onomastikës, ka vlera të larta historike, linguistike, kulturore, e përtej kësaj edhe politike, duke mbajtur parasysh se *çka, si dhe përse* e ofron lëndën e përzgjedhur ai. Me këtë vepër autori u jep studiuesve të fushave të ndryshme filologjike e sidomos atyre të fushës së onomastikës, edhe një mjet tjetër pune, me të dhëna shumë të

rëndësishme, një lëndë të vlefshme që mund të plotësojë, në një masë të mirë mungesën e asaj, që në shumë segmente, ka munguar deri sot. Vlerën dhe rëndësinë e veprës, padyshim se e shton dhe e bën edhe më të madhe edhe fakti se është vepër e rrallë e kësaj natyre ndër ne dhe jo vetëm ndër ne, për nga këndvështrimet që kap.

Veprës i prinë një *Hyrje* e shkurtër, por shumë përmbledhëse e autorit, ku ai spikat vlerat dhe rëndësinë që ka kjo vepër për pasurimin e literaturës albanologjike edhe me një botim të ri në shkencat filologjike në përgjithësi e të onomastikës në veçanti.

Botimi i kësaj vepre, që përfshin rreth 250 faqe teksti, i ndarë në tre krerë "është vazhdim i veprave, studimeve dhe teksteve të tjera në fushë të onomastikës, botuar në Tiranë, Prishtinë, Tetovë, Shkup dhe në qendra të tjera shkencore europiane, që merren me studime në fushë të albanologjisë dhe ballkanologjisë. Tekstet e këtij vëllimi janë shkruar për arsye të ndryshme: konferenca shkencore, projekte shkencore, parathënie veprash në fushë të onomastikës, recensione për përrurime apo për botime, por në të gjitha rastet ato ruajnë dimensionin e kërkimit toponimik apo antroponimik" – gjejmë të ketë thënë autori. "Në tërësinë e tyre, vazhdon Baliu, ato janë sinteza të përgjithësuara të dijes së gjertanishme (kërkimet historike), sinteza të arritjeve personale..., apo pasqyrim i disa prej veprave të botuara kohëve të fundit brenda dijes së onomastikës. Një kapitull më vete paraqesin tekstet në fushë të letërsisë, të cilat pavarësisht qasjes dhe

vlerësimit estetik, në esencë ato mbështeten... kryesisht në përbërësit onomastikë të tyre”.

Nga ajo që shihet në vepër, del se autori, me një ngulmim sfillitës dhe njëherësh sakrifikues ka ndërtuar edhe një mënyrë vetjake, si të thuash, të trajtimit dhe zbërthimit të topoleksemave të ndryshme, duke mbajtur parasysh se hulumtuesi në përgjithësi duhet t`u vërë mendjen si duhet të dhënave të ofruara, për të arritur në përfundime të suksesshme në punën e vet. Këtë parim drejtimdhënës, që e kishte ngritur prej kohësh patriarku i albanologjisë, Prof. Eqrem Çabej, e ka realizuar në mënyrë të shkëlqyer në këtë vepër edhe dr. Begzad Baliu.

Nga e gjithë kjo që u tha më lart, shprehim opinionin tonë se vepra *Onomastikë dhe identitet* përbën një punë të vyer, të kujdesshme dhe me rëndësi për gjuhësinë shqiptare dhe onomastikën. Ajo dëshmon për ecurinë rritëse e pjekurinë e plotë shkencore të autorit, po edhe një tregues të gëzueshëm të kaheve serioze, gjithmonë e më të epërme që po marrin studimet shkencore në Kosovë nga studiues të mirëfilltë e të pasionuar, siç është edhe dr. Baliu.

Shih, për këto dhe arsye dhe të tjera, të cilat nuk u përmendën këtu, ana metodologjike dhe teknike e hartimit të veprës (besojmë se një radhë tjetër do të bëjmë një shkrim më gjithëpërfshirës analitiko-sintetik të saj), me bindje të thellë pohojmë se kjo vepër meriton të zë vendin e saj në vitrinat e çdo studiuesi, pa dallim nga fusha me të cilën merret ai.

Në fund të këtij shkrimi të shkurtër, nuk na mbetet gjë tjetër pos autorit të kësaj vepre t'i urojmë me gjithë zemër botimin edhe të veprave të tjera si dhe shëndet e vullnet për punë kësodore.

Gjilan, 28 korrik 2012

Prof. dr. Bahtijar Kryeziu

HYRJJE

Vëllimi *Onomastikë dhe identitet* është vazhdim i veprave, studimeve dhe teksteve të tjera në fushë të onomastikës, të cilat i kam botuar në Tiranë, Prishtinë dhe në qendra të tjera shkencore europiane, e që merren me studime në fushë të albanologjisë dhe ballkanistikës. Tekstet e këtij vëllimi janë shkruar për arsye të ndryshme: konferenca shkencore, projekte shkencore, parathënie veprash në fushë të onomastikës, recensione për përrurime apo për botime, por në të gjitha rastet ato ruajnë dimensionin e kërkimit toponimik apo antroponimik. Në tërësinë e tyre ato janë sinteza të përgjithësuar të dijes së gjertanishme (kërkimet historike), sinteza të arritjeve personale (paraqitje e arritjeve tona), apo pasqyrim i disa prej veprave të botuara kohëve të fundit brenda dijes së onomastikës. Një kapitull më vete paraqesin tekstet në fushë të letërsisë, të cilat pavarësisht qasjes dhe vlerësimit estetik, në esencë ato

mbështeten kryesisht në përbërësit onomastikë të tyre. Në fund është sjellë kronika e një konference shkencore kushtuar gjendjes së studimeve onomastike në hapësirën shqiptare.

Prej kërkimeve të gjertanishme në fushë të onomastikës shqiptare, ballkanike dhe madje ndërkombëtare kemi kuptuar se onomastika në asnjë mënyrë nuk ka qenë indiferente ndaj zhvillimeve të gjertanishme shkencore, politike, strategjike dhe madje qytetëruese. Kemi kuptuar gjithashtu se roli i toponimisë ka qenë mjaft i ndjeshëm edhe në përcaktimin e kufijve ndëretnikë me fqinjët tanë, ndërsa nuk kemi mundur të qëndrojmë anash as në lidhje me antroponiminë e rrëgjuar shqiptare të fundit të shekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI.

Onomastikën shqiptare (toponiminë dhe antroponiminë) e kanë ndjekur gjithanshëm fatet e historisë së popullit shqiptar. Nuk janë të pakta rastet kur toponimia shqiptare (emrat e maleve, grykave, qyteteve, vendbanimeve përgjithësisht, të lumenjve si dhe objektet materiale e shpirtërore që përfaqësojnë ato) është sulmuar me mite dhe trajta të ndryshme gjuhësore, shumë më parë se sa të jetë sulmuar me armë dhe me mjete të tjera, populli dhe vendbanimet etnike shqiptare. Po kështu ndodhi edhe me pasojat që rrodhën pas këtyre sulmeve e pushtimeve

shekullore. A nuk u godit toponimia e Kosovës nga serbët në fillim të shekullit XX para se të pushtohej në vitin 1913? A nuk u ndërrua toponimia e Çamërisë menjëherë pas shpopullzimit të saj? A nuk u desh një shekull lufte e brendshme për të krijuar një standard në sistemin e antroponimisë shqiptare pas ndarjes nga Perandoria Osmane? A është kjo një prej arsyeve pse dy dekadat e fundit kemi paraqitur disa herë shqetësimet tona për emrat e rinj të fëmijëve tanë dhe pagëzimin e tyre e kemi quajtur sulm të vrazhdë në identitetin tonë!

Kjo vepër, kur drejtpërdrejt e kur tërthorazi, përpiket të shquajë disa tema të mëdha apo më të vogla, që më parë se sa të onomastikës shqiptare, në të vërtetë janë të qytetërimit shqiptar. Si e tillë, shpresojmë të plotësojë në shkallë modeste kërkesat e lexuesit të sotëm në fushë të onomastikës, duke filluar nga rëndësia e saj për historinë e vendit e të popullit shqiptar, deri te ndikimi i saj në letërsinë artistike.

Duke qenë njëkohësisht vëllim studimesh të shkruara për konferenca shkencore kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, në shumë drejtime sjell edhe vlerësime dhe rezultate të botuara dhe të diskutuara edhe në veprat e mia të mëparshme, prandaj edhe këtu botohen duke e ruajtur qasjen

teknike dhe metodologjike të tyre në botimet e këtyre konferencave: vëllimin, strukturën, modelin e bibliografisë etj .

Durrës, korrik 2012

Autori

ONOMASTIKA E KOSOVËS - NDËRMJET MITEVE DHE IDENTITEVE

I. 1. Onomastika si fat

Ballkani, si me historinë ashtu edhe me gjuhësinë paraqet një pasuri të madhe dhe shumështrësore të Europës Juglindore. Më parë sesa mikrostrukturat e tij, problemin e inventarizimit të toponimisë të tij dhe rrjedhëve të saj, në këtë proveniencë të Europës, e paraqet vetë emri i tij: Gadishulli Ilirik, Gadishulli Helenik, Rumelia, Ballkani, Europa Juglindore dhe tash së fundi një tendencë e re për ndarjen e tij: Ballkani Perëndimor, brenda të cilit hyn edhe areali etnolinguistik e kulturor shqiptar.

Hapësirën ballkanike e përshkon një traditë e pasur dhe e thellë kulturore e gjuhësore: trashëgimia paraindoeuropiane, trashëgimia e familjeve gjuhësore indoeuropiane dhe joindoeuropiane; një shtresim i pasur kulturash të shfaqura më shumë se askund, në toponiminë ilire, thrake, helene, romake, sase, shqiptare, sllave, arumune, turke etj., por edhe një

areal gjuhësor i përbashkët i strukturës gramatikore, i njohur në gjuhësinë e përgjithshme si gjuhësi ballkanike.

Sot, vështirë të gjenden në hapësirën e globit shtresime kaq të shumta e të thella kulturore brenda një tërësie gjeografike, sikur i gjejmë në Ballkan. Vështirë të gjendet një hapësirë kaq e vogël, e cila ka pranuar dhe ka rrezatuar një kulturë kaq të pasur në Europë, në Azi e më tej. Në këtë reflektim, toponimia ka shënuar gjurmët më të thella dhe më të pasura. Toponimia pasqyron shenjat më të sigurta të zhvillimeve historike jo vetëm në arealin historik, gjuhësor e kulturor të Ballkanit, por edhe në arealin gjuhësor, historik e kulturor të Europës e të Azisë.

Është e kuptueshme prandaj, pse ka shumë kohë që studimi i onomastikës, përkatësisht i toponimisë, paraqet një prej problemeve të shpeshta dhe shumë interesante në rrethet shkencore ballkanike dhe europiane. Prandaj, toponimia është bërë fushë e kërkimeve të shkollave dhe e drejtimeve më bashkëkohore të kohës; ajo është bërë sinonim i kërkimeve historike, gjuhësore, kulturore dhe madje të vetë prejardhjes së një populli a të një tjetri në Ballkan; ajo është bërë mjet i caktimit të kufijve të përshtirjes historike të popujve në këtë rajon në shekujt më të errët të historisë.

Por, në Ballkan si ndoshta askund tjetër, toponimia jo njëherë ka qenë shenjë e (ri)krijimit të miteve të vjetra dhe e konflikteve të reja nacionale. Sikur të mos mjaftonte trashëgimia sa e pasur po aq edhe e errët etimologjikut, toponimia e Ballkanit

disa herë, këta dy shekujt e fundit, e në vazhdimësi edhe sot, vazhdon të mbështillet me shtresa mitesh bashkëkohore.

1. 2. Onomastika dhe origjina e shqiptarëve

Njëra prej fushave më komplekse të filologjisë, onomastika, ka më shumë se një shekull që është bërë temë studimi më vete në gjuhësinë europiane në përgjithësi dhe gjuhësinë shqiptare në veçanti.

Studiuesit e huaj dhe shqiptarë, përmes kërkimeve onomastik, kanë hulumtuar:

➤ substratin, superstratin dhe adstratin e popujve dhe të lëvizjes së tyre përgjatë historisë nga Lindja në Perëndim;

➤ kulturat, zanafillën e etnive dhe gjurmët e tjera kulturore të popujve të zhdukur gjatë “përmytjeve” të ndryshme historike, para së gjithash të atyre popujve, për të cilët deri me tani kanë munguar dokumentet e shkruara etj., ndërsa gjuhësia shqiptare, përmes onomastikës, ka zbuluar në detaje më të veçanta nga ç’dihej më parë, praninë e paraardhësve të popullit shqiptar në Ballkan dhe në Europë;

➤ nënshtresën paraindoeuropiane të ilirishtes dhe mbishtresat e ndikimeve të huaja në kulturën shqiptare;

➤ shtrirjen gjeografike të Ilirisë në hapësirën e Europës Juglindore dhe Europës Qendrore;

➤ vendin e formimit të etnisë së Arbrit në trojet e sotme ku jetojnë shqiptarët;

➤ prerjet kulturore, fetare e historike të brendshme e të jashtme të hapësirës etnike shqiptare etj.

Në shekullin XIX, studiuesit kryesisht të huaj, duke u mbështetur në strukturën fonologjike e gramatikore, e vendosën gjuhën shqipe në drurin gjenealogjik të gjuhëve indoeuropiane, ndërsa në shekullin XX, shumë studiues të huaj dhe studiues shqiptarë, duke u mbështetur në onomastikën e trojeve shqiptare e më gjerë, përcaktuan prejardhjen e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, sidomos me fillimin e përhapjes së tezës së prejardhjes ilire të popullit shqiptar e të gjuhës shqipe. Gjatë kësaj periudhe, rilindësit, bartësit e vetëdijes kulturore dhe kombëtare të shqiptarëve, e paraqisnin popullin shqiptar si pasardhës të pellazgëve. Mirëpo, pas formimit të disa brezave studiuesish në shkollat europiane dhe pas krijimit të bërthamave shkencore albanologjike në Tiranë e në Prishtinë, këto qendra u bënë zëdhënëset më të flakta të prejardhjes ilire të shqiptarëve, ndërsa fusha e onomastikës ishte njëra prej tregueseve kryesore për arritjen e këtyre rezultateve.

Gjatë dekadës së gjashtë e të shtatë të shekullit XX, kur panilirizmi i studimeve europiane filloi të zbehej, prejardhja ilire e popullit shqiptar dhe e gjuhës shqipe ishte miniera e vetme në të cilën gjurmonin të gjithë studiuesit shqiptarë të gjuhësisë, arkeologjisë, historisë, etnografisë, hartografisë etj.

Treguesit më të lartë të këtij orientimi të shkencës albanologjike janë Konferencat albanologjike (1965, 1968), simpoziumi “Onomastika e Kosovës” (1979), konferenca “Shqiptarët dhe trojet e tyre”, vepra e Eqrem Çabejt “Studime etimologjike në fushë të shqipes” etj.

Ndryshe nga studiuesit e Europës Qendrore dhe Perëndimore, pjesa më e madhe e shkencëtarëve serbë, maqedonas, bullgarë e rusë, ndaj onomastikës iliro-shqiptare kanë mbajtur qëndrime shpesh johistorike, joshkencore dhe madje ekstralinguistike. Metodologjia e kërkimeve të tyre ishte metodologji e koncepteve të kushtëzuara e të ideologjizuara, ndërsa prirjet e tyre ishin më shumë politike dhe shtetërore. Kërkimet, studimet dhe rezultatet e tyre vetjake dhe të organizuara në trojet shqiptare që nga Jovan Cvijiqi, Selishqevi, Atanasie Urosheviq, Milica Gërkoviq, Jovan Ristiqi etj., tubimet shkencore si *Iliri i Albanci, Serbia i albanci kraj XIX veka*, të organizuara nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Serbisë, kanë pasur rrjedhoja krejtësisht politike për fatin kombëtar-historik të shqiptarëve. Prandaj, është e kuptueshme që simpoziumi shkencor *Slovensko porijekla stanovništvo u Albaniji*, mbajtur në Cetinë më 1990, pati sjellë me kohë shqetësime mes studiuesve shqiptarë. Në parim, reagimet mbështeteshin në faktin se organizimi ishte bërë nga akademitë e vijës fundamentaliste ortodokse: Cetinë – Beograd – Shkup – Sofje – Moskë, ndërsa në të njëjtën kohë shtypi shqiptar dhe institucionet shkencore vazhdonin të heshtnin para rezultateve tendencioze të tyre, të

cilat nuk dallonin nga qëllimet politike, që shumë herë ia kishin vënë vetes individët, grupet, institucionet dhe politikat shtetërore serbe. Artikulimin e kërkimeve të tyre, ata e përmblihdnin në këto teza:

➤ prejardhja joilire e shqiptarëve dhe joautoktonia e tyre në trojet e sotme etnike dhe shtetërore;

➤ vënia në dyshim e pranisë së shqiptarëve në trojet e sotme, madje edhe më gjerë, para ardhjes së sllavëve në Gadishullin Ilirik;

➤ prania e etnosit sllav në trojet e djeshme e të sotme shqiptare në një masë shumë herë më të madhe nga sa paraqitet realisht në dokumentet historike;

➤ teza për formimin e popullit shqiptar në mesjetë: “mbi bazën e mbeturinave të vogla të popujve” etj.

1. 3. Onomastika dhe politika

Mbi këto paradigma, për fat të keq është formuar edhe qëndrimi i fqinjëve tanë ndaj onomastikës së trojeve shqiptare. Qëndrimi i tyre natyrisht ishte politik, ekstralinguistik, johistorik dhe me pretendime pushtuese.

a) Pushtetarët e Serbisë, në fund të shekullit XIX, pasi shpërngulën me dhunë popullsinë shqiptare të mbi 640 vendbanime nga Sanxhaku i Nishit, toponiminë e kësaj hapësire e ndryshuan plotësisht, ndërsa shqiptarët e mbetur në kufijtë e Kosovës së

sotme, deri më 1945 krejtësisht dhe pas vitit 1945 pjesërisht, në patronimin e tyre u detyruan të marrin prapashtesat sllave *-iç*, *-viç* etj.

b) Në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në gjysmën e parë të shekullit XX, Greqia i ndërroi toponimet e trojeve të pushtuara shqiptare, ndërsa banorëve shqiptarë dhunshëm ua ndërroi emrat dhe llagapet etnike e fetare (myslimane e katolike), duke ua kthyer në emra greko-bizantinë. Greqia, djepi i lindjes së kuptimit të demokracisë, edhe gjatë këtyre viteve të fundit vazhdon të bëjë etnocid mbi shqiptarët, vazhdon të bëjë krime mbi të drejtën universale të njerëzimit: të mbajtjes së emrit vetjak. Ajo vazhdon të bëjë krime mbi kulturën njerëzore duke u ndërrua emrat shqiptarëve të besimit mysliman, katolik dhe ortodoks, për t'i kthyer në emra kombëtarë grekë ose të ritit greko-bizantin, si kusht i domosdoshëm për t'u dhënë një vizë për punë të përkohshme. Dhe jo vetëm kaq. Politika shtetërore, kulturore dhe shkencore e Greqisë ka vënë në sprovë të ashtuquajturin toponim dhe etnonim *vorio-epirot*, i cili përfshin troje të shtetit shqiptar dhe toka të shtetit të sotëm grek!

c) Në Maqedoni, deri në fillim të këtij shekulli, shqiptarëve nuk u lejohej të përdornin toponimet sipas veçorive gjuhësore të tyre. Në administratën maqedonase të pushtetit të djeshëm, emrat e qyteteve: *Shkup*, *Tetovë*, *Ohër*, *Kërçovë*, *Dibër*, *Manastir* etj., duhej të shkruheshin dhe të shqiptoheshin vetëm sipas veçorive gjuhësore të gjuhës maqedonase: *Skopje*, *Tetovo*, *Ohrid*, *Kiçevo*,

Debar, Bitola etj. Madje, në kryeqytetin e Maqedonisë – Shkup, për të cilin demografët thonë se është qyteti me popullsinë më të madhe në botë me origjinë shqiptare, vetëm një rrugë mbante emrin e një shqiptareje, emrin e Nënës Tereze.

d) I mësuar nga simotrat e tij Serbia, Maqedonia e Greqia, edhe Mali i Zi nuk qëndron fare mbrapa këtyre qasjeve. Në administratën shtetërore të Malit të Zi, toponimi *Krythë* shënohet *Krute*, emri i fshatit *Milla Katund* shënohet *Mide*, *Katërkolla: Vlladimir* (që është patronimi i Jovan Vlladimitrit), *Sukubina* : *Sukobin*, *Shtegvasha* : *Podstegllah*, *Gjonikaj* : *Gjeçbitriq*, *Kështenja* : *Koshtanjica*, emërtimi *Thtjan (Ftjan)* : *Tejani*, *Liarja* : *Livari*, *Selca* : *Seoce*, *Trieshi (Triepshi)* : *Zatrijebaç*, *Nënhelmi* : *Podhum* etj. Këtu prapashtesat sllave *-iç* e *-viç* te patronimet e shqiptarëve janë edhe më të pranishme se sa në hapësirat e tjera të shqiptare në ish -Jugosllavi.

e) Po kaq e rëndë ishte edhe gjendja e onomastikës në Kosovën e ripushtuar nga Serbia. Gjatë shekullit XX, pavarësisht nga sistemet politike nëpër të cilat kemi kaluar, disa herë është ndërruar pamja e onomastikonit të vendbanimeve të Kosovës: emrat e qyteteve, të krahinave, të hidronimeve, si dhe vetë emri i Kosovës. Kështu, në administratën e dhunshme serbe, oikonimi *Hani i Elezit* shënohej me emrin e *Gjeneral Jankoviqit*, *Ferizaji* : *Uroshevac*, emri i qytetit të *Suharekës*: *Suwareka*, makrotoponimi *Llapushë* : *Prekorupë*, ndërsa dhjetëra vendbanime të reja, të ndërtuara për kolonët e sjellë nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi e Serbia, janë

emërtuar mbi motive historiko-mitike serbe, edhe pse mikrotoponimia e asaj hapësire gjeografike nuk jepte bazë të mjaftueshme për emërtime të këtilla.

Edhe aty ku administrata e dhunshme serbe nuk kishte vënë dorë mbi toponiminë e Kosovës rrjedhojat kanë qenë po kaq të rënda. Alfabeti cirilik i serbëve nuk kishte grafi gjuhësore të mjaftueshme për të mbuluar grafinë e gjuhës shqipe, andaj onomastika në dokumentet zyrtare serbe ishte krejtësisht e shtrembëruar dhe e rrënuar në aspektin drejtshkrimor, drejtshqiptimor dhe kuptimor, pasojat e të cilave i ndejmë edhe sot në dokumentet e reja, me të cilat pajisemi në shtetin e Republikës së Kosovës.

II. 1. Etnonimi kosovar

Megjithëse në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* njësia *etnonim* nuk ekziston, shpjegimi për të është bërë në njësinë *etnik*: “që lidhet me një popull a me një komb të caktuar dhe me kulturën materiale e shpirtërore të tij. Grup etnik. Kufi etnik. Emër etnik. Përkatësi etnike”¹. *Fjalori* i Rikard Simeonit, këtë njësi, e ka saktësuar më për së afërmi, për të mos thënë në nivelin që na ndihmon edhe neve. *Etnik*: “emër për emrin e banorëve të një vendbanimi, zone, vendi ose shteti, p.sh., *zagrebas*, është etnik nga *Zagrebi...*”². Pavarësisht nga kjo, në studimet shqiptare etnonimi zbritet edhe në shkallë krahinore.

¹ *Fjalori*, 1980, 437.

² Simeon, 1969, 325.

Në fjalorët enciklopedikë të gjuhësisë së përgjithshme etnonimi zbret edhe në nivel vendbanimesh (qytetesh), sigurisht të rëndësishme. Në Kosovë, modeli i përcaktimit të etnonimisë në shkallën e traditës popullore, besoj, është mënyra më e mirë e përcaktimit të toponimeve gjatë historisë. Tradita popullore ka zgjedhur së paku tri rrugë në përcaktimin e këtij elementi:

a) Rruga e parë duket të jetë më e moçmja dhe duket të ketë funksionuar edhe pa vlerën shkencore që i jepet sot si mekanizëm i brendshëm. Bie fjala, gratë e martuara në një vendbanim tjetër, kryesisht në zonën e Rrafshit të Dukagjinit, vendasit i quajnë ('thërrasin') në emër të prejardhjes së vendbanimit (fshatit), krahinës ose fisit të tyre, pavarësisht prej krijimit të përkatësisë së etnikumit në shkallë fshati, krahine ose fisi që mund të kishte.

b) Shprehjes së përkatësisë etnike me përcaktimin krahinor: rugovas, dukagjinas, llapjan etj.

c) Me përcaktimin e qytetarisë, pra të qytetit, të cilit i ka takuar, veçse kjo nuk ka pasur vlerë për të gjitha qytetet. Fjala është për etnonimet e ndërtuara sipas qyteteve të vjetra dhe me etimologji shqipe: *gjakovar*, *pejan*, *prishtinas*, *ferizajas*, *gjilanas*, *prizrenas* etj., krahas të cilave tradita njih edhe trajtat me prapashtesa nga orienti: *prishtinali*, *gjakovali*, *ferizajli*, *gilanli*, *prizrenali* etj.; por jo edhe *podujevas*, *kamenicas*, *gllogovcas* etj. Në raste të tilla, tradita popullore ka ruajtur si përcaktues etnik vlerën krahinore: *llapjan*, *moravali*, *drenicali* etj. Shembull plotësues për një dukuri të tillë janë edhe patronimet:

Gjinolli (Prishtinë, Gjilan); *Gjilani* (Tiranë); *Peja* (Pejë, Gjakovë); *Gjakova* (Gjakovë, Prishtinë, Gjilan), por jo edhe *Kamenica*, *Podujeva*, *Glogovci* etj.

II. 2. Ruajtja e homogjenitetit

Në historinë e onomastikës shqiptare në veçanti dhe në historinë e onomastikës së përbotshme në përgjithësi ruhet një strukturë mjaft homogjene, jo vetëm e antroponimeve por edhe e toponimeve. Më në fund, është thënë edhe më parë se “emrat me të cilët njerëzit emërtojnë rrethinën e tyre paraqesin burimin e vetëm të informatave mbi historinë e një shoqërie, besimeve (religjioneve) dhe vlerave të saj”³. Tradita euro-amerikane ka shënuar disa raste, shembuj të mirë të rikrijimit të sistemeve toponimike nga njëri vend në tjetrin, madje nga njëri kontinent në tjetrin: *Paris*, *Memfis*, *Troja*, *Hertford* dhe *Londër* në Amerikë.

Shqiptarët asnjëherë nuk e kanë ndërprerë bartjen e emrave vetjakë (patronimeve) dhe toponimeve të mjedisit të tyre, kudo që ata shtegtonin brenda trojeve shqiptare dhe kudo që ata shtegtonin ose dëboheshin drejt Perëndimit dhe Lindjes. Përsëritja e toponimeve brenda trojeve shqiptare dhe sidomos në kolonitë e tyre të reja është një realitet që dëshmon për një rregull të caktuar që është krijuar gjatë historisë edhe brenda traditës historike të onomastikës shqiptare.

³ Kristal, 1997, 114.

Le të kujtojmë këtu bartjen e toponimeve e patronimeve shqipe në mesjetë nga shtegtarët shqiptarë në More të Greqisë dhe më vonë në Italinë Jugore ose në të dyja anët nga i njëjti burim. Po kështu ka ndodhur edhe gjatë Krizës Lindore kur shqiptarët u dëbuan nga trojet e tyre etnike, pra nga Sanxhaku i Nishit në Kosovë dhe në Turqi, ku janë përtërirë dhe ruajtur jo vetëm qindra e qindra antroponime, por edhe qindra toponime dhe po kaq antroponime, të cilat janë toponomizuar apo patronomizuar.

II. 3. Toponimi Kosovë dhe etnonimi kosovar

Emri i *Kosovës* si toponim dhe emri *kosovar* si etnonim janë dy elemente onomastike që do të mund të diskutoheshin jo vetëm duke iu qasur nga aspekti gjuhësor e historik, por edhe nga aspekti semasiologjik, etno-kulturor, politik, diplomatik, motivues etj. Le t'i shohim një herë emërtimet: *Kosovë* si toponim dhe *kosovar* si etnonim. *Kosovë*: emër historik për territorin jo aq të përcaktuar të Dardanisë antike; emër i Krahinës së Kosovës nën regjimin e Serbisë dhe të Jugosllavisë; emri i Kosovës deri më 17 shkurt 2008; emri i sotëm i Republikës së Kosovës; *Mala Kosova (Kosova e Vogël)*, emër i një pjese të Kosovës që kap kryesisht krahinën e Llapit dhe një pjesë të Rrafshit të Kosovës; *Kosova i Metohija*: trajtë e emërtimit të administratës serbe, gati, gjatë gjithë shekullit XX.

Ndryshe ndodh ndërkaq me rrafshin historik dhe gjeografik të etnonimit kosovar. *Kosovar*: etnonim,

njëri prej etnonimeve shqiptare: dibran, mirditor, shkodran, llapjan etj., (në shumë këngë shqipe të Kosovës, thuhet “Jam shqiptar, kosovar”); përcaktues i popullatës shqiptare në territoret e ish-Jugosllavisë nga nënshtetasit shqiptarë të Shqipërisë londineze; etnonim i përbashkët për të gjitha etnitë që jetonin brenda Kosovës nga regjimi i ish-Jugosllavisë; përcaktues etnik për vetveten nga shqiptarët e Kosovës së dëbuar dhe të vendosur me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare në shtetet e treta, për t’u dalluar nga emri shqiptar (*albanian*), të cilin nuk e pranonte administrata ndërkombëtare; cilësor i administratës ndërkombëtare të UNMIK-ut e tash edhe EULEX-it, për të gjitha etnitë që jetojnë në Kosovë, megjithëse edhe ky nuk është stabilizuar plotësisht.

Këtyre dukurive motivuese i është nënshtruar gjatë kësaj kohe edhe vetë etnonimi kosovar. Nëse shikojmë rrugëtimin historik të tij, etnonimi kosovar, deri në fillim të shekullit XX, ka mundur të barazohet me etnonimet e krahinave etnografike: *gegë, toskë, çam, drenicas, labriot, dukagjinas, rugovas, gallapas, llapjan* etj., por pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe pushtimit të Kosovës nga shteti serb, etnonimi kosovar nga shqiptarët e Shqipërisë së lirë ka përfshirë banorët shqiptarë të mbetur nën ombrellën e mbretërisë serbo-kroato-slllovene që quhej Jugosllavi. Po për këta, ky etnonim ka vazhduar të mbulojë të gjithë shqiptarët deri në fund të këtij shekulli edhe nga politika shtetërore shqiptare.

Ndryshe nga shqiptarët e Shqipërisë në kufijtë shtetërorë-politikë, shqiptarët e pushtuar nga sllavët e kanë quajtur veten e tyre para se gjithash shqiptar dhe rrallë herë *kosovar*, vetëm për atë pjesë të popullatës që ka jetuar brenda kufijve të Kosovës, ndërsa sllavofolësit shqiptarët i kanë quajtur me emrin e vjetër *arbanas* ose edhe *shiftari* e *shiptari* (pezhorativë) dhe *albanci*, në të gjitha rastet në shkallë të administratës shtetërore e në publicistikën vendore.

Në shkrimet gazetareske dhe në fjalorin diplomatik të Europës, etnonimi *kosovar* filloi të përdorej nga të huajt për shqiptarët që migruan në vitet '90 të shekullit XX nga Kosova, mbase më shumë për t'i dalluar nga emigracioni po kaq vërshtues nga Shqipëria.

Tradita gojore shqipe e ka sintagmën “shqiptar - kosovar” dhe anasjelltas: “jam shqiptar e kosovar” thotë rapsodi, mbase një shprehje e traditës, e ruajtur si “italo - arbëror” dhe “italo-shqiptar”. E ndihmuar edhe prej një ndërhyrjeje politike, pas vitit 1981, në traditën gojore emri *malësor* në shumë raste erdhi e u bë sinonim i emrit *shqiptar*. Këngëtari ynë popullor, në momente të vështira të sforcimit të regjimit, në shumë raste edhe toponimin Shqipëri e zëvendësonte me *Malësi*. Kjo trajtë, megjithëse jo në administratë, përdorej në bisedimet e përditshme edhe brenda qarqeve politike e shkencore serbe⁴.

⁴ Një drejtues i Bibliotekës Universitare të Beogradit, duke më njoftuar për ardhjen e një punëtori të ri në Bibliotekën e

Pas mbarimit të luftës së Kosovës dhe vendosjes së administratës ndërkombëtare, disa të ashtuquajtur teoricienë të kombit kosovar, morën nismën edhe për përkufizimin e tij.

Pavarësisht nga historia, shqiptarët në Kosovë duhet të krijojnë konceptin e tyre rreth etnonimit kosovar, sepse kam përshtypjen që etnonimi kosovar ka filluar të konceptohet nga ndërkombëtarët si një emërtim që deri dje mbulonte konceptin për etnonimin jugosllav, dhe mbulonte të gjitha etnitë e ish-Jugosllavisë. Në pasqyrën e regjistrimit të vitit 1972 u krijua një rubrikë e veçantë në kuadër të të gjitha etniteteve: sllovenë, kroatë, malazezë, shqiptarë, maqedonas, jugosllavë, serbë, hungarezë etj. Teoricienët e krijimit të kombit kosovar, jo rrallë janë nisur nga konceptet çintegruese në shkallë kombëtare, të dala dhe të reklamuar shumë në këto dhjetë vjetët e fundit për gegët dhe toskët, për Veriun dhe Jugun e Shqipërisë etj., prandaj është e kuptueshme pse mendimet e tyre janë pritur me reagime, me ftohtësi dhe madje me frikë!

Një gjë ndërkaq është më se e vërtetë. Sot edhe analistët që merren me studimin e çështjes shqiptare dhe ballkanike guxojnë të thonë se “një komb i ri po lind”. Kjo dëshmon se, brenda strukturës së këtyre

albanologjisë, në vitin 1985 më thoshte: “Kemi pranuar një punëtor nga Mali i Zi, por ai është *malësor* e jo *cërnogorac!*”, me çka më jepte të nënkuptoja se, megjithëse punëtori i bibliotekës ishte nga Mali i Zi, ai nuk ishte me kombësi malazeze, por shqiptare.

grupimeve shqiptare, sot nxisin, kontribuojnë dhe lobojnë edhe një numër i caktuar i të huajve.

Le t'i përjashtojmë në parim komentet për anën historike, politike dhe padrejtësitë që trashëguam. Le të fokusohemi vetëm në gjendjen e sotme. Kosova sot është një shtet i ri, i cili po ndërtohet në proporcion të zhdrejtë me lëvizjen tonë historike. Dhe me vjen keq që edhe ne vazhdojmë t'i kontribuojmë ndërtimit të kësaj strukture të përkundërt edhe nga aspekti akademik, në kohën kur prej nesh pritej një kontribut tjetër: ndërtimi i shtetit të Kosovës dhe rilindja shpirtërore e kombit shqiptar. Përkundrazi, po investohet shumë për ndërtimin e një kombi të ri: kombit kosovar.

Por le ta gjykojmë këtë çështje këtu vetëm nga aspekti gjuhësor. Pavarësisht nga mendimet tona për etimologjinë e toponimit Kosovë, bota shkencore emrin e Kosovës e konsideron me etimologji sllave, ndërsa ne bëjmë atë që dhunshëm është bërë nën ish-Jugosllavi. Po e ndërtojmë identitetin tonë të ri (kosovar) mbi një etimologji sllave!

A ka nevojë të mendohemi gjatë se si do të na gjykojnë pasardhësit nesër. Paraardhësit tanë na e lanë mbi kurriz një shtet sllav, ndërsa ne po ju lëmë pasardhësve në ndërdije një identitet me të cilin nuk shquhen saktë se cilët janë!

Për ne tashmë shtrohet nevoja e diskutimit të kësaj çështjeje me vetëdije kritike për të djeshmen dhe të sotmen, si dhe me vetëdije historike për të ardhmen. Për fat të keq, diskutimet e gjertashme,

përgjithësisht, nuk e kanë kaluar pikëpamjen për vetëdijen krahinore krahinore të tyre.

III. 1. Konteksti shqiptaro-sllav i toponimisë

Në toponiminë shqiptare sfidë më vete ka qenë, është dhe do të jetë konflikti shqiptaro-serb. Po bëhen disa shekuj që populli shqiptar dhe ai serb janë në një konflikt të përhershëm: historik, politik, kulturor, fetar, etnopsikologjik dhe madje gjuhësor. Ky konflikt i dy fqinjëve shekullorë ndeshet në disa rrafshet kulturore, në disa pika gjeografike dhe madje në disa shenja kontekstuale. Ndeshen prandaj edhe te ojkonimi *Nish (Naissus)*, e hidronimi *Moravë*. Ndeshen edhe në *Rrafshin e Kosovës*, rrëzë *Alpeve Shqiptare* (një toponim i literaturës europiane për ballkanologjinë), ndërkohë që ky oronim i traditës popullore, *Bjeshkët e Nemuna*, respektivisht përkthimi sllav *Prokletie*, një referencë tipike për luftën e tyre, vazhdon t'iu qëndrojë mbi kokë, si një e keqe e përhershme edhe për prejardhjen kuptimore të saj.

Më parë se themelet shekullore të kështjellave e faltoreve (kishat, xhamitë, teqetë) dhe përgjithësisht objektet e kultit, më parë sesa urat, përmendoret, reliktet e vjetra, mozaikët e muranave, si dhe shpellat e legjendat e tyre, konflikti është ndërtuar mbi emërtimin e tyre. Ky konflikt shkon e sforcohet mbi emërtimin e moçëm dhe shpjegimin më parë popullor se sa shkencor të tyre.

Kërkimet e gjertashme shkencore në fushë të toponimisë brenda kufijve të sotëm të Kosovës dhe në kontekst të kufijve historikë, të cilat i janë përshkruar *Dardanisë antike*, dëshmojnë për një numër të madh shtresash gjuhësore të saj, studimi i të cilave krijon pasqyrën më të saktë të lëvizjes së kulturave gjuhësore, etnografike e historike, si shenjat më përmbajtësore të identifikuara historikisht nga literatura greke e romake dhe nga mbetjet arkeologjike, të cilat vazhdojnë të nxjerrin krye edhe në ditët e sotme⁵.

III. 2. Ndeshja: struktura e toponimisë

E parë si makrostrukturë socio-gjuhësore dhe historike, toponimia e Kosovës dhe Dardanisë përbëhet nga tri paradigma: etnike, e motivuar dhe në kontekst; ndërsa e definuar si mikrostrukturë (përgjithësisht e thelluar gjuhësore), kjo toponimi përfshin një areal më të gjerë (historik dhe gjuhësor) dhe një numër të rëndësishëm shtresash gjuhësore mbi të cilat është strukturuar etimologjia e saj. Pra, në fondin e përgjithshëm të toponimisë së Kosovës, dhe më gjerë Dardanisë, në dy shekujt e fundit, si rezultat i ndërtimit të koncepteve nacionalromantike janë përplasur dy areale gjuhësore, kulturore dhe madje

⁵ Për studimet etno-linguistike dhe sidomos për kërkimet në fushë të toponimisë së Kosovës nga studiuesit shqiptarë dhe serbë, shih referencat e komentuara në librin *Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan*, oEra», Prishtinë, 2004, f. 75-158.

etnopsikologjike: ajo shqiptare dhe ajo sllave, në mes të të cilave qëndron dhe një shtresë tjetër: kontekstuale.

Fondi i moçëm i trashëgimisë iliro-shqiptare, si: *Llap, Gallap, Ulpianë, Therandë, Dardanë, Sharr, Vendenis, Bardosanë, Lumbardh, Naissus, Siparant, Margus, Bardarium, Scup* etj., është ndeshur me mitin e rikonstruktuar të fondit sllav të toponimisë së mesjetës: *Lazarevo, Miloševo, Obilič, Kosovo Polje, Uroševac e Gjeneral Jankovič*, për të cilin, veç 'dëshmive' të romantizmit serb mbi luftën mesjetare të Kosovës, sipas burimeve ekstrashkencore serbe është edhe një këngë që 'dëshmon të vërtetën' e tyre.

Derisa fondi i moçëm i toponimisë shqiptare ubifikohet me shkrime dhe harta të antikitetit greko-romak, fondi serb i mesjetës në Kosovë shtresohet mbi toponiminë e leksikut iliro-shqiptar, roman, sasë a turk të vendbanimeve të kolonizuara me serbë nga Serbia, Mali i Zi, Bosnja e Kroacia⁶. Dhe më tej, derisa fondi i toponimisë iliro-shqiptare homogjenizon konceptet postromantike të shqiptarëve në interes të ruajtjes së trojeve etnografike dhe monumenteve më të lashta materiale dhe shpirtërore të tyre; fondi sllav i rindërtimit të këtyre monumenteve në Kosovë, nuk

⁶ Për vendosjen e kolonëve serbë në Kosovë dhe fushatën e eliminimit të shqiptarëve në forma të ndryshme nga pronat e tyre si dhe shpërnguljen në Turqi, shih, veç tjerash, veprën e Hakif Bajramit, *Rikolonizimi i Kosovës me serbë 1945-1948*, "Era", Prishtinë, 2002.

ishte gjë tjetër veç një relikti i romantizmit serb, i fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Ai është vetëm vazhdim i një përpjekjeje të hershme që kisha serbe, duke shfrytëzuar autonominë e saj gjatë pesë shekujve të Perandorisë Osmane, ka ndërmarrë për mbishtresimin e toponimisë vendore me toponime të prejardhura sllave.

Fondi sllav i këtyre toponimeve me karakter identifikues për etnikumin e tyre ka qenë referenca më tipike e nismës së luftërave të reja shqiptaro-serbe dhe ballkanike, ai ka qenë referencë e homogjenizimit etnik, ndërsa fondi shqiptar i këtyre toponimeve ka qenë referencë e identifikimit të autoktonisë së tyre dhe vlerave etno-historike të kulturës së lashtë gjuhësore. Toponimet monumentale serbe përgjithësisht kanë qenë shenja të kufijve nacionalë, sipas të cilave pushtetet serbe kanë krijuar slloganin „Deri atje ku gjendet një varr serb (e kjo do të thotë një mikrotoponim që identifikon atë varr) atje është Serbia“⁷, ndërsa toponimet monumentale shqiptare janë identifikuar si trashëgimi kombëtare pa pretendimin që ato të identifikohen

⁷ Që nga mesi i viteve '80 e deri në fund të vitit 1999, politika zyrtare e Beogradit, institucionet shkencore në krye me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Serbisë, Lidhja e Shkrimtarëve të Serbisë në të ashtuquajturën *Francuska 7*, institucionet kishtarë të drejtuara nga kryepeshkopi Pavle, partitë opozitare dhe disa nga intelektualë popullistë etj., e kanë shqiptuar dendur dhe gjatë kësaj sllogani, i cili, krahas luftës nacionale, çoi në luftë qytetare dhe republikane gjithë popujt e ish-Jugosllavisë.

njëkohësisht edhe me kufijtë shtetërorë dhe politikë të tyre.

III. 3. Struktura shumështrësore e toponimisë së Kosovës

Një strukturë sa komplekse po aq edhe interesante për kërkimet interdisiplinare përbën shtresa linguistike, e kjo do të thotë shtresa shumëkulturore dhe etnolinguistike e toponimeve, hidronimeve dhe ojkonimeve të Kosovës, përkatësisht Dardanisë antike:

a. Onomastika ilire-shqiptare: *Ulpianë, Qafa e Prushit, Gallap, Sharr, Drin* etj. Tek një shtresë e vonshme në Kosovë ruhet edhe një sistem i pasur i emërtimeve të vendbanimeve me bazë tek emrat e vëllazërive a fiseve të ndryshme: *Isnikaj* (Deçan), *Shkrel* (Pejë), *Gjergjicë e Stakaj* (Drenas), *Kopiliq i Epërm* e *Kopoliq i Poshtëm, Dashevc, Dashec* e *Baks* (Skënderaj), *Balaj, Burrnik* (Ferizaj), *Palabardh, Bardhaniq, Fshaj*. (Gjakovë) etj.

b. Toponimia me bazë nga tradita greko-bizantine: *Glllogjan* (Deçan), *Mavriq, Mihaliq e Pantinë* (Vushtrri), *Manastirc, Papaz e Softaj* (Ferizaj), *Kolludra e Madhe* (Zubin Potok), *Tërpezë* (Viti), *Torinë* (Lypian), *Mojstir, Syne* (Istog), *Likoshan, Vasilevë* (Drenas), *Likoc* (Skënderaj) etj.

c. Toponimia serbe e Kosovës: *Suharekë, Rahovec, Bistricë, Sitnicë, Novosellë* etj.

d. Emërvendet me prejardhje orientale: *Azizi* (emri i vjetër i Milloshevës së Obiliqit), *Hani i Elezit*, *Ballaban e Hajvali* (Prishtinë), *Karaçicë* (Shtimje), *Hamidi* (Obiliq), *Hatmaxha* (Prizren), *Qerim* (Gjakovë) etj.

e. Emërvendet me prejardhje latino-romane: *Makresh* (Gjilan), *Rimanishtë* (Podujevë), *Beçuk* (Vushtrri), *Vllahi* (Mitrovicë), *Sibofc* (Obiliq), *Llukar* (Prishtinë), *Banullë e Magure* (Lipjan), *Turiçec*, *Magure*, *Mikushnicë* (Skënderaj), *Llajshec* (Prishtinë), *Llashticë* (Gjilan), *Llashkadrenoc* (Malishevë) etj.

f. Emërvende me prejardhje nga fisi gjerman i sasëve: *Shashkoc* (Prishtinë), *Shashkoc* (Podujevë), *Sazli* (Ferizaj), *Shashar* (Viti) etj⁸.

Gjithë këtë pasuri gjuhësore, kulturore dhe historike, Kosova do t'ia falë një ditë Europës së re. Kjo është simotra etno-kulturore e antikitetit evropian, një freskë shpirtërore e temave universale të shkrimtarëve të vjetër grekë e romakë, të cilën populli shqiptar e ka ruajtur brenda traditës së tij mijëvjeçare. Kjo ndërkaq, mund të hapë, njëkohësisht, edhe dilemën e përkatësisë shpirtërore të temave të këtyre veprave.

III. 4. Konteksti

Një fond më vete përbën toponimia me paradigmë kontekstuale dhe e rimotivuar ndër shekuj, ku për një

⁸ Baliu, 2000: 71-80. Për parimet e standardizimit të emërvendeve të Kosovës shih edhe Sejdiu, ²⁰⁰² etj.

kohë, në emërtimin e disa vendbanimeve kisha serbe kishte rol të theksuar, ndërsa në kohën tonë kjo veçori ndërtohet edhe mbi paradigma të tjera, si: faktorët natyrorë (pozita gjeografike, përbërja gjeologjike e vendbanimit, prania e rrjedhave ujore etj.), prejardhja patronimike, historia bashkëkohore etj. Shembuj të shumtë dëshmojnë për rimotivimin dhe riemërtimin e vendbanimeve shqiptare gjatë fillimit të shekullit XX nga administrata serbe në kontekst të koncepteve të tyre mitike, politike, historike, kulturore, gjuhësore dhe madje ushtarake. Bie fjala, emri i fshatit *Livragonë* me origjinë greke, nga administrata serbe u rimotivua dhe u rindërtua si *Vragoli*. Kjo krijon dyshimin e bazuar se kështu ishte vepruar edhe më parë me ojkonimet *Vučitrn* nga *Vicianum*, *Lipljane* nga *Lypenon*, etj⁹. Në këtë rrjedhë kërkimesh identifikohen edhe një varg mikrotoponimesh, hidronimesh e ojkonimesh të tjera me rëndësi për standardizimin e toponimisë së Kosovës. Bie fjala, pranë emrit të lumit me etimologji sllave *Bistricë* kontekstualisht e gjejmë fshatin *Lumbardh* dhe hidronimin *Krojet e Bardha*. Pranë objekteve me të cilat në shkallë ndërkombëtare identifikohen sot jo vetëm serbët, por edhe tradita shtetërore dhe kulturore e tyre në Kosovë (kryesisht manastiret) ne gjejmë një traditë të hershme të popullsisë shqiptare të lidhur kryesisht me burime të caktuara, të cilat identifikohen si hidronime: *Pusi Manastirit t'Dragancit*, *Kroni Manastirit* etj., në të cilët vazhdojnë të kryhen

⁹ Për kontekstin në toponiminë e Kosovës, shih sidomos studimet e Sejdiut, ²⁰⁰².

rite të vjetra, (kryesisht) besëtytnie: për shërimin e syve, plleshmërinë e grave, mbrojtjen e fëmijëve etj. Pra, nuk është fjala për tërësinë e toponimisë së Kosovës, fjala është për ojkonimet, hidronimet e oronimet, në emër të të cilave janë kryer një varg veprimesh politike, kulturore, gjuhësore, historike dhe madje ushtarake në Kosovë dhe në rajon gjatë dy shekujve të fundit.

Prandaj, kërkesa e popullit shqiptar në Kosovë në fund të shekullit XX, që disa toponime (kryesisht ojkonime) të ktheheshin në gjendjen e mëparshme ose të rimotivoheshin e standardizoheshin në kontekst të gjuhës, kulturës dhe historisë dhe traditës vendore, nuk ka të bëjë me një lëvizje ultranacionale, përkundrazi, fjala është për një përpjekje të banorëve të këtij vendi për të mënjanuar ato shenja, të cilat historikisht janë bërë sinonim i së keqes, që kanë penguar dhe vazhdojnë të pengojnë proceset kulturore dhe qytetëruese në rajon, që vazhdojnë të bëhen pengesë e ndërlidhjes europiane të këtij rajoni, në të vërtetë, që më parë se të kryejnë funksion thjesht lingvistik të tyre, që në vend se çdo njësi gjuhësore të kuptohet si njësi kulturore¹⁰ siç do të thoshte Çabej, ato janë bërë referenca përmes të të cilave gjykohet historia dhe sidomos e ardhmja e këtyre popujve.

¹⁰ Çabej, 1979: 7.

III. 5. Standardizimi i toponimisë dhe gjuha

Le ta shikojmë këtë çështje në kontekst të standardit të gjuhës. Po të rindërtohej mendimi i studiuesit Dubois për gjuhën standarde, atëherë përpjekja jonë do të mund të përkufizohej “si një formë e gjuhës standarde, ku në një vend të caktuar (këtë herë në Kosovë) përtej varianteve lokale ose shoqërore (në rastin tonë përtej variacioneve lokale, multigjuhësore dhe kulturore), toponimia imponohet në shkallën që të përdoret në mënyrë të zakonshme, si mjeti më i mirë i komunikimit”¹¹. Gjuha standarde anon drejt shuarjes së shmangieve duke imponuar një formë të vetme ndër të gjitha format dialektore”¹², në rastin tonë madje format dialektore, gjuhësore dhe historike të tyre. Në fushën e standardit, ta quajmë kushtimisht të përvojës gjermane¹³, kishim parasysh besoj së paku dy elemente të rëndësishme: legjitimimin historik (te i cili, mbase, më shumë se karakterin gjuhësor, kërkonim mbështetjen politike), realizimin gojor dhe atë të shkruar, të cilat nga aspekti pragmatik, mbështesin më së miri ndërmarrjen tonë për standardizimin e emërvendeve të Kosovës.

Projekti ynë do të kuptohej më së drejti me përkufizimin që Lewandowski i ka bërë standardit të gjuhës gjermane “si gjuhë e komunikimit mbiregjonal,

¹¹ Dubais, et al.: 1973, sipas R. Ismajlit, 1998, 17.

¹² Dubais, et al.: 1973, sipas R. Ismajlit, 1998, 17.

¹³ Bussmann: 1990, sipas R. Ismajlit, 1998, 17, 18.

që ka legjitimitet historik dhe që atë legjitimitet e ka të institucionalizuar, që ka për funksion komunikimin për tërë bashkësinë folëse, që ka norma gojore dhe të shkruara të vendosura përmes traditës, që mësohet në shkolla, e të tjera”¹⁴. Në këtë rrjedhë mund të thuhet se toponimia e standardizuar e Kosovës, e nxitur dhe e ndërtuar mbi një strukturë shumë-shtresore gjuhësore dhe jogjuhësore, siç do të thoshte studiuesi Rexhep Ismajli, “nuk përputhet domosdo me gjuhën letrare, as me gjuhën letrare kombëtare”¹⁵, por ajo, domosdo edhe në këtë rasë, mund të konsiderohet denjësisht e përfshirë brenda strukturës shumë homogjene të onomastikës shqiptare.

III. 6. Standardizimi i toponimisë - goditja më e fuqishme e mitit serb ndaj Kosovës

Përpjekjet e pasluftës se Kosovës për të standardizuar toponiminë, për të rikthyer gjendjen e mëparshme apo për të legjitimuar trajtën tradicionale të saj, janë synimet e bartësve të tyre për ta çliruar hartën e Kosovës nga mitet serbe, një mjet bazë me të cilin populli serb dhe institucionet e tij shtetërore, kulturore e shpirtërore e kanë sulmuar Kosovën. Dhe është e kuptueshme prandaj, pse serbët me këtë akt janë ndier të sulmuar nga shkenca dhe kultura shqiptare. Studiuesit thonë se “kur sulmohet një nga

¹⁴ Lewandowski: 1976, sipas Ismajlit, 1998, 18.

¹⁵ R. Ismajli, 1998, 18.

mitet e një komuniteti, komuniteti në fjalë do ta ndjejë veten të sulmuar, do ta shohë atë si sulm ndaj themeleve të tij, që vë në pikëpyetje ekzistencën e tij". (Përpyekja, 9) Në këtë rast, shkenca shqiptare politikën serbe ndaj Kosovës e ka sulmuar në thelbin e saj. Toponimet serbe të ndërtuara mbi mitet reflektojnë përpyekjet shfarosëse, të cilat edhe më tej gjenerojnë rreziqe të vazhdueshme për banorët e këtij rajoni dhe më gjerë, dhe është e kuptueshme prandaj pse eliminimi i tyre është mënjanim i rreziqeve të vazhdueshme, ndërsa ndërrimi i tyre ose kthimi në gjendjen fillestare paraqet mbylljen e fundme të këtyre burimeve që shkaktojnë kriza të përhershme.

Toponimet serbe të ndërtuara mbi mitin e Luftës së Kosovës (1389) kanë qenë shenjat më agresive përmes së cilave ideologjia serbe e shekullit XIX dhe institucionet shtetërore, kulturore e shpirtërore serbe të shekullit XX, e kanë funksionalizuar atë. Nëse Beteja e Kosovës, në fillim të Lëvizjes romantike serbe të gjysmës së parë të shekullit XIX, ishte një konstrukcion që i shërbente një miti, pas vendosjes së këtyre toponimeve në Kosovë, miti serb i kësaj beteje, mori të gjitha konstrukcionet e një miti nacional në shërbim të një agresioni të vazhdueshëm dhe antihistorik ndaj shqiptarëve. Sikur ndodh gjithmonë me mitet, edhe në këtë rast, ky ishte miti i përvojës kolektive serbe, prandaj duke mënjeluar këtë sistem toponimik Këshilli Shkencor për Standar-

dizimin e Emërvendeve të Kosovës¹⁶ ka kryer një akt të shumëfishtë: ka çmitizuar njërin prej miteve më të rëndësishme të serbëve si kolektivitet, dhe i ka çliruar ata si kolektivitet nga prangat më iracionale të qindvjetëshit të fundit.

Mitet serbe përgjithësisht dhe miti i Luftës së Kosovës veçanërisht e kanë legjitimuar dhunën serbe në Kosovë. A do të arrijnë serbët që tërësinë e miteve të veta ta rrudhin brenda kompleksit të shoqërisë së sotme bashkëkohore, në interes të zgjedhjes jo vetëm të çështjes kombëtare serbe, por edhe të çështjeve kombëtare të të tjerëve në Ballkan?

Nuk e di!

E di, ndërkaq se me këtë veprim Komisioni ka kryer një akt human në ndihmë lëvizjes së këtij

¹⁶ Komisioni për Standardizimin e Emërvendeve të Kosovës: *Shkëlzen Raça*, (kryetar) Drejtoria për Shkencë e Ministrisë së Arsimit në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës; *Shefki Sejdiu*, Fakulteti i Filologjisë; *Ruzhdi Pllana*, Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, Dega e Gjeografisë; *Latif Mulaku*, albanolog; *Rexhep Doçi*, Instituti Albanologjik i Prishtinës; *Sabit Uka*, historian; *Muhamet Pirraku*, Instituti Albanologjik i Prishtinës; *Tefik Basha*, Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, Dega e Gjeografisë; *Ilijaz Rexha*, Fakulteti i Filologjisë; *Isa Bajçinca*, Fakulteti i Filologjisë; *Isak Shema*, Fakulteti i Filologjisë; *Muhamet Shatri*, Instituti i Historisë i Kosovës; *Mehmet Halimi*, Instituti Albanologjik i Prishtinës; *Begzad Baliu*, Instituti Albanologjik i Prishtinës; *Jusuf Osmani*, (sekretar) Arkivi i Kosovës.

procesi demitizues, në interes të përgjithshëm të serbëve si kolektivitet i mitizuar deri në iracionalitet dhe në interes të kolektiviteteve të tjera të Ballkanit¹⁷.

IV. 1. Antroponimia - një luftë tjetër për Kosovën dhe identitetin shqiptar

Zakonisht, në historinë e njerëzimit, luftërat gjithëherë kanë shkaktuar ndryshime të mëdha historike, kulturore, gjuhësore e etnografike të një populli a të një rajoni të caktuar. Ndryshime të mëdha në rirreshtimin e shumë shteteve me ndikim në rajon dhe të koncepteve të tyre me përmasa ndër-kombëtare, ka bërë edhe lufta e Kosovës (1997-1999). Ajo ka sjellë ndryshime të thella në historinë e Kosovës, në aspektin e zhvillimeve të brendshme të saj, dhe përgjithësisht ka sjellë një rrjedhë tjetër të zhvillimeve qytetëruese në rajon. Ky realitet sot shihet edhe në fushë të toponimisë, e cila ka qenë pengu më i madh i këtij qytetërimi për disa shekuj me radhë¹⁸.

Toponimia e Kosovës ishte një prej elementeve kulturore e shpirtërore, e cila menjëherë pas përfundimit të Luftës së UÇK-së (1997-1999) u sforcua si nevojë për rishikim që kërkonte qasje profesionale nga studiues e institucione shkencore.

¹⁷ Baliu, 2001: 18; 2000: 16; 2000: 15-32.

¹⁸ Shih *Regjistri*: 2004.

Është dashur të lindte një institucion, sikur ishte UÇK-ja, që ta projektonte të kaluarën si një vijimësi të pashkëputshme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të asaj fryme që përcaktoi parimet 500-vjeçare të programeve kombëtare dhe rrjedhojave të tyre: që nga Kuvendi i Lezhës e deri te Lidhja e Prizrenit, apo që nga Kryengritjet për Pavarësi të fillimit të shekullit XX, deri te Lufta e UÇK-së. Pra, tërë ky proces i gjatë kishte edhe referencat e tij historike: Luftën e Skënderbeut, si kryengritje nacionale e si reflektim në procesin e civilizimit europian të kohës dhe luftën e UÇK-së, në fund të shekullit XX, që reflektoi përmasën universale të lirisë dhe trokitjen e saj në ndërgjegjen e diplomacisë euro-amerikane. Në këtë mënyrë ajo rindërtoi filozofinë politike të asaj tradite luftarake, e cila gërshetohej prej përbërësve themelorë të mendimit politik të Lëvizjes Kombëtare, prej pritjes që po i bëhej asaj në kancelaritë europiane dhe prej përkrahjes historike që kishte marrë dikur, e priste të merrte edhe më tej nga diplomacia amerikane.

Themeluesit dhe bartësit e saj kishin mësuar prej historisë, se në fillim të shekullit XX politika dhe diplomacia amerikane e drejtuar nga Presidenti Wilson, duke mbrojtur Lëvizjen kryengritëse antiosmane dhe duke përkrahur Lëvizjen Kombëtare proeuropiane, me votën e tij kishte ndihmuar popullin shqiptar për të shpëtuar nga rreziku që i vinte nga fqinjët. Prandaj, ata besonin se dora e fuqishme e Amerikës që në fillim të shekullit XX rrezatonte parimet e demokracisë universale, në fund të këtij shekulli do të dilte me përkushtimin e fjalës edhe të

forcës, në mbrojtje të lirisë dhe demokracisë edhe të popullit të Kosovës.

Gjatë tërë shekullit të kaluar, këto përpjekje mbinjerëzore kaluan nëpër periudha të rënda shpeshherë edhe të vetmisë së madhe. Por dy skajet e shekullit u përshkuan me dy pikëtakime me peshë të jashtëzakonshme. Prej presidentit Wilson (emrin e të cilit e mbajnë shumë fëmijë të Kosovës) në fillim të shekullit XX e deri tek presidenti Bill Klinton në fund të tij (me patronimin e të cilit u pagëzua *Klinton (Naim) Mehaj*, Tomaj – Burim) ditën kur presidenti Amerikan vizitoi Kosovën në vitin 1999), përpjekjet për lirinë e trojeve shqiptare nuk reshtën asnjëherë. Brenda kësaj filozofie ka funksionuar edhe struktura e antroponimisë së kohës.

IV.2. Paradigma toponimike e antroponimeve

Bazat e një sistemi onomastik me burim nga motivet e historisë bashkëkohore i ka ndjekur si toponimia, ashtu edhe antroponimia, të cilat si motiv kanë burimet denominuese të kohës, sigurisht për shkak se toponimet dhe antroponimet e tilla zgjojnë ndjenjat e përkatësisë kombëtare¹⁹. Është e kuptueshme prandaj pse, ndryshe nga përvoja e shënuar në luftërat e tjera shumëshekullore, gjatë gjithë kësaj kohe të fundit ka pasur më shumë emra abstraktë (gjithnjë të motivuar në nomenklaturën gjuhësore dhe semantike të shqipes), sesa emra të karakterit

¹⁹ Sejdiu, 1992: 63-64.

historik. Në Kosovë kanë vazhduar të krijohen toponime të reja kryesisht me karakter historik. Edhe në këtë rast, siç do të shprehej studiuesi Igor Gostl “fusha semantike e toponimeve është shumë-shtresore: në të reflektohet, ndër të tjera, varësia politike, përkatësia etnike, vazhdimësia e popullzimit. Me një fjalë, ato shprehin realitetin ekzistues gjeografik, politik ose etnik. Kështu, toponomastika merr jo vetëm nuanca kuptimore, profesionale, shkencore por edhe politike e gjeopolitike”²⁰.

Toponimet dhe oronimet e vjetra brenda ditës morën karakter politik e historik, bie fjala: *Likoshan, Prekaz, Lugina e Leshanit, Gllogjan, Junik, Koshare* etj; emrat e krahinave shpesh të harruara, si rezultat i ndryshimeve shoqërore: *Drenicë, Rrafshi i Dukagjinit, Llap, Reka e Keqe, Rugovë* etj., brenda kësaj kohe u rikujtuan dhe u bënë pjesë e historisë sonë të re.

Në dhjetë vjetët e fundit kemi qenë dëshmitarë të prirjes së formimit paralel të toponimeve dhe antroponimeve me motive nga zhvillimet e përditshme në Kosovë e në përgjithësi në trojet shqiptare. Në Kosovë, gjatë këtyre viteve, shumë toponime janë bërë shembull i krenarisë dhe pjesë e identitetit tonë kulturor, shoqëror dhe horizonti më i lartë i vetëdijes sonë historike. Një dekadë më parë, toponimi *Fusha Lotëve*, gjatë Aksionit të Pajtimeve të Gjaqeve, u emërtua *Fusha e Pajtimit*. Toponimi me motiv legjendar *Qafa e Krushqve t'Ngrirë*, u emërtua *Qafa e Krushqve t'Pajtimit*. Po krijoheshin toponime

²⁰ Gostl, 1987: 85-86.

të reja, të cilat, në mënyrën e tyre, bënin historinë e re të Kosovës. Kështu janë krijuar edhe toponimet e tipit *Lugina e Pajtimit, Livadhi i Pajtimit, Fusha e Pajtimit* dhe antroponimet *Pajtim e Pajtime*. Gjatë kësaj kohe shpesh do të dëgjojmë dhe shpesh do të lexojmë toponimet e tipit *Lëndina e Dëshmorëve, Fusha e Dëshmorëve, Kodra e Dëshmorëve të Kombit (Gjilan), Varret e Dëshmorëve (Kukës, Shqipëri), Parku i Dëshmorëve të Kombit (Sharr)* etj.

Është e kuptueshme prandaj pse edhe onomastika në përgjithësi dhe antroponimia në veçanti kanë qenë një pjesë e asaj vlere që mund të quhet bartëse e rëndësishme e kësaj historie. Shekuj me radhë shqiptarët në përgjithësi dhe shqiptarët e mbetur jashtë shtetit të sotëm shqiptar në veçanti, kanë vazhduar të luftojnë për lirinë e tyre dhe me qindra vjet, fëmijët e tyre, kanë vazhduar t'i pagëzojnë me motive të kësaj qëndrese, me motive të kësaj lufte, me motive të çasteve të krenarisë, me motive të luftëtarëve të kohës së cilës i kanë takuar etj.

Motivet kanë qenë të shumta dhe të ndryshme, por asnjëri prej tyre nuk ka dalë jashtë veçorive të trashëguara që më parë. Pra, kjo kohë ka bërë që brenda këtyre viteve, një veçori e përdorimit të emrave të jetë më e theksuar, por kurrësi e dalë jashtë paradigmes denominuese të saj. Fjala është për emrat e fëmijëve që kanë trashëguar emrat e baballarëve luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, emrat e fëmijëve që tregojnë qëndresë, luftë, krenari historike; emrat e fëmijëve që tregojnë besim në të ardhmen; emrat e fëmijëve që tregojnë

veçanti kohe; tipin e emrave të traditës dhe besëtytnisë, tipin e emrave me të cilët nderohej Shqipëria dhe shqiptarët, tipin e emrave me të cilët nderoheshin të huajt etj.

Le të shohim këtu vetëm motivet denominuese antroponimike që kanë mbuluar të gjitha antroponimet e fëmijëve të lindur pas fillimit të luftës në Kosovë, dhe sidomos pas dëbimit të shqiptarëve në Maqedoni, Shqipëri, Europë, Amerikë etj²¹.

Në një regjistër të hartuar nga Shoqata “Nëna Terezë” në Dardani të Prishtinës, prej pesëqind e një emrash të fëmijëve të lindur gjatë vitit 1999, kanë dalë vetëm katër emra të paradigmës fetare: *Elmedina* (tri herë), *Xheneta* (tri herë, të kujtojmë se emri i saj nuk ka gjithnjë konotacion fetar, sepse është e mundur që prindi të ketë marrë si bazë emërtuese emrin e këngëtares *Xhenet Xhekson* – BB), *Elfati* dhe *Medina* nga një herë. Emrat më të shpeshtë në këtë regjistër, pjesa më e madhe e të cilëve kishte lindur jashtë Kosovës ose jashtë

²¹ Pa dashur që të merrem këtu me konceptet mbi të cilat është hartuar projekti i vlerësimit në konferencën shkencore *Mbijetesë etnokulturore e të shpërngulurve nga Kosova 1999*, dua të theksoj se, për mendimin tim, jo çdo i lindur jashtë kufijve aktualë të Kosovës, por çdo i lindur jashtë pragut të shtëpisë, që më parë është larguar me dhunë, është i shpërngulur, më saktë, i dëbuar me dhunë, përfaqëson mbijetesë etnokulturore. Nisur nga ky parim, në studimin tonë kemi radhitur të gjithë të lindurit jashtë pragut të shtëpisë, duke e vënë theksin veçanërisht tek të lindurit jashtë Kosovës.

shtëpisë së prindërve të tyre, kishin të bënin para së gjithash me motivet aktuale të lëvizjes kombëtare shqiptare për çlirimin e Kosovës, me aktualitetin e kohës etj: *Flamur, Urim, Albulenë, Çlirim, Lumbardh, Laberion, Toskë, Furtunë, Albion, Arbias, Molos, Qëndresë, Arbërie*, si trinom familjar: *Qëndresa, Qëndrim e Çlirim*, pastaj *Granit, Kastriot, Ejona*²², *Leutrim, Çlirimtare, Trim, Lirije, Liridon, Kosovare, Arbër*; binomi: *Qëndresa e Qëndron*, pastaj *Shpresim, Fitim, Çlirimtar, Delvina, Flaka, Skordion, Lindita, Fitore, Yll, Vatër, Lirim, Atdhe, Festa, Jon, Andrra, Gramoz, Shota, Shqipton, Shreson, Shpat, Etnik* etj.

Në traditën popullore, edhe më parë ka ndodhur që fëmijët të trashëgojnë emrin e babait, të gjyshit, të xhaxhait ose të një anëtarit të familjes, por më shpesh të vëllait ose të motrës së vdekur gjatë ose pas lindjes. Kjo traditë është bartur më pak ose më shumë edhe gjatë viteve kur shumë motra, vëllezër e prindër ranë në demonstrata gjatë viteve 1981-1999²³. Të këtyre motiveve janë edhe emërtimet e

²² Fjala *ejona*, e kthyer edhe në antroponim e toponim, përdorej nga pjesëtarët e Lëvizjes Kombëtare duke nënkuptuar Shqipërinë.

²³ *Bardha (Bardhosh-emri i babait dhe i gjyshit) Gërvalla* mban emrin e babait të vvarë nga sigurimi jugosllav në Gjermani më 1982, ndërsa babai i saj mbante emrin e babait të vetë Bardhoshit, të vvarë ndërmjet dy luftërave botërore, gjatë kolonizimit serbo-malazez të Rrafshit të Dukagjinit. *Fahri (Fadil) Fazliu* nga Prishtina mbante emrin e xhaxhait Fahri Fazliu, i vvarë në një kundërvënie të armatosur prej

fundit, por kjo dukuri është theksuar mjaft, sidomos në rastet kur babai i të lindurit ka qenë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: *Bashkim, Nuhi Ramiz, Halim, Driton, Ismet, Haki* etj²⁴.

Mund të thuhet se me fillimin e liberalizimit të politikës jugosllave, diku nga viti 1966 e këndej, në Kosovë, por fatkeqësisht jo edhe në Maqedoni e më gjerë në ish-Jugosllavi, fëmijëve filluan t'u vinin emra që tregonin jo vetëm motivin historik, e që kryesisht kishin të bënin me bartjen e emrave historikë (heronj, shkrimtarë e madje edhe emra të personazheve të

policisë serbe më 1989 në Bregun e Diellit - Prishtinë. *Mustafë (Mustafë) Veseli* nga Theranda mban emrin e babait të vvarë në demonstratat e vitit 1989 në Prishtinë etj.

²⁴ *Bashkim (Bashkim) Berisha*, i lindur gjatë ofensivës serbe në fshatin Tushilë (Skënderaj), më parë sesa për vlerë semantike kombëtare të emrit dhe më parë sesa emrin Bashkim, për paradigme denominuese ka marrë emrin e babait të vvarë, ushtar i UÇK-së. *Nuhi (Nuhi) Geci* i lindur në maj të vitit 1999 në Tiranë, tre muaj ka pritur gjetjen e kufomës së babait, luftëtar i UÇK-së në Drenicë, për të verifikuar vdekjen e tij ose jo, dhe për t'i marrë emrin. *Ramiz (Ramiz) Bazaj* (Tërstenik) u lind më 1 tetor 1999 dhe mori emrin e babait të vvarë, ushtar i UÇK-së. *Halim (Halim) Bajraktari* (Drenas) lindi më 1999 dhe përtëriu emrin e babait të rënë në luftë, ushtar i UÇK-së. *Driton Ahmeti (Likoshan)* u pagëzua me emrin e Driton Ahmetit të vvarë në familjen Ahmeti gjatë masakrës së Likoshanit, të ndodhur më 28 shkurt –1 mars 1998. *Ismet (Shkëlzen) Ramadani*, i lindur në pyll, ka marrë emrin e gjyshit të vvarë, sikurse edhe Haki Muharrem Ramadani etj.

veprave të tyre, piktorë etj.), por edhe me emra nga leksiku i gjuhës shqipe, që tregonin veçori të lëvizjes sonë të përgjithshme kulturore, historike dhe çlirimtare. Gjatë luftës së fundit, paradigma të tilla kanë dominuar shumë edhe në gjithë hapësirën kombëtare nga kanë lëvizur të përndjekurit dhe të dëbuarit e Kosovës, por kjo paradigmë do të dominojë sidomos për atë popullatë që do të mbetet në lëvizje të përditshme brenda kufirit të Kosovës: *Çlirim, Qëndresë, Yllka, Leutrim, Herolinda, Qëndrim, binjakët Pëllumb e Çelik, Dardan, Qëndrim, Malësore, Kosovare, Çlirim, Drilon*, trinom historik *Drilon, Teutë, Taulant*²⁵.

²⁵ *Qëndresë (Nysret) Lajqi* (31.1.1998 - Pejë), *Çlirim (Ragip) Krasniqi* (Carrallukë, Malishevë). *Qëndresë (Sabit) Gashi* (20.4.1998, Fortesë - Drenas) është emër përkushtimi ndaj Luftës së Likoshanit. *Yllka (Naim) Bazaj* (Tërstenik) ka lindur në fushën e Tërdefcit, në qershor 1999. *Leutrim (Fadil) Dvorani* nga Tërsteniku, lindi në maj të vitit 1999 në Malet e Tërstenikut, gjatë kohës kur pesë ditë me radhë u mbajt fronti në mbrojtjen e *Urës së Spahisë* në Tërstenik. *Herolinda (Musli) Krasniqi* (Negroc) është vajza e ushtarit të UÇK-së, i vrarë në Malet e Berishës. *Qëndrim (Jakë) Bytyçi* (Shkozë, Malishevë) lindi në qershor 1999 në Gjermani. Binjakët *Pëllumb e Çelik (Ejup) Thaçi* lindën në Malet e Berishës. Antroponimi *Çelik*, në këtë rast na paraqitet për herë të parë në antroponiminë shqiptare në Kosovë dhe është motiv i denominuar nga emri i Fatmir Limës, i njohur nga lufta si Komandant Çeliku; *Dardan (Fatmir) Jashari* (Açarevë) lindi në prill të vitit 1999 te Tunelet e Ujmirit. *Qëndrim (Naim) Zabeli* (Rezallë), lindi në ofensivën e parë të gushtit, vetëm pak ditë pas arritjes në Prishtinë. *Malësore (Shaban) Reci*

Pa dashur të merremi me krahasime të veçanta, këtu mund të them se, janë të pakta rastet kur një popull ballafaqohet, goftë edhe për lirinë e tij, me të gjitha elementet e mundshme kulturore, mendore, ushtarake etj., madje në shkallën më masive, sikur veproi populli shqiptar. Identifikimi i idealeve të tij edhe përmes emrave të pasardhësve, besoj, është shembulli më i mirë i gjetur te shqiptarët e Kosovës. Në pasqyrën e emërtimit të fëmijëve, që nga gjysma e dytë e shekullit të njëzetë, e mbase edhe më parë, mund të gjenden emra që për paradigmë kanë idealet prindërore, familjare dhe shoqërore të familjes kosovare, por, sidomos pas vitit 1966, kur ndihet një liberalizim më i theksuar shoqëror, paradigma e idealeve të tyre si bazë për t'u vënë emrat fëmijëve shtohet dhe zgjerohet shumë, për të mos thënë bëhet vlerë kryesore.

Një amzë e të regjistruarve në Shoqatën humanitare “Nëna Terezë”, në Prishtinë, në vitin 1999, më sillte një bazë paradigmatiche të fëmijëve me emra kombëtarisht të motivuar deri në 95%. Le të theksojmë se të gjithë fëmijët e regjistruar në këtë Fletore i përkasin zonës rurale të Kosovës. Në këtë kohë, pra, në ditët më të stuhishme të luftës dhe të

(Siçevë) lindi në shtator 1998 në Ulqin. *Kosovare (Rexhep) Rexhepi* lindi në Burrel. *Çlirim (Ali) Totaj* (Gjonaj, Prizren) lindi në një spital të improvizuar në një shtëpi private. Vëllanë e kishte luftëtar në Brigadën 138 “Agim Ramadani”, Zona e Pashtrikut; *Drilon (Musa) Gashi* (Prizren) lindi në spitalin e Durrësit. Pagëzuesja, nëna e tij, siç duket me këtë emër ka krijuar një trinom historik Drilon, Teutë, Taulant.

qëndresës popullore, shfaqen edhe emra tipikë të motivuar nga paradigma e besimit në të ardhmen, dashuria për jetën, lirinë, dashurinë etj: *Rilind, Lirim, Lirie, Jetëlira, Çlirim, Pranvera, Rinor, Krijona, Liridon, Agon, Endrit, Fitore* etj²⁶. Në pasqyrën e këtyre emrave janë shënuar edhe emra tipikë, që shënjojnë motivin denominues të pagëzimit të fëmijëve me emra që tregojnë veçanti kohe dhe madje momenti e vendi: *Malsor, Çlirim, Lirie, Flaka, Beteja, Lirije, Liridon, Qëndrim e Mërgim* etj²⁷, por

²⁶ *Rilind (Shefki) Bellaqa*, Potoqan (Rahovec). *Lirim (Milaim) Gashi* (Fortesë) lindi në maj 1998. *Lirie (Fazli) Koçinaj* (Blaç-Sharr), lindur në Kampin italian të Kukësit. *Jetëlira (Selim) Sahiti* (Korreticë e Ulët) lindi gjatë ofensivës së prillit 1999, në fshatin Shtrubullojë. *Çlirim (Xhevat) Sinani* (Korreticë, qershor 1999), u lind në fshatin Shtrubullojë. *Pranvera (Zymer) Gashi* (Fortesë, ish-Vërbovc) lindi në prill 1999 në Çikatovë të Re, në kohën kur i ati mbahej peng nga policia serbe. *Rinor (Behrami)* (Domanek) lindi në mars 1998 në Prishtinë. *Krijona (Jetullah) Havolli* (Resnik), lindi në maj 1999 në Malet e Resnikut. Siç mund të shihet, emri i saj është një kompozitë e ndërtuar nga parulla Kosova Republikë e Jona. *Liridon (Haki) Avdija* (Obri e Epërme) lindi në maj 1999, te Tunelet e Ujmirit. *Agon (Tahir) Halilaj* (Tërdevc) lindi në mars 1999, në Malet e Tërdefcit. *Endrit (Fatmir) Çoçaj* (Gjonaj, Prizren) ka lindur në fshat dhe është i biri i luftëtarit të UÇK-së. *Fitore (Dan) Hameli* (Mazrek, Prizren) lindi në tendën e katundit, ndërkohë që babai i saj kishte rënë dëshmor.

²⁷ *Malsor Krasniqi* (Gllanasellë - Drenas) lindi në Malet e Fortesës te Fusha e Mollës, në shtator të vitit 1998. *Çlirim Qosaj* (Ferizaj) ka lindur natën e hyrjes së këmbësisë së

nuk mungojnë as emërtimet e fëmijëve sipas traditës dhe besëtytnisë, po është me interes të shihet edhe një ndërlidhje mes tradicionales dhe të sotmes: *Vanesa, Shkurta, Fillim, Enis, Enisa* etj²⁸.

NATO-s në kufirin Maqedoni-Kosovë. *Krisma* ka lindur më 2 prill 1999 në Qafë të Prushit. *Lirie Bylykbashi* (Tërstenik) lindi natën e nënshkrimit të marrëveshjes së Kumanovës. *Malsore (Driton) Plakiçi* (Nekoc) lindi në prill 1999, në Malet e Berishës. *Flaka Krasniqi* (Negrovc) lindi në prill 1999 në Malet e Berishës. *Flaka (Isak) Kadriaj* (Deçan) lindi në kohën që po digjej fshati Isniq, ku ishte strehuar përkohësisht familja e saj. *Beteja (Luan) Kadriaj* (Deçan) lindi një ditë pas betejës së zhvilluar në fshatin Rastovicë, në të cilën mori pjesë edhe babai i saj. Po me këtë motiv janë emërtuar edhe fëmijët: *Lirije (Shemsi) Ramadani* (Vushtrri), *Liridon (Nexhip) Maloku* (Besianë), *Qëndrim e Mërgim Rexhepi*, binjakë të lindur në mërgim.

²⁸ Krahas emrave *Vanesa (Mehmet) Gashi* (Çabiq, Klinë), fëmijë i lindur pas shumë vjetësh martesë, *Shkurta (Vesel) Rrusta* (1999, Drenas), *Fillim (Irir) Kongjeli* (Prishtinë, 1999), *Enis (Sylejman) Zhdrella* (Besianë, 1999), *Enisa Aliu* (Prishtinë), *Shkurta Statovci* (Prishtinë, 1999), *Enis Ibrahim* (Plemetin – Kastriot, 1998), *Vanesa Gashi* (Prishtinë, 1998) etj., del edhe emri i *Muharrem Nexhat Asllanit* (Krushë e Vogël) Prizren. Ai ka lindur pesë ditë pas kthimit nga Shqipëria, ku ishin të dëbuar gjatë luftës. Gjyshi i tij Muharremi bashkë me të pesë djemtë, e në mesin e tyre edhe babai i nipit të sapolindur, konsideroheshin të zhdukur dhe për fatin e tyre nuk dihej ende, prandaj familja e pagëzoi me emrin e gjyshit, me qëllim që, siç thuhej “të mos i sillet kobi të atit”.

Me këtë tip të emrave familjet e përndjekura nga Kosova i kanë nderuar vëllezërit e tyre shqiptarë në Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi, si edhe ata të huaj, të cilët kanë ndihmuar luftën, përpjekjen tonë për liri, refugjatët e ndodhur në shumë vendstrehime të botës etj. Tridhjetë vjetët e fundit, fondi i emrave të fëmijëve të Kosovës, që për paradigmë denominuese ka pasur emrat e motivuar nga qytetet, fshatrat, malet, lumenjtë etj. të Shqipërisë londineze ka qenë i madh, për të mos thënë dominues në pasqyrën e përgjithshme të emërtimeve. Mund të thuhet se janë të pakta familjet që nuk e kanë emërtuar së paku një fëmijë me bazë denominimi me një onoma nga Shqipëria. Nuk ishte e rastit kjo. Në Kosovë gjenden shumë familje që brenda tyre kanë krijuar një sistem të tërë emrash të qyteteve: *Shkodran, Berat, Labinot, Elbasan, Tirana, Gjirokastra*; të maleve: *Dajt, por edhe Pushkëdajt, Tomor* etj; të lumenjve: *Drin e Drilon, Shkumbin, Vjosa etj*²⁹. Ashtu siç kanë nderuar familjen, shoqërinë, Kosovën, luftën çlirimtare dhe Shqipërinë, familjet nga Kosova, me emrat e fëmijëve të tyre kanë nderuar edhe ata, që kanë ardhur nga vendet më të largëta të botës, duke i marrë emrat e

²⁹ Më shumë sesa ndjenjë kombëtare dhe politike, ka pasur shumë vjet kur kjo paradigmë e vënies së emrave ka qenë edhe modë. Prandaj është e kuptueshme që edhe në këto ditë të vështira, të dëbuarit do të vazhdojnë të nderojnë edhe me emrat e fëmijëve të porsalindur Shqipërinë dhe popullin shqiptar të përtej kufirit: *Albinot (Ibrahim) Dobërdolani* (Korroticë e Epërme) lindi në Kukës, ndërsa *Shkodran (Mërgim) Rexhepi* lindi në Burrel.

tyre si relikte historike, apo emrat vendeve ku kanë lindur³⁰.

V. Përfundime

Toponimia dhe antroponimia edhe më shumë se dy shekuj vazhdojnë të mbeten referenca historike dhe madje paradigmatiche të vlerësimit të kaluarës sonë dhe sidomos të të ardhmes së hapësirës shqiptare. Kosova, njëra prej pjesëve të saj, madje vazhdon të mbahet peng pikërisht i kësaj trashëgimie të rrëgjuar.

Sikur të mos mjaftonte gjendja aspak favorizuese e toponimisë në konsolidimin e hartës etno-historike dhe gjuhësore të hapësirës shqiptare, në kohën kur popujt fqinje e bëjnë të pamundurën për të ruajtur vlerat gjuhësore, kulturore, psikologjike dhe etno-historike, mbështetur madje edhe nga mitet romantike të tyre, shpërbërëve të kujtesës dhe identitetit kombëtar, ka kohë që po përpiqemi t'ia shtojmë edhe një identitet të ti: identitetin kosovar!

Klasës politike dhe intelektuale shqiptare, pa pasur nevoje të merret me teorizime, do t'i mjaftonte mbështetja në paradigmen etno-psikologjike dhe

³⁰ “Jam shumë i lumtur që djali im ka lindur diku në Amerikë, shprehej babai i një ta sapolinduri. (...) Dhe ky është shkaku kryesor për ta pagëzuar *Amerikan*” (kështu e përcillte bisedën me një bujk 28 vjeçar nga Ferizaji gazetari i agjencisë telegrafike *Rojters*, më 6 maj 1999 nga Mount Holly, Nju Xhersi).

kulturore të popullit të saj dhe sidomos të popullit shqiptar nën ish-Jugosllavi, për të kuptuar se asnjë prej përbërësve etno-historik, duke përfshirë këtu edhe antroponiminë, nuk përbëjnë referencë kulturore, gjuhësore apo historike, për tu mbështetur identiteti i ri, i ashtuquajtur i kosovar.

Përkundrazi, shqiptarët, përkatësisht institucionet e Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit, prej shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, kurrë nuk e kanë pasur mbështetjen më të fuqishme të bashkësisë ndërkombëtare se sa në fund të shekullit XX, për të realizuar referencat historike të hartës gjuhësore dhe historike të hapësirës shqiptare, brenda kufijve etnografik të saj, siç shprehej në fillim të viteve '30 të shekullit XX, diplomati nga Prishtina, Profesor Mehmet Vokshi³¹. Kosova tashmë ka bërë hapin e saj të parë.

Brenda dekadës së fundit, që jo njëherë është quajtur me të drejtë përuddhë historike, në Kosovë, krahas ndryshimeve të mëdha është përmbyshur edhe koncepti i njohur që më parë: gjuhët ndryshojnë kur ndryshojnë shoqëritë³². Në Kosovë ndërkaq, ka ndryshuar jo vetëm shoqëria, por edhe koncepti mbi të. Ka ndryshuar prandaj edhe toponimia e saj. Në të vërtetë ajo vetëm ka plotësuar përbërësin kombëtar mjaft homogjen: antroponiminë.

³¹ Vokshi, 1933.

³² Kristal, 1997: 5.

Mbi këto parime Komisioni Qendror për Standardizimin e Toponimisë së Kosovës ka përfunduar punën e tij në kërkimin, vlerësimin dhe standardizimin e emërvendeve të Kosovës. Puna e këtij nuk ka qenë as pa vështirësi dhe as pa përgjegjësi. Ai ishte i vetëdijshëm se më shumë sesa karakter shkencor, ky Komision kishte përgjegjësi të karakterit kulturor e kombëtar, e pse jo edhe politik dhe historik.

L i t e r a t u r a

- Baliu, Begzad, Akti i fundit i punës në standardizimin e toponimisë së Kosovës, “Gazeta e re”, 19 prill 2001, Prishtinë, f. 18; Shih edhe artikujt Projekt shkencor me karakter historik, “Pasqyra”, 31 mars 2000, f. 16; Ndihmesë diskutimit për standardizimin e emërvendeve të Kosovës, “Pasqyra”, 5 mars 2000, f. 15-32 etj.
- Baliu, Begzad, *Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan*, “Era”, Prishtinë, 2004
- Baliu, Begzad, Jo ndryshim i emërvendeve të Kosovës, por standardizim i tyre, “Gjuha jonë”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Gjuhësisë dhe Historisë, Tiranë, nr. 1-2/2000, f. 71-80.
- Baumgartner, Emmanuele - Menard, Philippe, *Dictionnaire etymologique et historique de la langue française*, Paris, 1996
- Bellusci, Antonio, *Ricerche e studi tra gli arberori dell'ellade – Kërkime dhe studime ndër arbërorët e Helladhës*, (Da Radici arbereshe in Italia a matrici arberore in Grecia –Testi e dokumenti), Cosenza, 1994

- Çabej, Eqrem, *Njësia gjuhësore pasqyron një njësi kulturore*, “Fjala”, nr. 19, Prishtinë, 1979, f. 7.
- Çabej, Eqrem, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Tiranë, 1974
- Carrabregu, Muharrem, *Gjeo dhe hartolinguistika* (Hartografia II), Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Botoi Enti i Teksteve dhe Mejeleve Mësimore i Kosovës, Prishtinë 1980, f. 86.
- Doçi, Rexhep, *Përgjigje zërit të profesionit*, “Zëri”, Prishtinë, 15-21 mars 2003, f. 20.
- Gashi, Skënder, “*Standardizimi*” i toponimisë së Kosovës, *çfarë është ai?*, i botuar në të përditshmen “Zëri”, 21. I. 2003 – 24. I. 2003, Prishtinë
- Gostl, Igor, “Egzonimia historike (Kontribut qasjes teorike)”, *Gjurmime albanologjike – seria e shkencave filologjike*, nr. 17-1987, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1988, f. 85-86.
- Grup autorësh, *Fjalor i fjalëve të huaja*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1988
- Grup autorësh, *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980
- Grup autorësh, *Puka dhe shkolla*, (Sesioni i parë shkencor për toponimet, Kabash, 21 maj 1977), Pukë, 1977
- Hoad, T. F., *English etymology*, Oxford - New York, 1996
- Ismajli, Rexhep, “*Në gjuhë*” dhe “*për gjuhë*”, “Dukagjini”, Pejë, 1998
- Kristal, Dejvid, *Enciklopedijski rečnik moderne lingvistike* (Oxford, 1985), Beograd, 1997; *Kembrička enciklopedija jezika* (Cambridge, 1987), Beograd, 1997

- Mulaku, Latif, *Emra të disa vendbanimeve të Vushtrrisë*, “Rilindja”, Prishtinë, 25 dhjetor 1999.
- *Onomastika e Kosovës*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1979.
- Pirraku, Muhamet, *Për një kujdes më të madh në shkrimin e emrave të vendbanimeve*, “Rilindja”, Prishtinë, 10. 1. 1973, f. 14;
- *Regjistri i emërvendeve të Kosovës* (Përfundimet e Komisionit Qendror), Prishtinë, 2004
- Sejdiu, Shefki, *Sprova etimologjike*, “Era”, Prishtinë, 2002
- Sesioni shkencor, *Gjendja e onomastikës shqiptare në momentin e tanishëm*, në “Gjuha shqipe”, nr. 1, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1987
- Sesioni shkencor, *Toponimia e Gjakovës me rrethinë*, Gjakovë, 2002.
- Shefki Sejdiu, “Rreth disa motivimeve denominuese në antroponimi”, Gjurmime albanologjike – seria e shkencave filologjike, nr. 21-1991, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1992, f. 63-64.
- Simeon, Rikard, *Enciklopedijski rječnik lingvističkih naziva*, I, II, Zagreb, 1969.
- Veselaj, Nuhi, *Çështje rreth emërimit të vendbanimeve në shqipe me theks në emërtimet e propozuara në Kosovë*, “Rilindja”, Prishtinë, 19 mars 2001, f. 15.
- Vokshi, Mehmet, *Shqipnija e shqiptarëve*, “Era”, Prishtinë, 2001.

EMRI I DARDANISË

në studimet gjuhësore të Profesor Çabejt

Emri *Dardani*, *dardan*, *Dardan* është njëri nga toponimet, etnonimet, fitonimet dhe antroponimet antologjike të gjuhësisë historike dhe të sotme shqiptare. Në gjuhësinë shqiptare emri i Dardanisë (kryesisht në kontekst të njërës prej krahinave të Ilirisë), është përfshirë në shtresën e toponimisë së antikitetit shqiptar, si *Albanoi*, *Dalmatia*, *Dimallum*, *Ulcinium*, *Scardus Mons*, *Naissus* etj., zgjidhja etimologjike e së cilës, në vija të përgjithshme është kryer nga Zef Skiroi (1836), edhe pse gjuhësia europiane përgjithësisht dhe ajo shqiptare veçanërisht, vazhdon që këtë meritë t'ia njoh Hahnit³³. Ky studiues i shquar emrin e krahinës ilire

³³ Shih, *Albanischen Studien*, I, Jena, 1854, f. 236. E. Çabej, *Hahn*, njësi enciklopedike e botuar së pari në vëllimin *Hrvatska enciklopedija*, sv. IV CLIACHIT – DIKTIS, Naklada Hrvatska Izdanja Bibl. Zavoda, Zagreb, 1942, rimarrë nga kapitulli *Skica të ndryshme*, botuar për herë të

të *Dardanisë* e barazoi me emrin e *dardhës*. Për më shumë se një shekull e gjysmë, në thelb, ky barazim nuk është lëkundur deri më sot. Vetë zhvillimi i gjuhësisë historike ka bërë që në njërin anë kërkesa për një relativizim të pjesshëm apo të plotë të mos mungojë, në anën tjetër, edhe mbi këtë bazë janë zgjidhur probleme, qoftë të brendshme të shqipes, qoftë në krahasim me gjuhë të tjera të familjes indoeuropiane.

Kjo është arsyeja pse gjuhëtarët e sidomos historianët e shekullit XX, emrit të *Dardanisë*, si edhe toponimeve *Dalmaci*, *Dimalum*, *Ulcinium* etj., i janë qasur pa kompleksin e diskutimit të prejardhjes së etimologjisë së tij, jo vetëm në botimet akademike, por edhe në tekstet shkollore, madje edhe pa referencën e domosdoshme të studiuesit apo studiuesve që i kanë sjellë këto përfundime.

Interesimi i Eqrem Çabejt për emrin e *Dardanisë* në studimet e tij ka qenë i veçantë dhe i shpeshtë. Emri i *Dardanisë* është bërë temë trajtimi dhe analize në fushë të leksikut (për emrin e *dardhës*), në fushë të toponimisë (emrin e *Dardanisë* dhe etnonimit *dardan*), në disa çështje të zhvillimit të brendshëm të historisë së shqipes, në zgjidhjet gjuhësore, kryesisht etimologjike të gjuhësisë indoeuropiane, në gjetjen e konkordancave ndërmjet shqipes dhe gjuhëve indoeuropiane, në hulumtimin e elementeve të

parë në gjuhën shqipe, në *Studime gjuhësore* V, “Rilindja”, Prishtinë, 1975, f. 325.

shqipes prehistorike etj³⁴. Duke vjelë një literaturë të pasur në fushë të gjuhësisë, të historisë, të etnografisë, të arkeologjisë etj., Eqrem Çabej studimet për emrin e krahinës ilire të Dardanisë, etnonimin dardan dhe fitonimin *Dardhë-a*, i ka zgjeruar në disa drejtime dhe në disa fusha të dijes³⁵.

Historia

Në literaturën historike sot është pranuar përgjithësisht se *Dardania* është njëra nga krahinat ilire, pjesa qendrore e së cilës sot njihet me emrin

³⁴Eqrem Çabej, *Emri i Dardanisë dhe izoglosat shqiptarokelte*, botuar së pari në “Studime filologjike”, ASH e RPSSH, IGJL, Tiranë, 1973, XXVII (X), nr. 3, f. 55-64; njësia leksikore ”dardhë”, në *Studime etimologjike në fushë të shqipes, A-O*, “Rilindja”, Prishtinë, 1977, f. 107; njësia leksikore “dardha” (formë e zgjeruar e njësisë leksikore, e shënuar më lart), në *Studime gjuhësore*, IX, “Rilindja”, Prishtinë, 1989, f. 166-168; studimi *Disa izoglosa kelto-shqiptare*, botuar së pari gjermanisht në vëllimin *Studi linguistici in onore di Vittore Pisani*, 1969, I, f. 167-186, ndërsa i botuar për herë të parë në gjuhën shqipe në *Studime filologjike*, Akademia e Shkencave e Republikës Socialiste të Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1973, XVII(X), nr. 2, f. 49-61, cit. nga E. Çabej, *Studime gjuhësore*, IV, “Rilindja”, Prishtinë, 1977, f. 374-385 etj.

³⁵ Në studimet për emrin e Dardanisë, Çabej ka shënuar edhe literaturë nga Paul Kreçmeri, Karl Paç, N. Vuliq, Radosllav Katiçiq, dhe sidomos Fanulla Papazogllu, studiues këta që kapin një periudhë studimesh që nga viti 1896 e deri më 1969.

Kosovë, ndërsa etnonimi dardan, njëri prej fiseve ilire. Eqrem Çabej, duke u nisur nga një numër antroponimesh (të vetmet dëshmi gjuhësore sot për dardanët dhe Dardaninë), konstaton se oemrat e personave: *Bato, Dasius, Epicardus, Longarus, Messius, Plannius, Turellius*, çojnë në trevën gjuhësore të ilirëve, veçanërisht emri i fisit Γαλαβροι me atë të mesapëve (*Calabri*), ndërsa ne e ndërlidhim edhe me fisin *Galabroi*, fis që banonte në krahinën e sotme verilindore të Kosovës, *Gallapit*³⁶; po me anë tjetër, vazhdon Profesor Çabej, emra të tillë si *Auloparis, Auluzon, Bitus, Dizo* (...) shprien në trevën gjuhësore të trakasve³⁷, prej nga ne këtu mund të sjellim disa përfundime:

1. Së pari, aspekti organizativ: Dardania ishte një mbretëri me ndikim politik dhe ushtarak shumë të ulët. Mendimi i tij provohet edhe nga Aleksandër Stipçeviq, i cili nga ky aspekt ka konstatuar se “roli politik dhe ushtarak i dardanëve rritet vetëm mbasi

³⁶ Shih, edhe Muharrem Carrabregu, *Gjeo dhe hartolinguistika - hartografia*, II, UP-FSHM-N, botoi ETMNK, Prishtinë, 1989, 122, 123, 264; Skënder Gashi, *Mendime rreth prejardhjes së emrit të krahinës së Gollakut (Gallapit)*, në “Fjala», nr. 2, Prishtinë, 1984, f. 20; Rexhep Doçi, *The Serbization of Kosova*, në revistën “The Voice of Truth” (*Zëri i së vërtetës*), Vol. 10, nr. 2, P. O. Box. 742, Ridgefield, NJ. 7657, pp. 1-3.

³⁷ Eqrem Çabej, *Emri i Dardanisë....*, në “Studime gjuhësore”, IV, 386, 387.

keltët sulmojnë maqedonët”³⁸, e kjo ndodh pas shekullit IV-III para erës së re;

2. Së dyti, pozita etno-gjeografike: sipas Çabejt, duke qenë në kufi me trakët dhe me një pasuri të dukshme emrash trakë gjatë epokës greko-romake, “si në pikëpamje gjeografike ashtu edhe në atë etnike dardanët kanë pasur një pozitë të ndërmjeme, ndërmjet ilirëve dhe trakasëve”³⁹;

3. Së treti, aspekti gjuhësor-onomastik: Sipas Çabejt “tema *Dard-* në onomastikën e kohës antike ka qenë e përhapur përtej caqeve të trevës dardane dhe të trevës dardane-trojane. Ajo na del me një anë të *Dardas*, emri i një *opraetor epiratrum*’, të *Δερδενις*, emër i shpreshtë princash makedonë-elimiotë, bashkë me emrin e një qyteti të trevës elimiote, me *Δερδια*, në Tesali, *Δερδενις* në ishullin Lesbos, më anë tjetër në truallin italik, në Apuli, si emër i një populli *Dardi* të *Daunëve*, si emër krahine *Derdensis*, dhe si emër i një qyteti *Δαρδανον*. Sufiksi *-ano* në *Dardanus Dardania* (...) ka qenë i përbashkët për shumë gjuhë indoeuropiane”⁴⁰.

Tash së fundi studiuesi Qazim Lleshi, një gjurmues i pasionuar i studimeve ilire, ka sjellë një pasqyrë të pasur antroponimesh ilire, apo sikur

³⁸ Aleksandër Stipqeviç, *Ilirët*, “Rilindja”, Prishtinë, 1990, f. 51.

³⁹ Shih, E. Çabej, *Emri ...*, po aty, f. 387.

⁴⁰ E. Çabej, *Emri i Dardanisë...*, po aty, f. 388-389.

shkruan autori, emrave vetjakë të ilirëve⁴¹. Në këtë vëllim shihet një pasqyrë e rëndësishme e antroponimeve tipike dardane, sikur janë emrat e mbretërve dardanë dhe familjeve të tyre, emrat e njerëzve të shquar, ushtarëve, emrat e zotërave të tyre etj.

Antroponimi *Andia(f)*, paraqitet në zonën e Kosovës e të Maqedonisë, si *Andiae Dassi*, por gjendet edhe në Siujdhesën e Apenineve. Në trajtën e gjinisë mashkullore, *Andin-i*, sipas Anton Mayer është gjetur në Kaçanik të Kosovës⁴².

Antroponimi *Bardhyl*, është emër i mbretit dardan, ndërsa toponimi *Dardan-i*, sikur mund të kuptohet është emër që rrjedh nga fisi ilir i dardanëve. Autori tërheq vërejtjen se edhe ky emër është shumë i përhapur në Europën Juglindore, madje edhe jashtë saj.

Antroponimi *Kalsina*, sipas Fanulla Papazogullit është “emër femëror që u përket emrave ilirë të gjetur vetëm në Dardani”⁴³.

Antroponimi *Kito* dhe trajta e tij *Kotaj*, është emër i rëndësishëm për dy arsye: për faktin se përveç në Dardani, sikur mendon Fanulla Papazogulli, ky emër gjendet edhe në mesin e emrave trakas.

⁴¹ Qazim Lleshi, *Emrat vetjakë ilirë*, Shtëpia Botuese “Dituria”, Tiranë, 1998, f. 150 + një hartë.

⁴² Po aty, f. 70.

⁴³ Po aty, f. 68.

Antroponimi *Monun*, është emër i dy mbretërve iliro-dardanë⁴⁴. *Nanea* dhe *Pasia*, janë emra shumë të përhapur te fisi i Pirustëve. *Summ-i*, del emër i një ushtari dardan; *Sausa* dhe *Sitë*, u gjetën në Rahovec. Studiuesi Lleshi beson se ndër shqiptarët është ruajtur te patronimi *Shita*⁴⁵, ndërsa ne besojmë se më afër mendsh është që kjo trashëgimi të kërkohet te emri i Sutës, mëshqerrë e re, apo te mikrotoponimi i trajtave të ndryshme që shoqërohet me emrin e Sutës; *Pirust*, është “gjetur midis minatorëve ilirë nga Dalmacia, të cilët në epokën e pushtimit romak ishin të angazhuar në shfrytëzimin e minierave të arit në krahinën e Dakisë antike rrëzë Karpateve perëndimore”⁴⁶. Më tej autori shënon edhe emrin e mbretit ilir *Pirustae*. Më parë se sa një emër vetjak ilir, te këto dy antroponime gjejmë edhe njëherë një lidhje të vjetër dhe të dyfishtë të Dardanëve, si dardanë në traditën popullore dhe si *Pirustae* në traditën shkrimore të pushtetit romak. Prandaj, ne besojmë se fjala është më shumë për etnikun e ushtarit e jo për emrin vetjak, gjithashtu të mundshëm si kuptim të parë të tij. Sikur është thënë edhe më parë, edhe këtu lidhjet ndërmjet një etniku Dardan dhe të një toponimi *Pirustae*, të ruajtur në Kosovë si toponim *Qafa e Prushit* edhe këtu nuk kanë pse të vihen në dyshim.

Vanno, është antroponim i gjetur në hapësirën e rrënojave në Ulpianë. Një emër i kësaj rrënje është

⁴⁴ Po aty, f. 87.

⁴⁵ Po aty, f. 108-109.

⁴⁶ Po aty, f. 110.

edhe emri *Varan-i*, emër i një ushtari që shërbente në kohorten Dardane, e që sipas Fanulla Papazogullit, është emër iliro-dardan, i cili nuk haset jashtë Dardanisë, sikur edhe emrat vetjakë të kësaj zone: *Varania* dhe *Varanila*. Emrat vetjakë *Vendo* dhe *Vendon* u gjetën edhe te ilirët e Italisë. Edhe arkeologu i njohur Hans Krahe mendon se *Vendo*, *Venndo* është emër tipik i ilirëve të Ballkanit.⁴⁷ Për këtë trajtë antroponimike, afër së cilës besoj se është edhe emri *Venet*, Schulze, mendon se ka prejardhjen nga trajta pararendëse etruske “venate”⁴⁸. Po ky autor edhe për emrin vetjak *Vakon*, mendon se vjen nga një “Vaconnius”, i prejardhjes etruske, pra ndërlidhet me pellazgët e stërlashtë”⁴⁹;

Aspekti gjuhësor

Eqrem Çabej iu ka dhënë të drejtë, por vetëm në parim: shpjegimit të Hahnit për emrin dhe etimologjinë e toponimit *Dardani*: *dardhë* “vend *dardhash*”; A. Baldecit për shënimin e tij se kjo trevë ishte e pasur me pemë të egra; Edit Durhamit, e cila e ka tërhequr vëmendjen me konstatimin e saj përgjithësues, se “emrat e vendeve me burim nga emra bimësh janë shumë të shpeshtë si në viset sllave jugore si në trevën shqiptare; (...) *Arnje*, *Molla*, *Arra*, *Qerreti*, *Kumbulla*, *Dardha* e për sllavishten:

⁴⁷ Po aty, f. 130.

⁴⁸ Po aty, f. 130-131.

⁴⁹ Po aty, f. 133.

*Krushevo, Krushevac, Krushevica*⁵⁰, dhe Vlladimir Georgievit për deklaratën e tij se “*Krushevci* gjendet bash në truallin e *Dardanisë* së vjetër”; por Profesor Çabej e ka pasuruar kërkimin e tij për emrin e Dardanisë dhe etnonimin dardan edhe me të dhëna të tjera për praninë e një vargu toponimesh e emrash topikë, patronimesh në zona të ndryshme të Shqipërisë, të kolonive shqiptare në Greqi, tek arbëreshët e Italisë etj. Për ne janë me interes dy propozime. Sipas tij “ka gjasë të hyjë edhe *Darsi* (nga një *Dárdhësi, Dardhsi*) si dhe emri i krahinës *Darsia* në Shqipëri të mesme, në qoftë se ajo rrjedh nga një *Dardhsia*”⁵¹. Përhapje të madhe kanë gjithashtu edhe emrat topikë *Maj’e Dardhës* e *Qaf’e Dardhës* dhe *Zall i Dardhës* (në Dibër), *Kurora e Dardhës*, emri i një kullose malore të verës në Kryezi të Mirditës⁵². *Dardha* është emër katundesh i shpeshtë edhe në Greqi, veçanërisht në trajtën deminutive-kolektive *Dárdhëza* (Νταρδίζα) në Morenë Jugperëndimore, në Antikë e në Elidë, si dhe *Qardhishtja* në krahinën *Trifilja*⁵³, emra që i ka vënë elementi shqiptar që nguli në ato anë. Prej Italie hyn aty *Dardhës*, emri i një

⁵⁰ E. Durham, “Man” 23 (1923) 42; *Some tribal Origins, Laws, and Customs of the Balkans* (1928) 236 w. Cit. nga E. Çabej, *Emri i Dardanisë*, po aty, f. 389.

⁵¹ E. Çabej, *Emri i Dardanisë*, po aty, f. 390.

⁵² Execurrens, Leka VI 57; Cituar nga Çabej, *Emri i Dardanisë*, po aty, f. 390.

⁵³ Shih, f. 14, cit. nga Çabej, *Emri i Dardanisë*, po aty, f. 390.

familjeje tashmë të shuar në katundin Kienti të Molizës.⁵⁴ Gjeografisë gjuhësore të shtrirjes së toponimeve dhe mikrotoponimeve me bazë në fitonimin *dardhë* do të mund t'i shtonim edhe një varg toponimesh e mikrotoponimesh historike dhe të kohës sonë. Nga dokumentet historike dhe arkivore Dhimitër S. Shuteriqi ka sjellë një mori emrash lidhur me bazën *dardhë*, që nga viti 1417 e këndej: *Dardhan-i* (1467), *Dardhaneshi-i* (1431), *Dardhasi* (1431, *Dardas* (1467), *Dardhë-a* (1417), *Darda*, *Dardhicë-a* (1431), ndërsa nxjerr nga *Leksikoni* i Hans Krahes: *Dardha*, *Dardhanesh*, *Dardhas* dhe *Dardhicë*⁵⁵. Duke insistuar në paraqitjen e një tërësie onomastike që për qëllim kishte paraqitjen e shtrirjes shqiptare në Gadishullin Ilirik, studiuesi Rexhep Doçi ka shënuar edhe disa toponime të këtij etimoni në Gadishullin Ballkanik nga V. Panajotopoulos⁵⁶: *Dardessi*, *Dardeon*, *Dardesza*, *Dardhëza*, *Dari* etj., ndërsa duke u marrë me etimonin e *dardhës* në aspektin diakronik dhe krahasues Rexhep Doçi ka

⁵⁴ Kolë Kamsi, Leka , XV, 218, cit. nga Çabej, *Emri i Dardanisë*, “Studime gjuhësore”, V, f. 390.

⁵⁵ Dhimitër S. Shuteriqi, *Fjalë nga leksiku i shqipes para Buzukut (879-1553)*, “Gjurmime albanologjike” - seria e shkencave filologjike, nr. 19, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1990, f. 308 - 309.

⁵⁶ Rexhep Doçi, *Iliro-shqiptarët dhe serbët në Kosovë (sipas onomastikës)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1994, f. 265, i cili e ka konsultuar V. Panajotopoulos, *Popullsia dhe vendbanimet e Peloponezit gjatë shekujve XIII-XVIII*, Athinë, 1985.

shënuar edhe një varg shembujsh: *Dardhoj* (1485, e ka edhe Çabej), *Dardos* (sipas Selami Pulahës), *Varret e Dardhishtes* dhe *Udha Dardhishtes* (në Kërboq - Kaçanik); mikrotoponimet: *Tu Dardha*, *Dardha Turke*, *Dardha Zallines*, *Dardha Haxhi Qazimit* dhe *Thepi Livadhit'* *Dardhave* (Kukaj); mikrotoponimet: *Dardha Madhe*, *Bregu i Dardhës*, *Fusha e Dardhave* etj., (*Krushë e Madhe* - Prizren)⁵⁷. Toponimet e regjistruara nga Lj. Stankovska, që ne po i citojmë nga studiuesi Qemal Murati, *Darda*, *Darda Kula*, që për ne janë të rëndësishme, sepse me këtë dëshmohet jo vetëm prania shqiptare në këtë zonë të Maqedonisë, por edhe ndikimi i shqipes në gjuhën maqedonase në fushë të leksikut përgjithësisht⁵⁸. Ne këtu po i shtojmë edhe disa mikrotoponime të Kosovës, si: *Dardha Nanes t'Madhe* (Makreshi i Poshtëm-Gjilan), *Te Dardha Gat*, *Ara Dardhes Gat*, *Te Dardhat Lamqe*, *Te Dardha Bizqe*, *Udha Dardhes t'Gat* (Marec-Prishtinë), *Lugit*

⁵⁷ Rexhep Doçi, *Ndriçimi i disa patronimeve dhe toponimeve kosovare nëpërmjet Fjalorit të Majerit* në vëllimin "Gustav Majer – jeta dhe vepra" (Sesion shkencor kushtuar 100-vjetorit të botimit të këngës kreshnike shqiptare), Prishtinë, më 15.XII.1997), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1998, f. 77.

⁵⁸ Shih, Qemal Murati, *Elementet e shqipes në gjuhët sllave jugore*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1990, f. 119.

Dardhav (Capar-Gjilan), *Makreshova Darda* (Jasanovik-Novo Bërdë) etj.⁵⁹

Shtirirjen gjuhësore të toponimeve dhe sidomos eponimeve me bazën *dardhë*, tezë e hapur nga Profesor Çabej, e ka përkrahur Ruzhdi Ushaku në një diskutim shkencor, kur ka paraqitur mendimin se “eponimin *Dardan* e ka vënë në një kontekst të lidhjes së mundshme të emrit të *Dardanisë* (pra edhe të fisit të dardanëve) dhe duke kujtuar një studim të Gërga Novakut ka shtuar ekzistimin e disa përkimeve toponimike me emrin e Dardanëve në një shtirje më të gjerë gjeografike deri te *Dardanelet*”⁶⁰. Po lidhur me këtë temë ka tërhequr vërejtjen Shefki Sejdiu, duke sjellë një koncept të tij përgjithësisht për metodologjinë e qasjes në fushë të etimologjisë. Kur shtrohet gjeografia gjuhësore e këtij problemi, mendon ai, duhet pasur kujdes areali gjuhësor, përndryshe humben kriteret e studimit në etimologjinë moderne”⁶¹.

⁵⁹ Begzad Baliu, Nga arkivi personal i onomastikës, mbledhur pas vitit 1989.

⁶⁰ Ruzhdi Ushaku, *Diskutim për kumtesën e Rexhep Doçit dhe të Hasan Dulajt*, në vëllimin “Gustav Majer – jeta dhe vepra” (Sesion shkencor kushtuar 100-vjetorit të botimit të këngës kreshnike shqiptare), Prishtinë, më 15. XII. 1997), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1998 f. 228.

⁶¹ Shefki Sejdiu, *Diskutim për kumtesën e Rexhep Doçit, Hasan Dulajt dhe të Muhamet Pirrakut*, në vëllimin “Gustav Majer-jeta dhe vepra” (Sesion shkencor kushtuar 100-vjetorit të botimit të këngës kreshnike shqiptare), Prishtinë, më

Lidhur po me fjalën dardhë dhe barazimet e saj me toponimin *Dardani* dhe etnonimin *dardan*, këtu është mirë të jepet edhe një pasqyrë e mendimit të studiuesve të huaj për zhvillimin e saj në aspektin diakronik dhe disa etimologji të saj në aspektin krahasues:

Së pari, shpjegimi i A. Fickut, sipas të cilit “duke u nisur nga një vlerësim i historisë se dardanët ishin të papastër, gjente te emri i tyre “*ndyrçakë*” dhe e afronte me gr. *δαρδανει μολυνει* (*dardanei – molijnei*) »*ndyn*» që e ka Heziku⁶², merrte përgjigje prej Profesor Çabejt, sipas të cilit, këto përfundime mund të quhen me plot gojën etimologji për hir të etimologjisë;

Së dyti, mbështetjen në aspektin gjuhësor, përkatësisht etimologjik Profesor Çabej e ka kundërshtuar edhe mendimin e studiuesit bullgar D. Deçevit dhe mendimin e studiuesit rumun I. Russu. Në këtë rast Çabej nisej nga një fazë e krahasueshme e shqipes indoeuropiane: “duke e cituar gjuhëtarin S. Bugge, i cili “mendonte që kjo fjalë, si reflekse e një forme bazë **g’hard-* është e afërt me gr. *αχρας* “*dardhë e egër, gorricë; dardhë*”, e *αχερδος* “*dardhë e egër, gorricë; murriz*”, ku *d*-ja e shqipes i përgjigjet pas fonetikës rregullisht - *χ*-së së

15.XII.1997), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1998, f. 228.

⁶² KZ. 44, 399. Hattiden und Danubier (1909) 39, cit. nga Çabej, *Emri i Dardanisë*, “Studime gjuhësore”, IV, f. 390.

greqishtes, ashtu si në *dimën*: gr. *χειμα, χειμον, dimër*” të *greqishtes*⁶³. Këtë mendim, sipas Çabejt, e kanë miratuar Gustav Majeri, Holger Pedersen dhe Norbert Jokli, ndërsa e kanë kundërshtuar Boisacq, Walde-Pokorny, Frisk, F. Ribezzo, P. Chantaine dhe Schwyzer, pastaj K. Oshtir dhe G. Novak. Dy të fundit mendonin se *dardhë* është fjalë paraindoeuropiane, ndërsa të parët, fjalën greke e konsideronin të huaj. Rrjedhimisht, përfundimet e Profesor Çabejt, dalin mjaft sintetike jo vetëm brenda zhvillimeve gjuhësore të shqipes historike, por edhe në kuadër të përkimeve gjuhësore me gjuhët e Ballkanit edhe në kuadër të afrisë dhe rrjedhëve të përbashkëta me familjen indoeuropiane.

Pa përjashtuar krejt mendimin e ndërtuar prej Bugges, Eqrem Çabej, mendonte se “për këtë emër druri të shqipes ekziston mundësia e një tjetër afrie gjuhësore: shq. *dardhë*, si vazhdim i një forme bazë **d(h)orga’a* mund të jetë e afërt me fjalën kelte, irland. *draigen* “*kullumbri; dardhë e egër, gorricë*” (kjo prej një baze **drageno*), korn. e vje. *Drani*, breton. *Drean*, një fjalë, shpjegimi etimologjik i së cilës nga ana e Pedersenit⁶⁴ dhe e një forme më të zgjeruar

⁶³ Bezzenbergers Beiträge XVIII(1892) 164, cit. nga Çabej, *Studime gjuhësore*, IV, f. 390-391.

⁶⁴ Vergleichende Grammatik der keltischen Sprachen I (1909) 97, cit. nga Çabej, *Studime gjuhësore*, IV, 391.

nga ana e J. Vendryesit⁶⁵ nuk e ka gjetur miratim të përgjithshëm.

Me këtë barazim, Eqrem Çabej shpresonte t'i kalojë caqet e shqyrtimit thjesht të një fjale “*dardhë*” dhe të emrit të *Dardanisë*. Përkundrazi, duke u nisur nga ky rast, Çabej besonte se po hynte në një fushë të hapur të izoglosave shqiptare-kelte, marrëdhëniet e të cilave, i ka diktuar Hahni, por me metoda të rrepta gjuhësore i ka trajtuar Norbert Jokli. Pavarësisht nga arritjet e gjertanishme edhe më tutje një ide gjithëpërfshirëse për fushat gjuhësore marrëdhënëse ende nuk janë ndërtuar. Eqrem Çabej ka ofruar një numër të caktuar izoglosash, si: “*mat buzë lumi, breg deti*”, top. *Lumi Mati* (treva përkatëse *Matja*), e afërt me irland. *Math* “*rërë, kum*”; e barazon me çek. *Metuja*, degë e lumit të Elbës⁶⁶. Nga aspekti gramatikor i ndërtimit Çabej gjen edhe një varg krahasimesh. Emrave *Dukát, Filát*, sipas Hahnit, në bazë të prapashtesave –*at* u përgjigjen sufiksive të ilirishtes –*ates*, që formon emra fisesh (*Dalamatae*,

⁶⁵ Buletin de la Societe de Linguistique XIII, 406. Cit. nga Çabej, SGJ, IV, f. 391.

⁶⁶ Eqrem Çabej, *Disa izoglosa kelto-shqiptare*, botuar së pari gjermanisht në “Studi linguistici in onore di Vittore Pisani”, 1969, I, f. 167-186, ndërsa e botuar për herë të parë shqip në “Studime filologjike”, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1973, XVII(X), nr. 2, f. 49-61. Cit. nga E. Çabej, *Studime gjuhësore*, IV, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 378.

Docleatea), etnika (*Olciniatae*, *Sapuates*) dhe emra visesh, *Lamatis*, *Aemate*, dhe në këtë mes mund të krahasohen me keltishten, me emrat etnikë si *Tolâsates*: *Tolosa*, *Atrebatas*, *Tarusates*, ndërsa në shqipe formon emra vëllezërisht e fisesh: *Bakiri*: *Bakirat*, *Demi*: *Demat*⁶⁷.

Nga këto njësi leksikore e onomastike, Profesor Çabej ka nxjerrë jo vetëm përfundime për fonetikën historike të shqipes, por edhe të gramatikës historike të saj, si dhe ka vlerësuar se izoglosat shqiptaro-kelte përfshijnë “kryesisht fushat e një ekonomie dhe të një mënyre të thjeshtë të jetesës, që është më afër dhe më fort me natyrën, si dhe rrokin kështu botën e drurëve e të bimëve, visoren e blegtorinë, pjesët e trupit dhe leksikun e një karakteri më të përgjithshëm”⁶⁸, por këto nuk mjaftojnë për një sintezë të thellë monografike.

Në këtë rasë e tëra do filluar përsëri nga historia: “Dyndje fisesh të keltëve në Gadishullin Ballkanik, në rrjedhë të shek. IV dhe gjatë dhjetë vjetëve të para të shek. III, para erës sonë, ka pasur shpesh. Disa sish ngulen në këto anë përgjithmonë, si në viset perëndimore si në viset lindore të kësaj zone. Ndër këta mund të përmendim skordiskët, të cilët zunë viset në brendësitë e thella të Gadishullit, dhe u bënë kështu fqinjë veriorë të Dardanisë, pra të një treve”⁶⁹.

⁶⁷ Eqrem Çabej, *Disa izoglosa...*, po aty, f. 383.

⁶⁸ E. Çabej, *Emri i Dardanisë...*, SGJ, IV, f. 391.

⁶⁹ E. Çabej, *Disa izoglosa...*, po aty, f. 293-294.

Prandaj, me të drejtë Çabej mendon se këto leksema “mund të burojnë pjesërisht prej një periode ose protohistorike, ose pjesërisht prej një periode historike”⁷⁰. Prej këtu edhe përpjekja e tij që përmes këtyre hulumtimeve të marrëdhënieve gjuhësore kelto-shqiptare, të ndriçojë një kapitull të prehistorisë së shqipes duket shumë i rëndësishëm dhe i hapur për hulumtime të mëtejme.

Emri i Dardanisë dhe fisi i pirustëve

Mendimi i F. Nopçës, në fillim të këtij shekulli, se: oemri i fisit ilir të pirustëve përmban përkthimin në gjuhën latine të emrit të dardanëve (lat. *Pirus* “*dardhë*”)⁷¹ u përkrah dhe u arsyetua edhe nga E. Durham, A. Baldacci, e më tutje mbase nga e gjithë elita e albanologëve që shqyrtuan këtë problem nga aspekti gjuhësor: Eqrem Çabej në studimet interdisiplinare, Mahir Domi gjatë trajtimit të disa prapashtesave ilire, Idriz Ajeti kur trajtoi një lëmë toponimesh ndër to edhe mokrotoponimin *Qafa e Prushit*⁷², Moikom Zeqo duke u marrë me disa

⁷⁰ E. Çabej, *Disa izoglosa...*, po aty, f. 293.

⁷¹ F. Nopcsa, *Die Albaner*, “Sonderdruck aus der Wochenschrift Urania”, nr. 1 dhe 2, 1916, f. 5v. Cit. nga E. Çabej, *Studime gjuhësore*, IV, 390

⁷² Idriz Ajeti, *Gjuha shqipe dhe origjina e saj*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1994, f. 17, 23 dhe *Vepra*, 3, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1998, f. 162.

argumente autoktone të mitologjisë ilire, Rexhep Doçi⁷³, duke iu qasur një mal toponimesh e antroponimesh me bazë në etimonin *pir-* etj. Ky i fundit ka dhënë edhe një pasqyrë të zgjeruar shembujsh në fushë të onomastikës nga aspekti sinkronik dhe diakronik, bashkë me kalkimet në shtresimin diakronik të dalë qoftë brenda shqipes, qoftë në krahasim me gjuhët fqinje. Në këtë çështje, problem kyç mbeten patronimet dhe toponimet e krijuara sipas emrit të bimës *pir* »*tricum spelta*» brenda etnikumit të shqipes, të cilat sigurisht janë të vona dhe ndërtimi dialektor, fonetik e gramatikor i tyre e tregon më së miri këtë, madje edhe kur kemi të bëjmë me simbioza shqiptaro-vllehe, shembujt konkretë për të gjithë veç e veç ose të përbashkët mbase më së miri i ka dhënë Skënder Gashi: *Këlkerja, Ledina e Këlkerave, Kurvalla, Ripa, Gusha* (në fshatrat Junik e Batushë të Gjakovës), *Pukë*⁷⁴, *Shtatuli* (në fshatrat Rrenc e Blaç të Dragashit), *Cibrina, Piceli* etj., në fshatin Bajgorë) dhe në këtë rast nuk duhet përjashtuar edhe një dozë simbioze

⁷³ R. Doçi, *Ndriçimi i disa patronimeve dhe toponimeve Kosovare nëpërmjet Fjalorit të Majerit*, në vëllimin “Gustav Majer” (Sesion shkencor kushtuar 100-vjetorit të botimit të këngës kreshnike shqiptare), Prishtinë, më 15.XII.1997), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1998, f.78-84.

⁷⁴ Sikur dihet prejardhjen etimologjike të toponimit *Pukë* e ka trajtuar gjerësisht edhe Eqrem Çabej në studimin *Emri i Pukës*, në vëllimin e konferencës shkencore “Puka dhe shkolla”, Sesioni i parë për toponimet, Kabash, 21 maj , Pukë, 1977, f.8.

shqiptaro-vllehe, si: *Çyçylagë-a, Kopilig-i, Magurë-a, Negrovci-i, Qirez-i, Vragoli-a, Sharban-i* etj, të Prishtinës dhe të Drenasit, por edhe mikrotoponimet si: *Shtubeja, Karanoci, Nekshori, Stanistori, Kampula, Fratishi, Bulurdolli, Dërlupa*, të Prishtinës, Drenasit e Podujevës⁷⁵. Duhet parë këtu madje edhe një zhvillim paralel të emrave të toponimeve, si: *Makresh*⁷⁶ (Gjilan) nga rom. *makris* “uthull” dhe *Llapushnik* (Skënderaj) nga *lapushë*, “lëpjetë”: *uthull*.⁷⁷

Eqrem Çabej e ka vlerësuar drejt mendimin e gjuhëtarëve, të cilët më parë e kanë mbështetur mendimin e Nopçës. për përkthimin latin të emrit të Dardanëve (lat. *Pirus* “dardhë”) dhe e ka krahasuar me toponimin *Qafa e Prushit*. Edhe në dokumentet e lexuara nga Selami Pulaha, del fshati *Prushi*⁷⁸. Rexhep Doçi e ka zgjeruar pasqyrën e këtyre toponimeve e patronimeve jo vetëm në Kosovë, por

⁷⁵ Skënder Gashi, *Albansko-vlashka simbioza u svetlu onomastike*, në “Onomastica jugoslavica”, nr. 10, Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti –Razred za filologiju, Zagreb, 1982, f. 57.

⁷⁶ Begzad Baliu, *Etimologjia e toponimit Makresh*, në rev. “Shpresa”, nr. 6, Prishtinë, 1994, f. 14.

⁷⁷ Skënder Gashi, *Albansko-vlashka simbioza u svetlu onomastike, albansko-vlashka simbioza u svetlu onomastike*, në “Onomastica jugoslavica, nr. 10, Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti – Razred za filologiju, Zagreb 1982, f. 57.

⁷⁸ Selami Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovë gjatë shekujve XV-XVI*, Tiranë, 1984, f. 135.

edhe më gjerë: patronimi *Prushi* (*Hysen Prushi*), *Selman Prushi* (Gjakovë), *Halit Prushi* (Zylfaj), *Fshati Prushi* (Kaçanik), *Prushi*, patronim dhe lagje në fshatin Radivojcë të Vitisë, por edhe patronimi *Prushevë* (*Radossau Pruxeu –Pruxat*⁷⁹).

Pra, të gjitha të dhënat gjuhësore, shikuar në diakroni dhe sinkroni na çojnë kah prejardhja pa ndërmjetësim gjuhësor e patronimeve dhe toponimeve *Pirus*, *Pirustae në Prush*, ku *st<sht*, që tashmë paraqet një rregull të fonetikës historike të shqipes. Vijimësia, jo vetëm në toponimi e lidhjeve *Pirustae-Prush*, por edhe në patronimi, dëshmon për një kontinuitet të përcjelljes së patronimeve e toponimeve edhe në shkallë historike.

Toponimet, mikrotoponimet apo patronimet me bazë *Pir*, sot paraqesin vështirësi zgjidhjeje për shumë arsye:

Së pari, shumë toponime të lashta të arealit ballkanik që përfshijnë afritë ndërmjet shqipes dhe arumanishtes, që në të vërtetë mbulohen nga latinishtja vulgare e Ballkanit, dhe toponime më të reja, në aspektin gjuhësor kanë jetuar një kohë të lashtë historike, prandaj mikrotoponimi *Mali i Pirros*,

⁷⁹ Mihailo Diniq, *Iz dubrovackog arhiva*, I, Beograd, 1957, f. 67-68, cit. sipas R. Doçit, *Ndriçimi i disa patronimeve dhe toponimeve Kosovare nëpërmjet Fjalorit të Majerit*, në vëllimin “Gustav Majer (Sesion shkencor kushtuar 100-vjetorit të botimit të këngës kreshnike shqiptare), Prishtinë, më 15.XII.1997), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1998, f. 79.

Kodra e Pirros, dhe Lugi i Pirros në katundin Kukaj, nuk mund të barazohen me shtresën historike të *Qafës së Prushit (Pirustae)*, sepse edhe këto mikrotoponime do të mbaronin si *Mali Pirrosh, Kodra Pirrosh dhe Lugi Pirrosh*. Mendoj se këtu ka dy rrugë: ose fjala është për toponime të simbiozës vllahe (arumune) ose janë ndërtime të vonshme të shqipes, mbi bazë të emrit të fitonimit *pir- "tricum spelta"*, sidomos po të kihet parasysh apelativi i shqipes pirrak, që vjen me etimon nga po kjo bimë;

Së dyti, më duket jashtë çdo mundësie që sot të lidhim çdo ndërtim toponimik me *pirus-dardhë*, ose *dardhë-krushka* ose ndonjë simbiozë tjetër të ngjashme, derisa fjala *dardhë* edhe fjala *krushka* sikur edhe fjala latine *pirust* kanë bazë indoeuropiane. Çështje mbetet vetëm identifikimi i vendbanimeve, nëse vërtet ato vendbanime i takojnë së paku mesjetës së hershme apo antikitetit. Në këtë zonë ballkanike, sipas njohurive të gjertanishme historike, arkeologjike e gjuhësore që herët është i pranishëm elementi arumun, i cili është vështirë të ndahet nga elementi iliro-shqiptar i romanizuar me kohë krahas elementit arumun.

Këtu do shtruar edhe një herë hipotezën për paralelen historike ilire të emrit *Dardani* dhe latinishtes *Pirustae*. Fakti se keltët u shtrinë në një trevë më të gjerë se sa *Dardania*, d.m.th. se trashëgimia kulturore (materiale dhe shpirtërore) është origjinale në tërë trevën e Ballkanit. Çështja e ruajtjes së emrit të *Dardanëve* dhe *Pirustëve* njëkohësisht do lidhur me anën apelative, metaforike

të gjuhës së latinëve, jo për vendin po për popullin. Prandaj edhe emri i tyre në kronika del më i pranishëm sesa emri i vendit. Në fund të fundit, hipoteza jonë nuk e lëkund dyshimin për praninë etnike iliro-shqiptare këtu, sepse, si toponimi Dardani (dardhë) ashtu edhe toponimi *Qafa e Prushit*, kanë pasur zhvillim fonetik sipas ligjeve të shqipes.

Shtresa sllave e toponimeve, kryesisht emra vendbanimesh edhe në Kosovë, nuk ka pse të ekzagjerohet, ose të ribëhet, e le më të përkthehet, por as edhe të lidhet me *Dardaninë* a *Pirustaan* historike.

Summary

The name of Dardania

In this paper the author raises once again his hypothesis on a historical Illyrian parallel the name Dardania and the Latin Pirustae. The fact that the Celts stretched on an area wider than Dardania, i.e. that the cultural heritage (both material and spiritual) is original in the entire Balkan area.

The question of preservation of the name of the Dardanians and Pirusteans should be linked through an appealing, metaphoric way of the language of the Latins not for country but for its people, therefore their name too comes it in chronicles more present than the name of the country. After all, our hypothesis does not throw doubt on the ethnic Illyrian - Albanian

presence here because both the toponym Dardania (dardhë) and the Qafa e Prushit had a phonetic development according to the laws of the Albanian language.

A Slavic strata of toponyms, mainly names of settlements in Kosova as well, should not be exaggerated or redone, much less be translated, as it is being done with the toponomy of Kosova, and it should not be linked to the pre-historic Dardania or Pirustae, "either".

SHQIPËRIA, KOSOVA DHE GJUHA SHQIPE NË BOTIMET ENCIKLOPEDIKE

Rezyme: *Vitet e fundit është diskutuar mjaft shumë lidhur me paraqitjen e shqiptarëve dhe historisë, gjuhës e kulturës së tyre në Enciklopedinë maqedonase. Por, a është kjo vepra e vetme ku shqiptarët dhe kultura e tyre paraqiten në mënyrë të shtrembëruar. Kjo është arsyeja pse vitet e fundit kemi gjurmuar në disa vëllime enciklopedike të gjuhës, historisë, kulturës dhe traditës, të botuara kryesisht në Europë dhe në Amerikë, ku shqiptarët, për fat të keq, kryesisht me fajin e tyre, përfaqësohen pa ato konditat elementare të një populli të lashtë dhe pa atë pasuri materiale e shpirtërore që e kanë trashëguar deri në kohën tonë.*

Fjalët nyjë: *shqiptarët, gjuha, historia, kultura, enciklopedia, leksikoni*

HYRJJE

Dy vjet më parë në Shkup u botua *Enciklopedia maqedonase*, kundër së cilës reagan shumë individë, shoqata dhe organizata të tjera joqeveritare, institucione kulturore, arsimore e shkencore kombëtare e ndërkombëtare, institucione qeveritare e diplomatë shqiptarë në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri, si dhe diplomatë perëndimorë, kryesisht amerikanë dhe anglezë, për shkak të deformimeve të të vërtetave politike, ushtarake e diplomatike.

Në të vërtetë mënyra se si u organizua reagimi kundër *Enciklopedisë maqedonase* tregoi gjithë amullinë tonë, gjithë mosorganizimin tonë institucional kulturorë, arsimorë e shkencorë, diplomatik e strategjik kombëtar, për t'iu dhënë përgjigje veprave shkencore e enciklopedike, të cilat më parë se sa pretendime individuale e institucionale kanë përmbajtje intelektuale, akademike, kombëtare e shtetërore të fqinjit tonë të parë. Pas reagimeve 'kryesisht për shtyp' të institucioneve tona akademike, u deshtë që të merrte iniciativën një Organizatë Joqeveritare, për të mbledhur një grup studiuesish të vullnetit të mirë, që t'i jepte përgjigje kësaj vepreje⁸⁰, e cila më parë se sa për shkak të

⁸⁰ **Enciklopedia e ndarjes** - *Marrëdhëniet shqiptare-maqedonase - konteksti i Enciklopedisë së Maqedonisë. Kumtesa të Tribunës shkencore të organizuar nga Instituti Alb-Shkenca, mbajtur në Prishtinë, më 7. 10. 2009. Botoi Instituti Albshkenca, Prishtinë, 2010, f. 124. Kumtesa të Tribunës shkencore të mbajtur në Prishtinë, më 7. 10. 2009,*

reagimit të opinionit shqiptar u ndalua për shkak të reagimit të diplomacisë anglo-amerikane.

Por, a është kjo vepra e vetme ku shqiptarët dhe kultura e tyre paraqiten në mënyrë të pakënaqshme. Kjo është arsyeja pse vitet e fundit kemi gjurmuar në disa vëllime enciklopedike të gjuhës, historisë, kulturës dhe traditës, të botuara kryesisht në Europë dhe në Amerikë, ku shqiptarët, për fat të keq, kryesisht me fajin e tyre, përfaqësohen pa ato konditat elementare të një populli të lashtë dhe pa atë pasuri materiale e shpirtërore që kanë trashëguar deri në kohën tonë.

Kumtesën tonë e kemi realizuar duke u mbështetur në disa botime të karakterit enciklopedik gjithëpërfshirës anglo-amerikan, në disa botime enciklopedike të fushës së linguistikës së përgjithshme, në një botim historik të Lindjes, në dy botime historiko-enciklopedike për shqiptarët në Europë dhe Amerikë, në një botim historiko-letrar për Ballkanin, në një botim për emigracionin etj. Vlerësimi për shqiptarët, gjuhën shqipe, historinë dhe kulturën materiale e shpirtërore në këto botime, dhe për Kosovën në veçanti, do të mbështetet në parametrat metodologjikë të njësive apo sytheve enciklopedike, vëllimin e tyre, formatin e tyre, përbërësit e të dhënave dhe kuptimet e tyre, proveniencën e mbështetjes së të dhënave, bibliografinë, respektivisht referencat dhe autorët e teksteve të tyre, si dhe

në temën: *Marrëdhëniet shqiptare-maqedonase - konteksti i Enciklopedisë së Maqedonisë.*

krahasimet e diskutueshme me shtete, popuj dhe kultura të fqinjëve, po në të njëjtat botime.

SHQIPËRIA

Zëri *Shqipëria* në botimet enciklopedike të dy dekadave të fundit përgjithësisht del në forma të ndryshme, por në të gjitha rastet e varfër, si vëllim, si përmbajtje, si koncept gjeografik, politik, historik, etnografik, kulturor e bashkëkohor. Në *Enciklopedinë e përgjithshme të Oksfordit*, siç thuhet, njëren prej enciklopedive më të besueshme në botë, me mbi 20.000 zëra, botimi i vitit 2005, i të cilës është përkthyer edhe në gjuhën shqipe një vit më vonë, Shqipërinë e paraqet në katër paragrafë, si një vend të varfër, me tokë kënetore, me ekonomi të paplanifikuar dhe me një histori po kaq të varfër, e cila fillon me shekullin XIV, Perandorinë Osmane, përkatësisht Ali Pashë Tepelenën dhe poetin anglez Bajronin, për t'ia dhënë gjysmën e hapësirës kohës së komunizmit dhe postkomunizmit, deri në vitin 1997 (f. 1207-1208). Deri sa Serbia, në më pak hapësirë paraqitet si një shtet që paska qenë “i pavarur që ë shekullin IV”(f. 1121), por “u pushtua nga turqit në shekullin XIV” (f.1121), për Shqipërinë nuk thuhet asnjë fjalë për antikitetin, mesjetën, periudhën e Skënderbeut, Pashallëqet autonome Shqiptare etj.

Zëri *Shqipëria*, nuk ka fat më të mirë as në *Enciklopedinë britanike*, njëren prej enciklopedive më të vjetra në botë (1768), ndërsa ne e kemi konsultuar

botimin e vitit 2002, versionin alfabetik të referencave themelore, versionin tematik dhe versionin elektronik të vitit të fundit (<http://www.britannica.com> /bps/search? query= Albania &blacklist=12472).

Në *Enciklopedinë britanike zëri Shqipëria* (f. 206-208) paraqitet në rreth pesë shtylla. Brenda tekstit të vëllimit alfabetik ka një hartë të Shqipërisë së sotme, por as edhe një fotografi të vetme, ndërsa në versionin tematik (vëll. XIV. f. 612-618) është botuar një fotografi nga qyteti muze i Krujës. Shqipëria po kaq errët prezantohet edhe në versionin elektronik, si shtet i përbërë prej dy nëngrupeve kryesore: gegëve në veri dhe toskëve në jug.

Ndonëse një botim mjaft bashkëkohor dhe kapital për nga përmbajtja dhe vëllimi, me autorë dhe tekste të dekadës së fundit, Shqipëria si nocion gjeografik dhe politik e historik, nuk është për tu lakmuar as në një nga botimet e fundit akademike në Lindje. Fjalën e kam për botimin enciklopedik të veprës *Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman*, në të cilën Shqipëria nuk mund të krahasohet jo vetëm me vendin dhe përmbajtjen që i është dhënë Serbisë, po ndonjëherë edhe Maqedonisë e popullit maqedonas. Në kronologjinë e pasur historike të këtyre vëllimeve vendi i personaliteteve shqiptarëve theksohet vetëm në vitin 1463, kur shënohet ekspedita shqiptare e Mehmetit II dhe me vitin 1656, kur fillon periudha e sundimit të Familjes Qypriliu dhe heshtet deri në vitin 1910, kur theksohen Kryengritjet shqiptare, si dhe viti 1912, kur veçohet Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë. Le të kujtojmë

se po në këto vëllime vlerësohen si ngjarje të karakterit historik: fillimi i rebelimeve serbe (1804), autonomia serbe (1816) dhe madje “problemi armen” e “problemi maqedonas” (1878), Kryengritja e Ilindenit (1902) dhe viti kur Maqedonia fiton autonominë (1903). Për akademikët turq, në historinë e Perandorisë Osmane nuk ka asnjë domethënie as vlerë historike periudha e Skënderbeut, Pashallëqet Shqiptare të Janinës e të Shkodrës, apo së paku vlerë rebeluese, të cilën ua njohin serbëve po në këtë periudhë, Rrethimi i Krujës, si një prej momenteve të rëndësishme shtetërore, pushtimi i Shkodrës, si një prej momenteve të përcaktimit të kufirit perëndimor në Shtetin Otoman, dorëzimi i Ulqinit, si një prej fillimeve të ndryshimit të kufirit Perëndimor të Perandorisë Osmane me ndihmën e aleatëve europianë etj.

KOSOVA

Duke qenë një shtet i ri dhe me një moshë tepër të re të shpalljes së pavarësisë, që për botimet enciklopedike është pothuajse e papërfillshme, së paku si nocion gjeografik dhe historik, për Kosovën do të duhej të bëhej më shumë, që dobësitë të mos na dalin, qoftë edhe vetëm në gjuhën shqipe, ashtu sikur nuk del në botimin jo vetëm anglisht, por edhe në botimin shqip të *Enciklopedisë së përgjithshme të Oksfordit*. Enciklopedia më e besueshme në botë, e cila duket të jetë jo vetëm në vitrinat akademike, por edhe në tavolinat e publicistëve të botës, edhe në

vitin 2005, përkatësisht edhe në vitin 2006, kur botohet në gjuhën shqipe në Tiranë, zërin Kosova, e fillon me fjalinë “Krahinë në Serbinë Jugore” (f. 660). Brenda një paragrafi prej 12 rreshtash sa ka zëri për Kosovën, përjashtoj fjalinë e parë që përmban një mesazh gjeografik dhe historik njëkohësisht dhe fjalinë e dytë të karakterit gjeografik dhe etnik, pjesa tjetër është krejtësisht politike dhe paraqitet me gabime të mëdha lëndore e metodologjike, si këto: “Kosovës iu dha një shkallë autonomie nga qeveria e ish-Jugosllavisë më 1974, mirëpo pas konfliktesh etnike midis shqiptarëve (që përbëjnë mbi 75% të popullsisë) dhe serbëve (për serbët nuk thuhet për qindja, v.j.), qeveria serbe e shpërndau Kuvendin e Kosovës dhe imponoi sundimin e drejtpërdrejtë”.(660). Për autorin e këtij zëri, Kosova nuk ka qenë as nuk është nocion historik, gjeografik, politik dhe madje kulturor e etnik, por qenka vetëm një provincë serbe në jug, si edhe të gjitha provincat etnografike dhe kulturore serbe. Prej citatit të mëtejshëm del se Kosova nuk paska qenë nocion historik, gjeografik dhe madje etnokulturor që nga antikiteti e mesjeta dhe shtetëror nga periudha e Perandorisë Osmane, si dhe etnolinguistik, politik e ushtarak që në periudhën e Jugosllavisë mbretërore, por vetëm në vitin 1974 iu paska dhënë një autonomi, për t’iu marrë, jo si rezultati i përpjekjeve historike të shqiptarëve për çlirimin e saj dhe bashkimin me hapësirën tjetër etnohistorike, etnokulturore e etnogjuhësore shqiptare, por si rezultati i “konfliktit etnik mes shqiptarëve dhe serbëve”. Dhe për më tej, e shqiptarëve, që paskan një përbërje prej 75% të

popullsisë së saj. E palejueshme apo jo për një botim bashkëkohor, të cilit i beson bota dhe të cilin po me këtë gjendje ne kemi pranuar ta botojmë e ta shpërndajmë, si një botim tepër të besueshëm edhe në gjuhën shqipe e për lexuesit shqiptarë.

Ndonëse më gjerësisht, apo me karakteristikat historiko-gjeografike dhe etnike të një shteti, Kosova nuk e ka pamjen e duhur, as vendin e duhur dhe madje as vëllimin e duhur, as në *Enciklopedinë britanike*. Për zërin *Kosova* për nga vëllimi, kjo enciklopedi ka më pak tekst se sa bie fjala për secilin nga tre pashallarët e familjes Qypriju (vëll. XIV, f. 955). Zëri *Kosova* (955) ka tre paragrafë dhe shënohet në trajtën *Kosovo*, me vërejtjen “dikur (1946-71), KOSOVO I METOHIJA, or. KOSMET, outonomus pokrajina (province), brenda Republikës së Serbisë, Jugosllavi” (969-970). Për autorin e këtij teksti, Kosova nuk paska pasur trajtë tjetër, as trajtë tjetër në gjuhën shqipe, as organizim tjetër politik, ekonomik, shtetëror dhe madje ushtarak para vitit 1946, gjatë gjysmës së parë të shekullit XX, kur Kosova kishte strukturë organizative ushtarake dhe territoriale, as gjatë shekullit XIX, kur Kosova kishte organizim shtetëror të Vilajetit në Perandorinë Osmane dhe madje as në antikitet, kur Kosova ishte e organizuar në shkallë të mbretërisë ilire të Dardanisë. Përkundrazi, në këtë enciklopedi historia fillon me mesjetën serbe dhe trashëgiminë ortodokse të tyre, kryesisht kishat dhe manastiret, ndërsa, sigurisht për të shquar edhe më shumë përmbajtjen etnolinguistike të saj, të gjithë emrat e qyteteve shënohen në trajtën sllave: Dečan, Peč, Gračanica

etj. Është edhe një fakt në këtë zë, i cili rrënon besoj të gjithë parametrat e një enciklopedie me përmasa historike dhe besueshmërie e reference në botën e shkencës e të humanizmit njerëzor 200 vjeçar. Derisa në të gjitha rastet e prezantimit të hapësirave toponimike, ojkonimike dhe regjionale këto vende a vendbanime paraqiten me harta apo pamje vendbanimesh, për zërin Kosova, jo vetëm mungon harta, por në vend të saj prezantohet një pamje e Manastirit të Graçanicës, foto e Tanjugut, me një legjendë të pakkundndodhur në rastet e tjera: “Manastiri i Graçanicës në provincën autonome të Serbisë” (696). Në këtë zë, vetëm në paragrafin e tretë apo të fundit, përmenden shqiptarët katër herë, prej të cilëve, dy herë me cilësorin shqiptarë myslimanë.

Dua të theksoj këtu se pos zërit Kosova, po në këtë enciklopedi kemi edhe zëra për dy Luftërat e Kosovës (1389 dhe 1448). E para (970) prezantohet në tre paragrafë, si luftë serbo-otomane, ndërsa e dyta krahas imazhit krejtësisht të luftës serbo-turke, kujtohet edhe pjesëmarrja e Gjon Huniadit dhe Skënderbeut, si lider i shqiptarëve (970).

Po në këtë seri të *Enciklopedisë britanike*, emri i Kosovës jo vetëm nuk përmendet te zëri për Shqipërinë, po përkundrazi përjashtohet edhe aty ku do të duhej të theksohej doemos, apo edhe aty ku në rastet e tjera emrat e shteteve theksohen edhe në kontekst të gjendjes së tashme të organizimit politik të tyre. Kështu, tek paragrafi për gjuhën shqipe, brenda zërit *Shqipëria*, thuhet se gjuha shqipe

shtrihet edhe në pjesë të tjera të Ballkanit, por nuk përmendet emri i Kosovës, pavarësisht se theksohet emri i Greqisë, për të vazhduar më tej edhe me Italinë dhe madje Ukrainën! (207). Që Kosova vërtet përjashtohet në të gjitha mënyrat dëshmon edhe fakti se kur përmendet vendi i mbajtjes së Kongresit të Manastirit, të cilin autori e identifikon vetëm në kontekst të udhëheqjes së tij nga Gjergj Fishta, madje jo si një Kongres po si një tubim intelektualësh në Bitol, shton shënimin (Maqedonia e sotme), ndërsa kur përmend Lidhjen e Prizrenit, edhe kësaj radhe jo si ngjarje e veçantë historike, po në kontekst të drejtuesit të saj, nga njëri prej vëllezërve Frashëri, nuk e shton emrin e Kosovës, si hapësirë historike dhe gjeografike a shtetërore.

Përveç në botimin alfabetik edhe në botimin tematik të *Enciklopedisë britanike* emri i Kosovës shënohet krahas shpjegimit si regjion i Serbisë (vëll. XIV: 612).

Pozita e Kosovës është edhe më e varfër dhe madje më e shpërfytyruar në botimin elektronik të Enciklopedisë britanike. Shikoni vetëm sythat që e shquajnë përmbajtjen hyrëse të kërkimit për Kosovën, sipas radhës: Një histori e Ballkanit, vështrim i veçantë i konfliktit të Kosovës (1998-99), Beteja e parë (1389) dhe Beteja e dytë e Kosovës (1448), Konflikti në Kosovë, Muzeu i Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, UNMIK-u, Prishtina, Peja, Prizreni, Hashim Thaçi (kryeministër), Mali i Sharrit

(trajta latine), Dobrica Qosiq, Artet (referencë e marrë nga enciklopedia për Serbinë), Ismail Kadare, Ivan Meshtroviq, Rrafshi i Dukagjinit, Kulla, Fatmir Sejdiu (president), Manastiri i Graçanicës, Universiteti i Prishtinës, Malet e Gjeravicës, Kisha e Bogorodica Levishkës (Prizren), EULEX, Ibrahim Rugova (si shkrimtar kosovar dhe politikan), Qeveria (serbe), Konflikti në Kosovë (versioni i enciklopedisë serbe), Grupet etnike (nga zëri për Serbinë), Trendet demografike (nga zëri për Serbinë), Shteti (nga zëri për Serbinë), një artikull për vitet '70, nga zëri për Josop Broz Titon, Stefan Nemanja, Ati Pavle, Trendet demografike (nga zëri për Shqipërinë), Sigurimi (nga zëri për Slloveninë), Mali i Zi, Marti Ahtisari, Lugina e Ibrit, Shëndetësia dhe mirëqenia (nga zëri i Serbisë), dhe Lufta e Dytë Botërore (nga zëri për Shqipërinë)⁸¹.

Prej zërave të paraqitur kur më gjerësisht e kur vetëm formalisht, jo të zakonshëm për botimet enciklopedike të këtij formati, nuk është vështirë të kuptohet Kosova si një trashëgimi serbe dhe si një vend i dyzuar mes Serbisë dhe Shqipërisë. Si është e mundur që prej historisë së Kosovës të fshihet periudha e pasur e antikitetit, ndërsa prej Betejës së Parë (1389) dhe të Dytë (1448) të Kosovës, të mos ketë asnjë ngjarje tjetër deri te Lufta e Dytë Botërore (1941-1945)! Si është e mundur të përjashtohet pozita e saj shtetërore në kuadër të Perandorisë Osmane, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Luftërat Ballkanike dhe Lufta e Parë Botërore, pozita e saj

⁸¹ <http://www.britannica.com/ bps/search? query= Kosovo& blacklist= 322726>

juridike në ish-Jugosllavi etj! Si është e mundur që në Kosovë të identifikohen vetëm tri qytete, të cilat nuk përfaqësojnë njëkohësisht edhe të gjitha veçoritë e saj dhe si shpjegohet fakti që pothuajse të gjitha faktet e prezantuara (qytetet, krahinat etnografike, malet, fushat, etj.) janë marrë nga zona jugperëndimore e Kosovës, dhe si të shpjegohet fakti se të gjitha toponimet, ojkonimet etj., janë shënuar në trajtën latine?! Nuk paska Kosova fusha të tjera (si Fusha e Kosovës), nuk paska Kosova male të tjera në verilindje të saj (si Mali i Albanikut), nuk paska qytete antike (si Ulpiana) e mesjetare (si Artana - Novo Bërda), nuk paska Kosova vende të tjera turistike (si Shpella e Gadimes), të cilat do të duhej të zinin vendin e tyre në enciklopedi, krahas atyre që janë paraqitur! Janë më se të çuditshëm edhe përbërësit e tjerë të Kosovës në këtë Enciklopedi. Në Kosovë paska vetëm kisha dhe manastire serbe, por jo edhe institucione të tjera fetare: xhamia e teqe; në Kosovë nuk paska asnjë shkrimtarë, pra nuk qenkan shkrimtarë Esad Mekuli (bardi i letërsisë dhe kulturës në Kosovën e gjysmës së dytë të shekullit XX), Azem Shkreli, Din Mehmeti, Nazmi Rrahmani, Ali Podrimja, Rexhep Qosja, Hivzi Sulejmani, Jusuf Buxhovi, Mehmet Kraja, Emin Kabashi, Ymer Shkreli, Reshat Sahitaj etj. po u dashka të sillen shkrimtarë nga Serbia (Dobrica Qosiq), nga Shqipëria (Ismail Kadare) dhe madje një tjetër serb nga Amerika (Ivan Meshtroviq). E ndarë mes Serbisë dhe Shqipërisë edhe në këtë enciklopedi Kosova vazhdon të identifikohet sa me njërën sa me tjetrën, po asnjëherë me vetveten. Artet, shfaqen si pjesë përbërëse e

arteve serbe, trendet demografike, si pjesë e zërit të Shqipërisë (sigurisht për të identifikuar lindshmërinë e lartë) ndërsa grupet etnike, si zë i Serbisë, shëndetësia dhe mirëqenia nga zëri i Serbisë, ndërsa Lufta e Dytë Botërore, si zë i Shqipërisë, sigurisht për të dëshmuar anën e kundërt të lëvizjes çlirimtare. E marr me mend një zë në botimet enciklopedike për Kosovën edhe për Marti Ahtisarin, po Josip Broz Tito dhe nostalgjia për të, Stefan Nemanja, Ati Pavle dhe biografia e tyre, çka duan në këtë vëllim? Po Ibrahim Rugova si shpjegohet të paraqitet vetëm si politikan dhe shkrimtar, po jo edhe si president? Çka do të thotë njësia për *Sigurimin* nga zëri i Sllovenisë? Pse në strukturën e Kosovës duhet të hyjë Mali i Zi, por jo edhe Shqipëria apo Maqedonia. Pastaj, çka kërkon zëri Qeveria/ serbe, në Kosovë? Si e tillë Kosova nuk mund të thuhet se paraqitet as përafërsisht në qarqet intelektuale dhe shkencore të botës, e cila *Enciklopedinë britanike* e konsulton me shumë se asnjë botim tjetër të kësaj natyre.

Emri i Kosovës, si edhe më parë në botimet perëndimore, nuk e ka atë përmasë historike e gjeografike të cilën e njohim ne, as edhe në njërin nga botimet enciklopedike të dijes Lindore, në veprën *Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman*. Në kronologjinë e ngjarjeve më të rëndësishme të shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman emri i Kosovës identifikohet me Luftën e Kosovës (1389), të cilën autori i këtij teksti e ka shënuar si Fitorja e Kosovës, përkatësisht Martirizimi i Muratit I dhe Fitorja e dytë e Kosovës (1448).

GJUHA SHQIPE

Në botimet enciklopedike të karakterit politik, historik, gjeografik e kulturor, ajo që nuk mund të arrihet me përbërësit e tjerë, në një mënyrë a një tjetër arrihet me gjuhën shqipe dhe përmasën e shtrirjes së saj, sado edhe gjuha shqipe jo njëherë bie viktimë e koncepteve kur metodologjikisht të paqëndrueshme, kur politike, e madje edhe koncepteve nihiliste a konceptualisht krahinore, ideologjike e klanore të autorëve të zërave për të.

Gjuha shqipe, në zërin për Kosovën shënohet si gjuhë zyrtare krahas serbokroatishtes në faqen elektronike të *Enciklopedisë britanike*⁸², ndërsa në zërin për *gjuhët në Shqipëri*, në faqen elektronike sillet versioni i shtypur i saj, në të cilën thuhet: “Gjuha shqipe, gjuhë Indo-Europiane e folur në Shqipëri dhe me numër më të vogël të shqiptarëve etnikë në pjesët e tjera të Ballkanit jugor, përgjatë bregdetit lindor të Italisë dhe në Sicili, në Greqinë jugore dhe në Gjermani, Suedi, Shtetet e Bashkuara, Ukrainë, dhe në Belgjikë. Shqiptarët janë të vetmit pasardhës modern të një dege të veçantë të familjes gjuhësore indo-europiane”⁸³. Por sikur dihet, gjuha shqipe më shumë se sa në Jug të Ballkanit shtrihet në Veri të tij, e kjo do të thotë në Kosovë dhe në Maqedoni, Mal të

⁸² <http://www.britannica.com/EBchecked/topic/322726/Kosovo>.

⁸³ <http://www.britannica.com/EBchecked/topic/12542/Albanian-language>). Shih edhe variantin e shtypur, f. 207.

Zi e në Serbi, që këtu mënjanohet jo pa qëllim. Brenda saj është për të vënë re një ngulmim të autorit të tekstit për të shquar zonën gege dhe toske të Shqipërisë, identitetin gegë e toskë të shqiptarëve dhe dialektin gegë e toskë të gjuhës shqipe.

Megjithëse në zërin për gjuhën shqipe, duket sikur është shkruar më shumë në *Enciklopedinë e përgjithshme të Oksfordit*, edhe këtu janë një varg lëshimesh, të cilat kanë të bëjnë me afrinë e saj në lashtësi me gjuhët e vjetra, me ndikimin e saj në familjen ballkanike, me të ashtuquajturën mungesë të letërsisë së saj të vërtetë deri në shekullin XVII etj.(455)

Botimet me karakter shkencor ku shqipja zë një vend të merituar po i fillojmë me veprën më të popullarizuar të dy dekadave të fundit për gjuhësinë, të linguitit amerikan Dejvid Kristal⁸⁴, *The Cambridge*

⁸⁴ David Crystal (Holyhead, North Wales), lindur në Lisburn, Northern Ireland in 1941. Autor i veprave dhe botimeve enciklopedike: *The Cambridge Encyclopedia of Language* and *The Cambridge Encyclopedia of the English Language*. Recent books include *A Little Book of Language and Begat: the King James Bible and the English language* (both 2010) dhe autobiografisë gjuhësore, *Just a Phrase I'm Going Through* (2009). Co-autor i veprave *Words on Words* (2000), dhe *Shakespeare's Words* (2002) dhe *The Shakespeare Miscellany* (2005), *Around the Globe. Think On My Words, Prosodic Systems and Intonation in English* and *The English Tone of Voice*. His clinical books include *Introduction to Language Pathology, Profiling Linguistic Disability, Clinical Linguistics, and Linguistic Encounters with Language*

*encyclopedia of language*⁸⁵. Brenda këtij vëllimi gjuha shqipe diskutohet në mënyrë shumë serioze krahas gjuhëve të tjera për çështjen e arealit, si mjaft të definuar (33); për gjuhën shqipe në Kosovë, si për një gjuhë me pozitë autonome në nivel krahinor (37); për vendin që ia ka bërë në studimin krahasues gjuhëtari gjerman Franc Boppi, në rrethin e gjuhëve indoeuropiane (296); për citimin e lutjes në gjuhën shqipe: “Ati ynë që je në qiell”, krahas gjuhëve të tjera indoeuropiane (298); për shqipen e radhitur në vendin e parë në mesin e dhjetë familjeve gjuhësore indoeuropiane (300); për barrierat gjuhësore, përkatësisht gjuhët në gjendje kritike; për e radhitjen e gjuhës shqipe në mesin e 169 gjuhëve të rrezikuara në botë, që më 1985 (342); për pozitën zyrtare të saj në Shqipëri, por jo edhe në Kosovë e në Maqedoni (357) etj.

Gjuha shqipe zë një vend të merituar nga të gjitha anët edhe në një vëllim enciklopedik të gjuhësisë, botuar kohëve të fundit: Enciklopedia e

Handicap. His work for schools includes the Skylarks, Databank, and Datasearch programmes, Nineties Knowledge, Language A to Z, Rediscover Grammar, Discover Grammar, and Making Sense of Grammar etj.

⁸⁵ Dejvid Kristal, *The Cambridge encyclopedia of language*, (Cambridge: CUP, 1987), VII+472 pp. 0 521 26438 3; 0 521 42443 7. Kemi përdorur botimin e shtypur në serbokroatisht, *Kembricka enciklopedija jezika* (Beograd, 1996: Nolit), VII+474 pp.

gjuhësisë (*Encyclopedia of linguistics*)⁸⁶, në të cilën gjuha shqipe përfaqësohet si për përmasën e paraqitjeve të veçanta të zërave për të, ashtu edhe për përmasën e referimit të saj në kuadër të gjuhëve, arealeve gjuhësore, familjeve gjuhësore, strukturave dialektore, morfologjike, sociolinguistike, leksikore etj. Në zërin *Shqipja* (31) gjuha shqipe përkufizohet, si një nga gjuhët e familjes indoeuropiane, e dëshmuar kjo shkencërisht që në shekullin XIX, përmes zgjedhimit të foljeve të saj dhe të krahasuara edhe me foljet e gjuhëve simotra të indoeuropeanishtes. Gjuhës shqipe i përshkruhet edhe koncepti tashmë shkencor i pranuar në dijen e linguistikës, se ajo është pasardhëse moderne e ilirishtes, ndonëse tërhiqet vërejtja për mungesë dokumentesh të arealit shqiptar, por arsyetohet kjo me praninë e krahasueshme të fjalësit të shqipes së sotme me gjuhët e tjera indioeuropiane. Përshkrimi historik dhe aktual i shqipes në këtë vëllim enciklopedik do të mund të shquhej edhe për dy veçori, të cilat mungojnë në botimet e tjera simotra apo të përafërta me to. Në këtë vëllim, si rrallë kund tjetër, theksohet se shqipja flitet edhe në Turqi dhe jepet një numër aproksimativ për të gjithë folësit e sotëm të shqipes, prej 700.000 frymësh në Mal të Zi, Greqi, Turqi, Itali dhe Shtetet e Bashkuara. Po në këtë vëllim kujtohet

⁸⁶ *Encyclopedia of linguistics* / Philipp Strazny. Editor Published in 2005 by Fitzroy Dearborn. An Imprint of the Taylor & Francis Group 270 Madison Avenue New York, NY 10016. ISBN 1-57958-391-1 (set: alk. paper). ISBN 1-57958-450-0 (v.1:alk.paper). ISBN 1-57958-451-9: pp.31-34.

se shqipja standarde është miratuar edhe në Kosovë më 1968, por nuk theksohet as shënohet Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), edhe pse kujtohet në fund të artikullit se shqiptarët në Kosovë dhe Shqipëri kanë braktisur plotësisht dialektet e tyre. Për njësinë historike dhe gjeografike, e sociokulturore të saj ka rëndësi edhe përkufizimi i unitetit të saj: “Shqipja, thuhet në këtë vëllim, shtrihet në Shqipërinë e Veriut dhe bashkë me të folmen e Kosovës përbëjnë tërësinë e saj” (31).

Gjuhës shqipe i është bërë një vend i duhur dhe i merituar edhe në një enciklopedi posaçërisht të rëndësishme, botuar dekadën e fundit në tre vëllime. Fjala është për veprën *Encyclopedia of language and linguistics*⁸⁷, me redaktor Keith Brown (University of Cambridge, UK)⁸⁸, në të cilën gjuha shqipe (zëri për Shqipërinë), përkatësisht gjendja e tashme e saj,

⁸⁷ *Encyclopedia of Language and Linguistics* (ELL2)

⁸⁸ Keith Brown, University of Cambridge, UK. Keith Brown, ELL2 Editor-in-shefi. Veprat: *He is author of Linguistics Today* (Fontana, 1984) and co-author, with Jim Miller, of *Syntax: A Linguistic Introduction to Sentence Structure and Syntax: Generative Grammar* (Hutchinson, 1981). He was syntax editor for the first edition of the *Encyclopedia of Language and Linguistics* and was joint editor, with Jim Miller of *A Concise Encyclopedia of Linguistic Theories and A Concise Encyclopedia of Grammatical Categories* (Pergamon Press, 1997 and 1998). He was joint editor of *Common Denominators in Art and Science* (Aberdeen University Press, 1983) and *Language, Reasoning and Inference* (Academic Press, 1986).

është përshkruar duke filluar nga pozita e saj e sotme sociolinguistike, krahas zhvillimeve shoqërore e politike të popullit shqiptar, numrit të folësve të saj në Shqipëri dhe jashtë saj, shtrirjes gjeografike të saj, përdorimit të saj në institucionet elektronike dhe të shkruara, etj.

Autori i këtij zëri, kujton se gjuha shqipe është anëtare e trungut të familjes së gjuhëve indoeuropiane, por përpjekja e studiuesve për ta parë atë si të vetmen gjuhë të prejardhur nga ilirishtja ende nuk mund të thuhet se është vërtetuar, pasi mungojnë dokumentet në shkruara në lashtësi nga shqiptarët, prandaj të gjitha arsyetimet e saj deri më tash janë bërë duke u mbështetur në përmasën e përbërësve të saj në strukturat e përbashkëta të gjuhëve të familjes indoeuropiane.

Sigurisht, jo në të gjitha botimet enciklopedike gjuha shqipe e ka fatin e saj të mirë, që zërin për të ta shkruaj një mjeshtër i paanshëm i linguistikës. Fjalën e kemi për vëllimin enciklopedik *An encyclopaedia of language*⁸⁹, në të cilin shqipja, edhe kur injorohet, në

⁸⁹ *An encyclopaedia of language*, Edited by N.E.Collinge, London and New York, First published 1990, by Routledge 11 New Fetter Lane, London EC4P 4EE 29 West 35th Street, New York, NY 10001, *Routledge is an imprint of the Taylor & Francis Group* This edition published in the Taylor & Francis e-Library, 2005. Includes indexes. ISBN 0-415-02064-6 (Print Edition) 1. Language and languages. 2. Linguistics. I. Collinge, N.E. P106.A46 1989. 410–dc20 89–6203 ISBN 0-203-40361-4 Master e-book ISBN. ISBN 0-203-71185-8 (Adobe e Reader Format), f. 477.

paragrafin krahasues të grupeve gjuhësore, krahas grupit antolian, madje edhe në kuadër të figurës që e përcjell, nuk arrihet të injorohet në sythin për prejardhjen indoeuropiane të gjuhëve. Në këtë vepër mjaft të vëllimshme shqipen e gjejmë vetëm në pak shembuj, por shumë të rëndësishëm, siç është fjala shqipe *motër* e krahasueshme me anglishten *mother*, gjermanishten *Mutter*, greqishten *mātēr*, krahas shqipes së sotme *mëmë*⁹⁰.

Në vend të përfundimit

Duke e parë gjendjen aspak të denjë të Shqipërisë, Kosovës, gjuhës shqipe dhe trashëgimisë materiale e shpirtërore të popullit shqiptar e të qytetërimit të tij në disa botime shumë të rëndësishme enciklopedike, disa prej të cilave u përfshinë në këtë kumtesë të shkurtër për Javën e shkencës, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e quaj të rëndësishme që t'i theksoj disa rekomandime të veçanta dhe gjithëpërfshirëse:

- e para, shkencëtari shqiptar, duhet ndihmuar që të dalë nga praktika e angazhimit të tij vetëm mbi paradigmen e vullnetit të mirë, në dekadën e fundit të shekullit të kaluar dhe nga pozita sociale e dekadës së fundit që po e jetojmë;

- e dyta, institucionet, sidomos ato me karakter kombëtar, duhet nxjerr nga praktika e punës vetëm individuale e studiuesve të tyre, dhe prej tyre duhet

⁹⁰ Po aty, f. 480.

kërkuar që të marrin detyra të veçanta për nevoja të ngutshme të interesit kombëtar;

- e treta, Universiteti i Prishtinës, sa më parë duhet të fuqizojë angazhimin e stafit akademik sa në mësimdhënie, po aq dhe në hulumtime shkencore, duke i përkufizuar qartë nevojat e kërkimeve edhe të kandidatëve për master e studime të doktoratës edhe në interes të popullarizimit të shkencës kombëtare;

- e katërta, institucionet shkencore dhe arsimore të Kosovës dhe ato të Shqipërisë, sa më parë duhet krijuar programet afatshkurtra dhe afatgjata për realizimin e projekteve me karakter kombëtar dhe me ndikim ndërkombëtar, duke filluar me projektet e vogla (bie fjala me zërat enciklopedikë, për *Fjalorë* apo *Leksikonë* të përgjithshëm a të veçantë), deri te botimet enciklopedike të formatit të përgjithshëm;

- e pesta, meqenëse projektet e tilla realizohen shumë ngadalë dhe ndikimi ynë në veprat e karakterit enciklopedik ndërkombëtar mund të jetë i vonuar, duhet bërë përpjekje që t'i ndihmojmë kolegët tanë të angazhohen në projekte të kësaj natyre te botimet serike, sikur janë enciklopedia britanike, franceze, gjermane etj.

- e gjashta, institucionet tona akademike sa më parë duhet të vejnë kontakt me institucionet akademike europiane, që, për sa është e mundur, të plotësojnë, përmirësojnë dhe ndryshojnë disa artikuj të karakterit enciklopedik, së paku, të shpërndarë në formatin elektronik për Shqipërinë, Kosovën,

historinë, gjuhën, kulturën dhe trashëgiminë materiale e shpirtërore të tyre.

E nëse vërtetë duam t'i arrijmë këto qëllime, që në parim janë shkencore, ndërsa në koncept janë politike, presim që institucionet tona, të cilat i ndërtojnë politikat e shkencës kombëtare të lirohen prej instalimit nepotist, klanor dhe krahinor të shkencëtarëve për nevoja ditore, ndërsa nga shkencëtarët presim që angazhimin e tyre ta bëjnë mbi parimet etike të kërkimit shkencor. Vetëm kështu mund të realizojmë me kohë dhe në nivel kërkesat që shqiptarët dhe trojet e tyre kanë ndaj shkencëtarëve dhe institucioneve të tyre.

POLITIKA E STANDARDIZIMIT TË TOPONIMISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR

***(Political standardization of toponymy in the
Western Balkans)***

Hyrje

Studimet e gjertanishme në fushë të standardizimit të onomastikës kanë konstatuar një përpjekje shekullore të hulumtuesve dhe institucioneve të kohës për të krijuar një pamje standarde të vendbanimeve, porteve detare, institucioneve të shenjta dhe rrugëve detare e tokësore të globit (shih, *Kadmon* 2000: 123-143). Edhe koha e re ka vazhduar të ballafaqohet me problemin e emërtimit të vendeve dhe me problemin e pagëzimeve të reja, prandaj që në shekullin XIX ka filluar që intensivisht të ngrëjë institucione shkencore, kulturore dhe profesionale në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat kishin disa funksione: ruajtjen e trashëgimisë së mjedisit, kryesisht nga ndryshimet e mëdha që bëheshin me rastin e vendosjes së ndërlidhjeve të kolonive me botën moderne euro-

piane; emërtimin e saktë të vendeve të caktuara me interes të përbashkët për rrjetin tregtar, ekonomik, ushtarak, politik e strategjik; procesin e krijimit të standardeve në emërtimin e vendbanimeve, ishujve, deteve, portave detare e oqeanike, limaneve etj., për të gjitha vendet e botës, me theks të veçantë vendet europiane, të cilat kishin shumicën e kolonive në Afrikë, Azi dhe Amerikën Jugore (shih: *Cërrabregu* 1980: 86; *Kerfoot* 2000: 199-213).

Ballkani, si me historinë ashtu edhe me gjuhësinë (që është njëra prej përbërëseve të saj më të rëndësishme) paraqet një pasuri të madhe dhe shumështresore të Europës Juglindore. Më parë sesa mikrostrukturat e tij, problemin e inventarizimit të toponimisë dhe rrjedhëve të saj, në këtë proveniencë të Europës, e paraqet vetë emri i tij: Gadishulli Ilirik, Gadishulli Helenik, Rumelia, Gadishulli Ballkanik, Europa Juglindore dhe tash së fundi një tendencë e re për ndarjen e tij: Ballkani Perëndimor.

Hapësirën e përfshirë në studimin tonë e karakterizon një traditë e pasur dhe e thellë kulturore dhe po aq gjuhësore: trashëgimia paraindoeuropiane (Pellazgët), trashëgimia e familjeve indoeuropiane (Helenët, Ilirët, Trakët, Sllavët) dhe joindoeuropiane (Turqit); një shtresim i pasur kulturash të shfaqura më shumë se askund, në toponiminë: pellazge, ilire, greke, romake, sase, shqiptare, sllave (kryesisht serbe e bullgare), arumune, turke etj., por edhe një areal gjuhësor i përbashkët, i konstatuar jo njëherë me sintagmën gjuhësi ballkanike.

Sot, janë të rralla në botë shtresimet kaq të shumta e të thella kulturore brenda një tërësie gjeografike, sikur i gjejmë në Ballkan. Zor të gjendet një hapësirë kaq e vogël, e cila ka pranuar dhe ka rrezatuar një kulturë kaq të pasur në Europë, në Azi e më tej. Në këtë rrezatim, toponimia ka shënuar gjurmë të thella dhe të pasura. Ajo reflekton shenjat më të sigurt të zhvillimeve historike jo vetëm në arealin e Ballkanit, por edhe në arealin gjuhësor, historik e kulturor të Europës e të Azisë. Është e kuptueshme prandaj, pse ka shumë kohë që studimi i onomastikës, përkatësisht i toponimisë, paraqet një prej problemeve të shpeshta dhe shumë interesante në rrethet shkencore ballkanike dhe europiane. Ajo është bërë fushë e kërkimeve të shkollave dhe e drejtimeve më bashkëkohore të kohës; Ajo është bërë sinonim i kërkimeve historike, gjuhësore, kulturore dhe madje të vetë prejardhjes së një populli a të një tjetri në Ballkan; Ajo është bërë mjet i caktimit të kufijve të përshtirjes historike të popujve në këtë rajon në shekujt më të errët të historisë.

Por, në Ballkan si ndoshta askund tjetër, toponimia jo njëherë ka qenë shenjë e riciklimit të miteve të vjetra dhe e konflikteve të reja nacionale. Sikur të mos mjaftonte trashëgimia sa e pasur po kaq e errët, sa i përket prejardhjes, toponimia e Ballkanit disa herë, shekujt e fundit vazhdon të mbështillet me shtresa mitesh bashkëkohore.

GJENDJA E TOPONIMISË NË GREQI

Toponimia me theks në Çamëri

Gjatë fundit të shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX Greqia shfrytëzoi situatën politike dhe diplomatike të kohës, jo vetëm për të përzënë popullatën jogreke, por edhe për të ndryshuar trashëgiminë e saj me elemente kulturore e historike të proveniencës greke. Nuk ka dyshim se ndryshimet janë të mëdha, të shumta dhe të ndryshme, por kujtesa popullore, trashëgimia kulturore dhe historike i ka ruajtur dhe duke mos qenë këto ndryshime të largëta, vazhdon t'i ruajë të freskëta në përditshmërinë e tij, pavarësisht nëse jeton në ato vendbanime apo jo.

Mbledhësi i pasionuar i trashëgimisë gjuhësore, kulturore, etnologjike, folklorike dhe historike të popullatës çame të dëbuar në Shqipëri që nga Kriza Lindore e deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, Fatos Mero Rrapaj ka sistemuar dhe ka botuar një pjesë të paçmuar të toponimisë dhe mikrotoponimisë shqipe në krahinën e Çamërisë, prej të cilës veç tjerash mund të konstatojmë, se në Çamëri, ashtu sikur edhe në shumë vende të botës, kultura shumështrësore dhe bilinguizmi gjuhësor kanë imponuar trajta dyfishe të toponimisë, si: *Mitka* (Mitika), *Moçali* (Nerohori), *Murto : Volta* (Sivota), *Njihuri* (Neohori). (Shih, Rrapaj 1995)

Prej kujtesës historike të popullatës shqiptare të dëbuar nga Çamëria dhe prej asaj të mbetur në vendbanimet e të parëve të tyre, arvanitase, nuk duhet të jesh etimolog për të kuptuar origjinën shqipe të toponimisë së krahinës së Çamërisë dhe asaj të shpërndarë në gjithë hapësirën e shtetit të sotëm grek, e cila është ndryshuar me emra të rinj të fjalësit grek me metoda administrative: *Ahuri i Likut* (sot Aj Varvara), *Birbili* (Ajdhoni), *Bulmeti* (Lelovë), *Gardhiqi* (Aj Jorjios), *Gorrica* (Stavrohor), *Guri i Kuq* (Kaçinolithari), *Gurrëza* (Anapaloklisi), *Hani i Xhumbes* (Dhafni), *Ledheza* (Lladhohori), *Lëkurësi* (Mesopotamo), *Lopësi* (Asproklisi), *Laurati* (Katavathra), *Lugati* (Agora), *Muri* (Pirji), *Palofshati* (Filat), *Peshtani* (Kriovrisi), *Popova* (Ajia Qiriaqi), *Rrëzanji* (Aj Jeojs), *Spatari* (Trikorifo), *Shënmëriza* (Ajia Maria), *Shënedjella* (Ajia Qiriaqi), *Shënikolla* (Ajos Nikolaos), *Shkëmbi* (Mili), *Tabani* (Themelo), *Vreshtat* (Ambelia) etj (Shih, Rrapaj 1995).

Administrata greke për të ndryshuar hartën gjeografike të tokave të okupuara nuk i ka kursyer as toponimet e vendbanimeve shqiptare, që ndonëse si strukturë gramatikore shqiptoheshin mbi parimet e gjuhës shqipe, për nga etimologjia ishin të provinencës orientale, arumune, sllave apo madje edhe italiane. Le të kujtojmë këtu një numër të madh toponimesh të kësaj strukture, të cilat tani janë zëvendësuar me toponime të reja: *Çefliku* (sot Kato Palioklisi), *Çifliku i Rajit* (Raji), *Dolani* (Jeroplatanos), *Draganji* (Ambelia), *Dragomia* (Zervohori), *Kushovica* (Marina), *Llabanica* (Ellataria), *Mangjari* (Qiparisos), *Stanova* (Mandhrotopos), *Topola* (Topoja), *Turkopa-*

Ilku (Qipseli), *Velani* (Hrisavji), *Vllahori* (Polidhroso), *Vojniku* (Prodhromi). (Shih, Rrapaj 1995)

Një njollë më vete në toponiminë e Greqisë paraqet standardizimi i saj në veri të këtij vendi. Fjala është për toponiminë sllave të zonës së Maqedonisë së Egjeut, për të cilën studiuesit maqedonas ngulin këmbë se është e tëra e proveniencës së gjuhës, historisë dhe trashëgimisë së tyre. Në këtë zonë studiuesit e onomastikës kanë identifikuar rreth 3000 ojkonime, mikrotoponime e oronime të ndryshme, disa prej të cilave mund të identifikohen edhe nga etimologët popullor, por që të gjitha sot janë standardizuar si emra të rinj të gjuhës dhe semantikës greke. Në këtë kumtesë po i shënojmë vetëm disa nga ojkonimet, oronimet dhe mikrotoponimet e kësaj zone: Бела Црква: Asproklicja: “Ασπρροκκλησιά; Aga Mahala: Agova Maala; Adali – Κατο Σηολαριον; Ак Бунар: Ασπροωρισι; Горно Κοτορι: Ανο Ιδρυσα; Горно Χρνε□επο: Ανο Γαρεφιον; Γρανι: Κριονεριοι Ιζωορ: Πιγι. Në të vërtetë, prej ojkonimeve të regjistrit të vjelë nga studiuesi maqedonas Todor Simovski, më shumë se sa me ojkonime sllave-maqedonase Maqedonia e Egjeut, është e pasur me ojkonime të fshatrave tashmë të shpërngulura me banorë të besimit mysliman (Симовски1978).

GJENDJA E TOPONIMISË NË SERBI

Toponimia si trashëgimi kishtare dhe shpirtërore mesjetare

Tradita serbe e ndryshimit të toponimisë shqiptare në arealin ballkanik është e gjatë dhe e njohur përgjithësisht në dokumentet, historiografinë dhe në kujtesën e banorëve të saj. Nëse kjo traditë në institucionet religjioze dhe madje në vetë ndërdijen kulturore serbe është bërë veçori karakteristike e tyre, në traditën shqiptare kjo veçori ruhet si një relik i përhershëm kërcënues për të djeshmen dhe të ardhmen e qytetërimit të tyre.

Duket qartë se nga koha e shtetit të Dushanit (një shtet i vazalëve serbë, shqiptarë e grekë ndaj tij) serbët, nën ndikimin e kishës së tyre në vijimësi kanë punuar në ndryshimin e toponimisë së tokave që i kishin nën sundim. Ky koncept, duket vazhdoi të veprojë edhe më tej në ndërdijen e tyre madje edhe në kohën e pushtimit osman, kur serbët filluan ta identifikojnë të kaluarën e tyre me mitin serb të mbretërimit mbi popujt e Ballkanit gjatë mesjetës. Marrëveshja ndërmjet pashait turk me prejardhje serbe Mustafa Saraxhulldin dhe kishës serbe për regjistrimin e vendbanimeve të Kosovës nën juridiksionin e saj, 500 vjet më vonë shënon një moment të pashoq, që ka përmbysur historinë dhe sot vazhdon të bartë përmasat tragjike të saj (Pulaha 1974, 1984). Për fat të keq, konceptet e tyre tradicionale dhe

historike i kanë ruajtur, i kanë përdorur e vazhdojnë t'i përdorin, kur më shumë e kur më pak edhe sot.

Përveç me konceptet e tyre tradicionale për të ndryshuar çdo emër që nuk përkon me gjuhën apo prejardhjen gjuhësore të tyre, përveç me konceptet kishtarë serbe për të regjistruar dhe identifikuar çfarëdo toponimi vetëm me origjinën sllave, serbët edhe në fillim të shekullit XX do të vazhdojnë që ndryshimin e hartës toponimike të arealit shqiptar në Ballkan ta bëjnë edhe me masa administrative shtetërore.

Ndryshimit të toponimisë së trojeve shqiptare të mbetura nën Jugosllavi, serbët tashmë nuk do t'i qasen vetëm me konceptet tradicionale e kishtarë, por edhe me përkrahjen e studiuesve dhe institucioneve shkencore të tyre. Mbretëria serbo-kroato-sllavene do të angazhojë studiuesit serbë me përmasa kombëtare, ballkanike dhe europiane, që nën përkrahjen e ushtrisë dhe policisë, të merren me studimin e etnokulturës shqiptare, e në këtë fushë të studiojnë edhe toponiminë e saj.

Udhëtarë, shkrimtarë, publicistë, diplomatë, gjeografë, gjuhëtarë etj., të njohur (Shih, Nušić: 1902, 1894; Urošević: 1965, 1975; Bajraktarević: 1960; Lutovac: 1972; Stijović: 1979; Pešikan: 1981; 1985, 1988: 81-87), do të shkruajnë dhe do të botojnë e ribotojnë vepra të përcjella me shënime për vendbanimet dhe popullsinë e Shqipërisë veriore në përgjithësi dhe Kosovën në veçanti, ndërsa në kuadër të Akademisë së Shkencave dhe Arteve Serbe (SANU), do të themelojnë një shkollë të njohur

me emrin “Naselije i porijeklja stanovništva”, e cila ka pasur dhe do të ketë edhe më tej pasoja për trashëgiminë tonë të djeshme dhe për rikthimin e saj në të ardhmen. Kjo seri, pothuajse zëvendësohet nga një seri tjetër mjaft e vëllimshme “Onomatološki prilozi”, (1979 -). Për botimin e kërkimeve të tyre një kohë të gjatë studiuesit serbë, të përkrahur edhe nga studiuesit maqedonas, veprat e tyre do t’i botojnë madje edhe në filialen e tyre të Shkupit. Bardi i tyre, ndërkaq, siç dihet, si për formimin e shkollës ashtu edhe për themelimin e metodës kërkimore saj, ishte studiuesi serb i shkollës franceze, Jovan Cvijiq. (Shih, Cvijić: 1906, 1911, 1966).

Duke u mbështetur në mitet e romantizmit kombëtar dhe në mitet e kohëve të reja, qeveria serbe ka krijuar një hartë të re dhe të paqëndrueshme të arealit shqiptar nën Jugosllavi. Kështu, duke u mbështetur në mitet e vjetra serbe, pushteti i jugosllav ka krijuar një sistem emërtimesh me paradigmë Luftën e Kosovës (1939): *Devet Jugoviq, Kosovo Polje, Orloviq, Obiliq, Llazarevë, Dushanovë* etj., ndërsa duke u mbështetur në paradigmen historike të saj ka krijuar një sistem tjetër, të riemërtimit të vendbanimeve të Kosovës: *Ferizaj: Uroshevac, Hani i Elezit*. Gjeneral Janković, *Fusha e Kosovës: Kosovo Polje, Kaličan* (në emër të gjeneralit serb Kaliçanin), etj.

Përpyekjet e politikës serbe për të ndryshuar toponiminë e arealit shqiptar të trojeve tona të mbetura nën Jugosllavi, deri në gjysmën e dytë të shekullit XX, lidheshin ngushtazi me shumë elemente

gjuhësore, kulturore, politike, historike, ushtarake etj., dhe kulmonin me përcaktimin largvajtës të serbëve për dëbimin e shqiptarëve të këtyre trojeve brenda kufijve politikë të Shqipërisë apo dëbimin e tyre në Turqi. Se sa i rëndësishëm ishte ky përkushtim për politikën kulturore, shkencore dhe shtetërore serbe, dëshmojnë veç tjerash edhe konkluzionet e një konference qeveritare, përkitazi me shpërnguljen e popullatës me prejardhje joslave nga e ashtuquajtura Serbi Jugore, e mbajtur me datën 1 tetor 1935, në Beograd. Në Ministrinë e Punëve të Jashtme që diskutuar edhe rreth shpërnguljes së shqiptarëve dhe lidhjes së një marrëveshjeje me Turqinë etj. Në këtë Konferencë qenë nxjerrë gjashtë konkluzione, tri prej të cilave po i veçojmë këtu:

“Shpërngulja duhet të rregullohet sa më parë me konventë speciale me Turqinë dhe Shqipërinë; Zbatimi i rreptë i të gjitha dispozitave mbi kolonizimin e viseve jugore, dhe *Të bëhet njëkohësisht edhe nacionalizimi i emrave gjeografikë*” (Osmani 2002: 37).

Pra, vetë fakti se njëri prej gjashtë konkluzioneve merret me *nacionalizimin e emrave gjeografikë*, dëshmon se përkushtimi i politikës serbe për të ndryshuar, në të vërtetë për të sllavizuar hartën gjeografike të trojeve shqiptare ishte i rëndësishëm së veçantë.

Përpjekja e dështuar shtetërore

Pas Luftës së Dytë Botërore është bërë përpjekje që ndonjë element përmbajtësor i toponimisë së kësaj ane ose të ruhet ose të rikthehet në gjendjen e mëparshme, por pa bërë ndryshime të rëndësishme. Ndryshime nën ndikimin e lëvizjeve të fuqishme kulturore, shkencore dhe politike të shqiptarëve do të fillojnë të bëhen vetëm në fillim të viteve '70. Atë kohë qenë bërë disa përmirësime dhe përparime të dukshme në hartën toponimike të Kosovës dhe jo vetëm të saj. Amandamentet e miratuara në Kushtetutën e Jugosllavisë nga Qeveria e saj më 1971 (shih, Zbornik, 1984), lejonin për një përdorim më të saktë të toponimeve dhe sidomos për një përdorim në shkrim dhe shqiptim të mundshëm të tyre edhe në gjuhët e kombësive, për të cilat janë të merituar edhe përpjekjet e studiuesve shqiptarë në Kosovë (Shih, *Onomastika e Kosovës*, 1979).

Ndonëse disa herë nën ndikimin e shkollës serbe, si metodologji dhe si koncept politik, në fillim të zhvillimit të dijes së onomastikës si shkencë, studiuesit shqiptarë ishin të penguar për të thënë mendimin e tyre të plotë dhe të saktë. Gjatë kësaj kohe edhe nga studiuesit shqiptarë kanë filluar kërkimet në fushë të etnologjisë: për tërësinë e organizimit etnografik të Kosovës, krahinat e saj veç e veç, komunat etj. Vetëm viteve të fundit, njërit prej studiuesve të përkushtuar të etnogjeografisë së Kosovës, gjeografit Jusuf Osmani, i ka shkuar përdore që të bëjë kërkime afatgjate dhe të hapura në fushë të etno dhe antropogjeografisë, për të

dhënë një pasqyrë më të plotë të gjendjes së saj, në të vërtetë më të plotën deri më tash nga një studiues shqiptar (shih, Osmani 2003, 2004, 2005, 2006, 2008).

Duke u mbështetur në rezolutat e njohura ndërkombëtarisht, sidomos ato të viteve 1967 dhe 1973, në ish-Jugosllavi, që nga viti 1977 filloi procedura e formimit të Komisionit për Standardizimin e Toponimisë, të cilin duhej ta përbënin: Komisioni Federativ (si institucion koordinues i Qeverisë Federale dhe pa ingerenca të theksuara e me ndikim mbi politikën e standardizimit të toponimisë së republikave dhe krahinave jugosllave), dhe komisionet republikane e krahinore. Sipas udhëzimeve të sjella nga organet më të larta shtetërore, prej makrotoponimeve, mezotoponimeve dhe mikrotoponimeve, vlerësimit duhet t'i nënshtroheshin vetëm emrat e lokaliteteve – mikrotoponimet, ndërsa emrat e lagjeve vetëm duhej të standardizoheshin. Parimet ishin të përgjithshme, por edhe të detajuara: nuk kishte rëndësi prejardhja etimologjike e toponimit; secili toponim duhej shikuar dhe studiuar në mënyrë interdisiplinare nga gjuhëtarë, gjeografë, hartografë, historianë etj., kërkimet në terren dhe arkiva duheshin bërë në mënyrë paralele; duheshin marrë parasysh të gjitha trajtat e shkrimit dhe të shqiptimit, pavarësisht a ishin ato gjuhë zyrtare apo të minoriteteve dhe duhej dhënë përparësi gjendjes më të përshtatshme për të gjithë; duhej të caktohej kategoria e toponimit etj. Pritej që rezultatet e standardizimit të toponimisë edhe në arealin e banuar me shqiptarë të përfundonin me sukses (Petrica 1987: 4; Gosl 1988: 81-95).

Nga të gjitha komisionet, siç dihet, qe formuar vetëm Komisioni për Maqedoninë, vendimet politike dhe aspak shkencore të të cilit, siç dihet do të rrënojnë toponiminë e prejardhjes dhe shqiptimit në gjuhën shqipe. Në të vërtetë, më parë sesa të standardizonte toponiminë shumështrësore dhe shumëgjuhësore të Maqedonisë, ai Komision qe bërë laborator i sprovave të politikës kulturore, shkencore dhe administrative serbe nga Beogradi.

Komisionin e koncepteve serbe, të sprovuar në Maqedoni, Serbia do ta ngrrejë dhe zgjerojë jo vetëm në nivel qendror, por edhe në nivel komunal, me qëllim të përshpejtimit të ndryshimit të pasqyrës toponimike të Kosovës. Këtë e dëshmon njëri prej akteve juridike sistemore Ligji për Organizimin Territorial të Serbisë, në të cilin, veç tjerash, shkruan: sipas nenit 7 të këtij ligji “Qeveria e Serbisë mund t’ua ndryshojë emërtimin (toponimin) e vendbanimeve ekzistuese sipas përcaktimeve me atë ligj, pas mendimit paraprak të marrë nga kuvendi i komunës”. Me dispozitat e nenit 73 të Ligjit në fjalë, kuvendet komunale detyrohen t’i “rishqyrtojnë emërtimet ekzistuese të vendbanimeve dhe të caktojnë emërtime të reja në afat prej një viti nga dita e hyrjes së tij në fuqi”. Kjo do të thotë se, qeverisë serbe, i duhej vetëm një vit për të fshirë nga harta e Kosovës edhe gjurmët e fundit të toponimisë shqiptare (Osmani, 2002: 54).

GJENDJA E TOPONIMISË NË KOSOVË

Struktura e toponimisë

E parë si makrostrukturë socio-gjuhësore dhe historike, toponimia e Kosovës dhe Dardanisë përbëhet nga tri paradigma: etnike, e motivuar dhe në kontekst; ndërsa e definuar si mikrostrukturë (përgjithësisht e thelluar gjuhësore), kjo toponimi përfshin një areal më të gjerë (historik dhe gjuhësor) dhe një numër të rëndësishëm shtresash gjuhësore mbi të cilat është strukturuar etimologjia e saj.

Pra, në fondin e përgjithshëm të toponimeve të Kosovës, dhe më gjerë Dardanisë, në dy shekujt e fundit, si rezultat i ndërtimit të koncepteve nacional-romantike janë përplasur dy areale gjuhësore, kulturore dhe madje etnopsikologjike: ajo shqiptare dhe ajo sllave, në mes të të cilave qëndron dhe një shtresë tjetër: kontekstuale.

Fondi i moçëm i trashëgimisë iliro-shqiptare, si: *Llap, Gallap, Ulpianë, Therandë, Dardanë, Sharr, Vendenis, Bardosanë, Lumbardh, Naissus, Siparant, Margus, Bardarium, Scup* etj., është ndeshur me mitin e rikonstruktuar të fondit sllav të toponimisë së mesjetës: *Lazarevo, Miloševo, Obilič, Kosovo Polje, Uroševac* e *Gjeneral Jankovič*, për të cilin, veç dëshmimeve të romantizmit serb mbi luftën mesjetare të Kosovës, sipas burimeve ekstrashkencore serbe është vetëm një këngë që 'dëshmon të vërtetën' e tyre (Baliu 2004: 75-158).

Derisa fondi i moçëm i toponimisë shqiptare ubifikohet me shkrime dhe harta të antikitetit greko-romak, fondi serb i mesjetës në Kosovë shtresohet mbi toponiminë e leksikut iliro-shqiptar, roman, sasë a turk, të vendbanimeve të kolonizuara me serbë nga Serbia, Mali i Zi, Bosnja e Kroacia (Bajrami: 2002). Derisa fondi i toponimisë iliro-shqiptare homogjenizon konceptet postromantike të shqiptarëve në interes të ruajtjes së trojeve etnografike dhe monumenteve më të lashta materiale dhe shpirtërore të tyre; fondi sllav i rindërtimit të këtyre monumenteve në Kosovë, nuk ishte gjë tjetër veç një relikte e romantizmit serb, e fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Ai është vetëm vazhdim i një përpjekjeje të hershme që kisha serbe, duke shfrytëzuar autonominë e saj gjatë pesë shekujve të Perandorisë Osmane, ka ndër marrë për mbishtresimin e toponimisë vendore me toponime të prejardhura sllave. □

Fondi sllav i këtyre toponimeve me karakter identifikues për etnikumin e tyre ka qenë referenca më tipike e nismës së luftërave të reja shqiptaro-serbe dhe ballkanike, ajo ka qenë referencë e homogjenizimit etnik, ndërsa fondi shqiptar i toponimeve të tyre ka qenë referencë e identifikimit të autoktonisë së tyre dhe vlerave etno-historike e kulturës së lashtë gjuhësore. Toponimet monumentale serbe përgjithësisht kanë qenë shenja të kufijve nacionalë, sipas të cilave pushtetet serbe kanë krijuar slloganin “Deri atje ku gjendet një varr serb (e kjo do të thotë një mikrotoponim që identifikon atë varr) atje është Serbia“ (Drašković 1988), ndërsa toponimet monumentale shqiptare janë identifikuar si

trashëgimi kombëtare pa pretendimin që ato të identifikohen njëkohësisht edhe me kufijtë shtetëror dhe politik të tyre.

Demitizimi i toponimisë së Kosovës

Përpyqja e Këshillit për Standardizimin e Toponimisë së Kosovës, për të rikthyer gjendjen e mëparshme apo për të legjitimuar trajtën popullore të saj, është përpyqje për ta çliruar hartën e Kosovës nga mitet serbe, një mjet bazë me të cilin populli serb dhe institucionet e tij shtetërore, kulturore e shpirtërore e kanë sulmuar Kosovën. Dhe është e kuptueshme prandaj, pse serbët me këtë akt do të ndihen të sulmuar nga shkenca dhe kultura shqiptare. Studiuesit thonë se “kur sulmohet një nga mitet e një komuniteti, komuniteti në fjalë do ta ndjejë veten të sulmuar, do ta shohë atë si sulm ndaj themeleve të tij, që vë në pikëpyetje ekzistencën e tij”. (Përpyqja, 15-16/1999: 46) Në këtë rast, shkenca shqiptare politikën serbe ndaj Kosovës, besoj e ka sulmuar në thelbin e saj.

Toponimet mitike serbe janë mite mbi të cilat janë ndërtuar përpyqjet shfarosëse dhe të cilat edhe më tej gjenerojnë rreziqe të vazhdueshme për banorët e këtij rajoni dhe më gjerë; është e kuptueshme prandaj pse eliminimi i tyre është mënjanim i rreziqeve të përhershme, ndërsa ndërrimi i tyre ose kthimi në gjendjen fillestare paraqet mbyllje të përhershme të këtyre burimeve që shkaktajnë kriza permanente. Toponimet serbe të ndërtuara mbi mitin e Luftës së Kosovës (1389) kanë qenë shenjat më agresive

përmes të cilave ideologjia serbe e shekullit XIX dhe institucionet shtetërore, kulturore e shpirtërore serbe të shekullit XX, e kanë funksionalizuar atë. Besoj se, nëse Beteja e Kosovës, në fillim të Lëvizjes romantike serbe të gjysmës së parë të shekullit XIX ishte një konstruksion që i shërbente një miti, pas vendosjes së këtyre toponimeve në Kosovë, miti serb i kësaj beteje, mori të gjitha konstruksionet e një miti nacional në shërbim të një agresioni permanent dhe antihistorik. Sikur ndodh gjithmonë me mitet, edhe në këtë rast, ky është miti i përvojës kolektive serbe, prandaj duke mënjanuar këtë sistem toponimik Komisioni kreu një akt të shumëfishtë: ç'mitizoi njërin prej miteve më të rëndësishme të serbëve si kolektivitet, dhe çliroi nga prangat më irracionale të qindvjetëshit të fundit një kolektivitet të tërë. Mitet serbe përgjithësisht dhe miti i Luftës së Kosovës veçanërisht e kanë legjitimuar dhunën serbe në Kosovë. A do të arrijnë serbët që tërësinë e miteve të veta ta rrudhin brenda kompleksit të shoqërisë së sotme bashkëkohore, në interes të zgjedhjes jo vetëm të çështjes kombëtare serbe por edhe në interes të zgjedhjes së çështjeve kombëtare të kombeve të tjera në Ballkan. Nuk e di. E di ndërkaq, se me këtë ata do të kryenin një akt human në ndihmë lëvizjes së këtij procesi demitizues, në interes të përgjithshëm të serbëve si kolektivitet i mitizuar deri në iracionalitet dhe në interes të kolektiviteteve të tjera të Ballkanit (Baliu 2000a: 16; 2000b: 15-32; 2001: 18).

Struktura shumështresore e toponimisë së Kosovës

Një strukturë sa komplekse po aq edhe interesante për kërkimet interdisiplinare përbën shtresa linguistike, e kjo do të thotë shumëkulturore dhe etnolinguistike e toponimeve, hidronimeve dhe ojkonimeve të Kosovës, përkatësisht të Dardanisë antike:

g. “Onomastika ilire-shqiptare: *Ulpianë, Qafa e Prushit, Therandë, Gallap, Sharr, Drin*, etj., Te një shtresë më e vonë në Kosovë ruhet edhe një sistem i pasur i emërtimeve të vendbanimeve me bazë tek emrat e vllaznive a të fiseve të ndryshme: *Isnikaj* (Deçan), *Shkrel* (Pejë), *Gjergjicë e Stakaj* (Glllogoc), *Dashec e Baks* (Skënderaj), *Balaj, Burrnik* (Ferizaj), *Palabardh, Bardhaniq, Fshaj* etj. (Gjakovë), *Kopiliq i Epërm e Kopoliq i Poshtëm, Dashevc* (Skënderaj) etj.

h. Toponimia me bazë nga tradita greko-bizantine: *Glllogjan* (Deçan), *Mavriq, Mihaliq e Pantinë* (Vushtrri), *Manastirc, Papaz e Softaj* (Ferizaj), *Kolludra e Madhe* (Zubin Potok), *Tërpezë* (Viti), *Torinë* (Lipjan), *Mojstir, Syne* (Istog), *Likoshan, Vasilevë* (Drenas), *Likoc* (Skënderaj) etj.

i. Toponimia serbe e Kosovës: *Suharekë, Rahovec, Bistricë, Sitnicë, Novosellë* etj.

j. Emërvendet me prejardhje orientale: *Azizi* (emri i vjetër i Milloshevës së Obiliqit), *Hani i Elezit, Ballaban e Hajvali* (Prishtinë), *Karaçicë* (Shtimje), *Hamidi* (Obiliq), *Hatmaxha* (Prizren), *Qerim* (Gjakovë) etj.

k. Emërvendet me prejardhje latino-romane: *Makresh*, (Gjilan), *Magure* (Lipjan), *Rimanishtë* (Podujevë), *Beçuk* (Vushtrri), *Vllahi* (Mitrovicë), *Sibofc* (Obiliq), *Llukar* (Prishtinë), *Banullë e Magure* (Lipjan), *Turiçec*, *Mikushnicë* (Skënderaj), *Llajshec* (Prishtinë), *Llashticë* (Gjilan), *Llashkadrenoc* (Malishevë) etj.

Emërvende me prejardhje nga fisi gjerman i sasëve: *Shashkoc* (Prishtinë), *Shashkoc* (Podujevë), *Sazli* (Ferizaj), *Shashar* (Viti) etj". (Shih Baliu 1-2/2000: 71-80; Sejdiu 2002: 116-122).

Me gjithë këtë pasuri gjuhësore, Kosova do t'i falë një ditë Europës së re simotrën etno-kulturore të antikitetit europian, një freskë shpirtërore të temave universale të shkrimtarëve të vjetër grekë e romakë, të cilën populli shqiptar e ka ruajtur brenda traditës së tij mijëvjeçare, natyrisht për të hapur, njëkohësisht, sot edhe dilemën e përkatësisë shpirtërore të temave të këtyre veprave.

Zakonisht, në historinë e njerëzimit, luftërat gjithëherë kanë shkaktuar ndryshime të mëdha historike, kulturore, gjuhësore e etnografike të një populli a të një rajoni të caktuar. Ndryshime të mëdha në rirreshtimin e shumë shteteve me ndikim në rajon dhe të koncepteve të tyre me përmasa ndërkombëtare, ka bërë edhe lufta e Kosovës (1997-1999). Ajo ka sjellë ndryshime të thella në historinë e Kosovës, në aspektin e zhvillimeve të brendshme të saj, dhe përgjithësisht ka sjellë një rrjedhë tjetër të zhvillimeve qytetëruese në rajon. Ky realitet sot shihet edhe në fushë të toponimisë, e cila ka qenë

pengu më i madh i këtij qytetërimi për disa shekuj me radhë (Shih, *Regjistri*, 2004).

Toponimia e Kosovës ishte një prej elementeve kulturore e shpirtërore, e cila menjëherë pas përfundimit të Luftës së Kosovës (1997-1999) u sforcua si nevojë për rishikim dhe kërkonte përgjigje profesionale nga studiues e institucione shkencore. Në Kosovë, krahas ndryshimeve të mëdha është përmbushur edhe koncepti i njohur që më pare: gjuhët ndryshojnë kur ndryshojnë shoqëritë (Kristal, 1997: 5). Këtu, ndërkaq ka ndryshuar jo vetëm shoqëria, por edhe koncepti mbi të.

GJENDJA E TOPONIMISË NË MAQEDONI

Standardizimi i toponimisë në ish-Jugosllavi dhe prova e parë në Maqedoni

Përpjekjet e para për formimin e komisioneve republikane dhe krahinore për standardizimin e emërvendeve në Jugosllavi lidhen me Maqedoninë. Prej projekteve të komisionit maqedonas, prej qëllimeve të tij dhe prej rezultateve të para të tij, pavarësisht prej udhëzimeve dukshëm më të arsyeshme nga Komisioni Federativ, nuk është vështirë të kuptohet se koncepti i tyre ishte nxjerrë nga laborator i vjetër i Beogradit, me qëllim të mënjanimin të toponimisë tradicionale bilinge në trojet etnike shqiptare brenda Maqedonisë. Gjithashtu kjo sjellje e Komisionit të administratës maqedonase ishte vetëm një sinjal paraprak për rezultatet që duhej të priteshin

edhe në pjesën tjetër të toponimisë së arealit shqiptar në ish-Jugosllavi (Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi).

Sipas projektit të Komisionit Republikan të Maqedonisë, vendimet e të cilit shpejt do të bëhen të ligjshme dhe të referueshme jo vetëm në administratën e përditshme, por edhe në tekstet shkollore, toponimet shumëgjuhëshe në Maqedoni duhet të shkruheshin, duhet të shqiptoheshin dhe duhet të përdorreshin vetëm në gjuhën, përkatësisht, në trajtën e gjuhës maqedonase, si: *Shkup*: Skopje, *Tetovë*: Tetovo, *Ohër*: Ohrid, *Kërçovë*: Kiçevo, *Dibër*: Debar, *Manastir*: Bitola etj. Nëse këto vendime merreshin dhe imponoheshin dhunshëm për qytetet më të mëdha të vendit, për qytetet ku historikisht popullsia shumicë ishte popullsia shqiptare, sot mund të merret me mend se çfarë vendimesh janë marrë apo do të merren më vonë për hidroniminë, oroniminë, dhe mikrotoponimet e tjera anësore për opinionin, por të thella dhe shumë të rëndësishme për historinë e gjuhës dhe të vendit (*Gjendja*: 1987; Baliu: 1997, 2004).

GJENDJA E TOPONIMISË NË AREALIN SHQIPTAR TË MALIT TË ZI

Ndryshe nga politika maqedonase e standardizimit të emërvendeve dhe e ndalimit të antroponimeve me përmbajtje kombëtare shqiptare, politika malazeze në vendbanimet shqiptare të kësaj republike është treguar e përmbajtur dhe ka ushtruar

një veprimtari të prapavijës. Duke kamufluar një të ashtuquajtur tolerancë të skajshme të popullatës së përzier nga aspekti fetar dhe nacional(!), nën një gjendje të rëndë ekonomike, politika malazeze ka bërë që popullatës së kësaj ane t'i lejohej çdo gjë dhe të mos ndryshohej asgjë. Duke imituar simotrat e saj, Serbinë dhe sidomos Maqedoninë, administrata malazeze është kujdesur që toponiminë e vendbanimeve shqiptare, jo vetëm ta standardizojë duke u mbështetur në nevojat e përdorimit shumëgjuhësor dhe zyrtar, por edhe për nevojat e përmbushjes së idealeve hegjemoniste serbe, përjashtimin dhe fshirjen e shenjave identifikuese të kulturës autoktone të shqiptarëve në këto anë.

Prej toponimeve të standardizuara dhe të ndryshuara, si: *Krythë* (Krute), *Milla Katund* (Mide), *Katërkollë* (Vlladimir), *Sukubina* (Sukobinë); *Shtegvasha* (Podstegllah), *Kraja* (Kraina); *Hasçobaj* (Kovaçeviq), *Gjonikaj* (Gjeçbitriqi), *Kështenja* (Koshtanjica), *Thtjen - Ftjan* (Tejani), *Liarja* (Livari), *Selca* (Seoce), *Trieshi - Triepshi* (Zatrijebaç), *Nënhelm* (Podhum) etj., mund të shihet dhe mund të kuptohet se disa prej tyre ka qenë e arsyeshme të shënohen si dublete, por disa ndryshime të tjera janë bërë thjesht për të plotësuar konceptet serbe të politikës ditore. (Draga 1997: 126; Berjashi 1994a:7, 1994b: 1, 7).

GJENDJA E TOPONIMISË NË SHQIPËRI

Standardizimi gjatë sistemit komunist

Pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri janë bërë ndryshime të mbështetura kryesisht në natyrën e zhvillimeve politike dhe ideologjike të kohës. Sot nuk mund të përjashtohet ndonjë emërtim i ri i karakterit të trashëgimisë së antikitetit, si: *Drilon* (Valorekë) burim në afërsi të Pogradecit; apo nga tradita historike, si: *Bajram Curri* (Kolgecaj), i cili në esencë është me paradigme politike të brendshme dhe të jashtme (Bajram Curri ishte likuiduar nga qeveria e Ahmet Zogut, paraadhësit politik të Enver Hoxhës, ndërsa me vendosjen e emrit të tij në kufi me Kosovën, politika e kohës donte të tregonte përkujdesje anësore të shtetit shqiptar ndaj shqiptarëve të mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë), dhe të paradigmës ideologjike: *Qyteti Stalin*, *Fshati i Ri*, *Përparim*, *Fitore* etj.

Ndryshimet toponomastike në Shqipëri përgjithësisht kanë karakter të standardizuar, por nuk mund të thuhet se janë përcjellë nga një indiferentizëm nacional e gjuhësor, pavarësisht nga vija politike dhe ideologjike që i ka udhëhequr.

Në këtë rrjedhë mund të thuhet se janë ndryshuar toponimet, oronimet, hidronimet etj., pa përjashtuar krahina të veçanta dhe pa përjashtuar besime, shtresa sociale, kulturore e historike etj., duke ju përmbajtur disa paradigmave që në vija të trasha do të mund të ndaheshin në:

1. **Toponimet me përmbajtje fetare:** *Vërrin* (ish Shënvlash), *Përparim* (Shënvasil), *Kodra e Alfabetit* (Shëndilli), *Anëvjosë* (Shehaj), *Fushas* (Balhaxhias), *Bardhaj* (Hajdarbejas), *Miras* (Bozhigrad), *Bardhaj* (Bozhiq), *Burimas* (Shënmëri), *Çestije* (Haxhialiaj), *Çlirim* (Shënmërtir), *Demirxhias* (Shënkollë-Demirxhias), *Dritaj* (Manastirec), *Dritës* (Paping), *Erzen* (Shënëpremtë), *Fitore* (Shënkollas), *Fshati i Ri* (Dervishas), *Fushas* (Balhaxhias), *Fushë* (Shënpjetër), *Gurbardhë* (Shëngjergji), *Klos* (Haxhias), *Kodras* (Hixhaj), *Livadhaj* (Hoxhë), *Kodras* (Protopapë), *Kuben* (Vakuf) etj.

2. **Toponimet me përmbajtje zbuuese:** *Guri i Bardhë* (ish Qelbësirë), *Afrim* (Qenas), *Blerim* (Sakat), *Blerimaj* (Bullutaj), *Çlirim* (Murtajas), *Dritas* (Karaalibej), *Dritë* (Ferrë-Karicë), *Ilirias* (Përrenjas), *Luadh* (Keçerisht), *Lamollë* (Prapanikë), *Lezhë* (Lesh), *Pëllumbas* (Sëmuraj), *Goriçan –Çlirim* (Goriçan – Xhahil) etj.

3. **Toponime me prejardhje feudale, pra të padëshirueshme për sistemin politik të kohës:** *Adriatik* (ish Alibejas), *Agim* (Qifligu i Madh), *Vjosë* (Ahmetbejas), *Kodras* dhe *Burim* (Allajbeg), *Arrës* (Kadipashaj), *Fitore* (Imer Efendi), *Fshati i Vogël* (Kurt-beg), *Lumas* (Kadipashaj), *Kodër* (*Kalivja e Pashait*), *Neohor* (Kasëmallajbeg), *Urakë* (Kulla e Pashës), *Përparim* (Mahmut Aga), *Pllakë* (Memushbej), *Bregas* (Sallbeg), *Shqitas* (Çaushi), etj.

4. **Toponime të ndryshuara me paradigmë ideologjike të kohës:** *Dritë* (ish Ajnikollë), *Bukëmirë*, *Shqitas* (Çaushli), *Çermë-Shkumbin* (Çermë-Çiflig),

Jeta e re (Çifligu i Ri), *Agim* (Çifligu i Madh), *Diellas* (Shulin), *Lefter Talo* (Hadëraga), *Bardhaj* (Hajdarbejas), *Prruell* (Kaprruell), *Ndriçim* (Katund, Stratobërdë), *Një Maji* (Moglicë), “*8 Marsi*” (Papllukës), *Drithas* (Vloçisht), *Ullinjas* (Vrion, nga një familje e njohur e klasë politike shqiptare), *Grunjas* (Vërçun) etj.

5. Toponime të standardizuara thjesht me qëllim lehtësues të përdorimit: Pra, këtu standardizimi ka pasur funksion thjesht pragmatik: *Bubës* (Bubësi i Parë), *Malas* (Bubësi i Dytë), *Bletëz* (Shëmbërdhenji), *Gurtop* (Guri i Topit), *Bashkim* (Rreth-Fikth), *Krioner* (Kakogoranxi) *Kashisht* (Kallëm-Kashisht), *Kujtim* (Kurdaria e Poshtme), *Qafëbarë* (Qafa e Barit), *Qafëbotë* (Qafa e Botës), *Qafëbuall* (Qafa e Buallit), *Qafëkashtë* (Qafa e Kashtës), *Qafëkumbull* (Qafa e Kumbullës), *Qafëmal* (Qafa e Malit), *Qafëmollë* (Qafa e Mollës), *Liras* (Stori i Poshtëm), *Shtëpazë* (Lanabregas-Shtëpazë) etj.

Ashtu siç kanë vepruar shtetet fqinje edhe Shqipëria ka bërë ndryshime të toponimeve, të oronimeve e të hidronimeve, të cilat kanë pasur etimologji sllave, greke, italiane apo arumune, por ndryshe nga fqinjët e saj, të cilët toponimet i kanë ndryshuar kryesisht aty ku kishte banorë të nacionalitetit tjetër dhe kryesisht në krahina me përbërje etnike historikisht vendase, banorët e vendbanimeve në Shqipëri kanë qenë të përkatësisë shqiptare ndërsa ndryshimet janë bërë kryesisht me rastin e riorganizimit të vendbanimeve: bashkimit të dy

vendbanimeve apo themelimit të një vendbanimi të ri. Përtej saj, edhe nëse në ndonjë rast banorët e saj kanë qenë minoritarë, emri i ri në asnjë mënyrë nuk ka ardhur sipas një pardigme të theksuar nacionaliste dhe kulturore e hegjemoniste shqiptare.

Sot në Shqipëri nuk ka ndonjë përpjekje zyrtare apo e nxitur nga institucione shkencore dhe joqeveritare, për të ndryshuar toponiminë e vendit, por kjo nuk do të thotë se shqetësimet mungojnë për gjendjen e përgjithshme të saj. Si duket shqetësimet e mëdha të dala nga ndryshimi i dhunshëm i antroponimisë shqiptare nga qeveria greke, si kusht për të marrë vizat greke, si dhe një lëvizje mjaft e çoroditur e emërimit të porsalindurve shqiptarë, problemin e standardizimit të emërve të Shqipërisë postkomuniste e ka hedhur në plan të dytë. Pavarësisht nga kjo, në faqe shtypi dhe sidomos në faqe interneti diskutime të gjera janë bërë edhe për problemin e emërve të huaj, dhe madje jo vetë të tyre, në Shqipëri.

Literatura

Bajraktarević M., 1960,: *Rugova. Etnološka i antropogeografska proučavanja*. Beograd.

Bajrami H., 2002, *Rikolonizimi i Kosovës me serbë 1945-1948*, Prishtinë.

Baliu B., 1987, *Gjendja e onomastikës shqiptare në momentin e tanishëm*, Gjuha shqipe 1, Prishtinë.

Baliu B., 2000, *Jo ndryshim i emërvendeve të Kosovës, por standardizim i tyre*, Zëri i Kosovës, 28 janar 2000, Prishtinë, 1: 8-9; Gjuha jonë 1-2, 71-80.

Baliu B., 2000a, *Projekt shkencor me karakter historik*, në: Pasqyra, Prishtinë, 31 mars 2000, 16.

Baliu B., 2001b, *Ndihmesë diskutimit për standardizimin e emërvendeve të Kosovës*, Pasqyra, 5 mars 2000, 15-32.

Baliu B., 2004, *Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan*, Era, Prishtinë.

Baliu B., 2009, *Onomastika e Kosovës (Ndërmjet miteve dhe identiteteve)*, Prishtinë.

Baliu B. 2006, *Demitizimi dhe standardizimi i onomastikës së Kosovës*, Argeta, Tiranë.

Baumgartner E., Menard Ph., 1996, *Dictionnaire etymologique et historique de la langue française*, Paris.

Bellusci A., 1994, *Ricerche e studi tra gli arberori dell'Ellade – Kërkime dhe studime ndër arbërorët e Helladhës*, [në:] Da Radici arbereshe in Italia a matrici arberore in Grecia – Testi e dokumenti, Cosenza.

Berjashi I., 1994, *Harta turistike e Ulqinit në shqip me toponime në gjuhën serbe*, Kronika, Gazetë informative, 32/1994: 7.

Berjashi I., 1994, *Të kthehet gjuha e toponimeve shqipe*, Bujku, Prishtinë, 20 prill.

Çabej E., 1974, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Tiranë.

Carrabregu M., 1980, *Gjeo dhe hartolinguistika (Hartografia II)*, Prishtinë, 86.

Cvijić J., 1906-1911, *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje*, Beograd.

Cvijić J., 1966), *Osnove za geografiju Makedonije i Stare Srbije*, I-III, Beograd.

Doçi R., 1983, *Antroponimia e Llapushës (Prekorupës)*, Prishtinë.

Draga N., 1987, *Gjurmime gjeografike*, [në]: Art Club, Ulqin.

Gjendja..., 1987, *Gjendja e onomastikës shqiptare në momentin e tanishëm*, Gjuha shqipe, 1.

Gosl I., 1988, *Egzonimia historike (Kontribut qasjes teorike)*, Gjurmime albanologjike – seria e shkencave filologjike, 17/1987, 81-95.

Hoad T. F., 1996, *English etymology*, Oxford - New York.

Kadmon N., 2000, *Ptolemy - the First Ungegn, Toponymist - Commemorating the thirtieth anniversary of the First United Nations Conference on the Standardisation of Geographical Names*, *Onoma*, 35/ 2000: 123-143.

Kerfoot H., 2000, *Wien or Vienna; Kalaallit Nunaat, Grønland or Greenland? - Recent Work and Directions in Geographical Names Standardization through the United Nations*, *Onoma*, 35/2000: 199-213.

Krasniqi M., 1963, *Savremene društvene geografske promene na Kosovu i Metohiji*, Prishtina.

Krasniqi M., 1984, *Gjurmë e gjurmime*, IAP, Prishtinë, 1979; *Lugu i Baranit*, ASHAK, Prishtinë.

Krasniqi M. (red.), 1987, *Rugova*, monografi etnografike, libri i 6-të, Prishtinë.

Kristal D., 1997, *Enciklopedijski rečnik moderne lingvistike* (Oxford, 1985), Beograd.

Kristal D., 1997, *Kembrička enciklopedija jezika*, Beograd.

Lutovac M., 1972, *Geografski i političko-geografski značaj pokrajine Kosova u Srbiji*, Beograd.

Nušić B., 1902, *Kosovo, Opis zemlje i naroda*, I, II, Novi Sad.

Nušić B., 1902, *S Kosova na Sinje More. Beleške s puta kroz Arbanase 1894. godine*, Beograd.

Onomastika e Kosovës, 1979, *Onomastika e Kosovës*, Prishtinë.

Onomatološki prilozi, 1979, Srpska Akademia Nauka i Umetnosti, Beograd.

Osmani J., 2002, *Kolonizimi serb i Kosovës*, Prishtinë.

Osmani J., 2003, *Vendbanimet e Kosovës (1). Prishtina - Fushë Kosova – Kastrioti*, Prishtinë.

Pešikan M., 1981, *Iz istorijske toponimije Podrimlja*, Beograd.

Pešikan M., 1985, *O istorijskoj onomastici Kosova*, [në] *Zbornik okruglog stola o naučnom istraživanju Kosova*, Srpska Akademija nauka i umetnosti, Beograd, 81-87.

Petrica M., 1987, *Standardizimi i toponimeve në Jugosllavi*, Fjala, 1 shtator, 7.

Pulaha S., 1974, *Deferi i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, (Paraqitja, hyrja, transliterimi dhe komentet nga Selami Pulaha), Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Historisë, Tiranë.

Pulaha S., 1984, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI*, (Studime dhe dokumente), Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Historisë, Tiranë.

Regjistri..., 2004, *Regjistri i emërvendeve të Kosovës* (Përfundimet e Komisionit Qendror), Prishtinë.

Rikard S., 1969, *Enciklopedijski rječnik lingvističkih naziva*, I, II, Zagreb.

Rrapaj F., 1995, *Fjalori onomastik i Epirit*, Vëllimi I: *Çamëria*, Tiranë.

Sejdiu Sh., 2002, *Sprova etimologjike*, Era, Prishtinë.

Симовски Т., 1978, *Населените места во Егејска Македонија*, I, Скопје.

Stijović S., 1979, *Onomastika istočnog dela Metohijskog (Pećkog) Podgorja*, Beograd.

Urošević A., 1965, *Kosovo. Naselje i stanovništvo*, Beograd.

Urošević A., 1965, *Toponimi Kosova*, Beograd.

Zbornik..., 1984, *Zbornik radova savjetovanja o pitanjima standardizacije geografskih naziva u jezicima naroda i narodnosti SFRJ*, Savez Geografskih Društava Jugoslavije – Geografsko Društvo Bosne i Hercegovine, Sarajevo.

Kadmon, Naftali, 2000, *Ptolemy - the First UNGEGN Toponymist*, Commemorating the thirtieth anniversary of the First United Nations Conference on the Standardisation of Geographical Names, [Onoma](#), **Volume: 35**, ff, 123-143.

Summary

The Balkan region represents with its history and linguistics (which is one of its most important components) a great and manifold richness of the South-Eastern Europe. Before studying its microstructure it is the problem of the inventory of toponymy and its consequences which is represented by its very name: the Illyrian Peninsula, the Hellenic Peninsula, Rumelia, the Balkan Peninsula, South-Eastern Europe, and recently a new tendency for its separation by calling a part of it the Western Balkan, where the Albanian ethno-linguistic and cultural realm is a part. The space included in our research is characterized by a rich and deep cultural and linguistic tradition: the pre-Indo-European heritage (the Pelazgians), the Indo-European families heritage (the Hellene, the Illyrians, the Thracian, the Slavs), a rich stratification of cultures appeared more than anywhere in the “pelasgian” toponymy of Illyrians, Greeks, Romans, Sases, Albanians, Slavic (mainly Serbian and Bulgarian), Roma, Turkish, etc., as well as a common linguistic realm called more than once with the syntagma Balkanic Linguistics. Today in the world it is very rare to find such numerous and deep cultural stratifications within one unique geographical integral such as in the Balkan. It is very difficult to find such a small space which has accepted and radiated such a rich culture in Europe, Asia and elsewhere. Toponymy has marked deep and rich traces in this radiation. It reflects the most secure signs of the historical developments not only for the Balkan realm, but also for the linguistic, historic and cultural realm of

Europe and Asia. But in the Balkans, as nowhere else, toponymy more than once has been the sign of recycling the old myths and new ethnic conflicts. As if the rich and sometimes dark heritage for what regards the descent was not enough, the Balkan toponymy in the recent centuries continues to be convoluted with contemporary strata of myths.

HOMOGENITETI KOMBËTAR I ONOMASTIKËS SË ARBERESHËVE TË ITALISË (Pikëpamjet e Eqrem Çabejt)

Përkushtimi i përhershëm

Interesimi i Eqrem Çabejt për arbëreshët, historinë, kulturën dhe sidomos gjuhën e tyre ishte i përkushtimit jetësor, që nga fillimet e krijimtarisë së tij shkencore. Nëse interesimi i tij për kolonitë e tjera shqiptare në diasporë ishte i kufizuar kryesisht në aspektin e përgjithshëm historik (kontekstin shkencor) dhe vetëm në fillim të krijimtarisë shkencore (kontekstin krijues), interesimi i tij për koloninë shqiptare të arbëreshëve të Italisë ishte i përhershëm, si në kontekstin kohor ashtu edhe në atë të kërkimit të sintezave.

Interesimi i tij për arbëreshët e Italisë lidhet me krajetat historike të vendosjes së tyre në atdheun e ri, me historinë e shtrirjes së tyre kohore dhe hapë-

sinore në Italinë e Jugut, me historinë e lëvizjes kulturore, me historinë e gjuhës dhe sidomos me të folmet e krahinave të ndryshme, me historinë e folklorit dhe traditës gojore e të veshjes në përgjithësi, me traditën e krijimtarisë letrare, me personalitetet historike, me studiuesit e shkencave të ndryshme, me krijuesit letrarë, pra, me historinë e kulturës materiale e shpirtërore, ndërsa objekt i sintezës sonë janë përpjekjet e tij për krijimin e një onomastikoni diakronik, sinkronik e shtresues të onomastikës shqiptare në kontekst të onomastikonit të arbëreshëve të Italisë⁹¹.

⁹¹ Shih, studimet: *Italo-albanische Studien* (Studime italo-shqiptare). Dissertation zur Erlangung des Doktorgades an der Universität Wien. 1933, 143 faqe të daktilografuara. Kam konsultuar fotokopjen e doktoratës në gjuhën gjermane dhe përkthimin në dorëshkrim të dr. Skënder Gashit. *Tekste italo-shqiptare në Hyllin e Dritës*, në “Hylli i Dritës”, Shkodër, viti, XI, nr. 4, f. 196-206, prill 1935; *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, (me pjesë të zgjedhura për shkollat e mesme), Shtypshkronja e Ministrisë së Arsimit, Tiranë, 1936, f. 201; *Mundartliches aus Italien* (Elemente dialektore nga Italia), *Für die Krtschmer Festschrift*, “Glotta”, XVII, f. 50-57; *Albaner und Slaven in Süditalien* (Shqiptarët dhe sllavët në Italinë Jugore), në “Revue internationale des études balkaniques”, III, II, (6), f. 555-566, Beograd, 1938; *Shqiptarët në Itali të Mesme dhe në Napoli*, në “Hylli i Dritës”, XV, Shkodër, 1939, f. 542-546; *Atlasi gjuhësor shqiptar*. Pesë fashikuj. Pyetësorë, 2578 çështje, “Grottaferrata”, Roma. 1943; *Zum Worschatz der*

Interesimi i Eqrem Çabejt për arbëreshët lidhet me historinë e zhvendosjes së tyre nga trualli amë (i Shqipërisë apo i Greqisë), me vendosjen e tyre në atdheun e ri dhe me përhapjen në atë vend, me trashëgiminë materiale dhe shpirtërore të sjellë nga

albanischen Mundarten in Kalabrien (Një vështrim mbi leksikon e të folmeve arbëreshe të Italisë), “Serta romanica”, Tübingen, M. Niemeyer Verlag, 1968, f. 115-124; *Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre*, në “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike», Tiranë, 12-18 janar 1968, Tiranë 1969 (1970), vëll. III, f. 107-115; *Die Herkunftstfrage der albanischen Kolonien im Italien im Lishte vornehmlich der Sprache und der Eigennamen* (Çështja e prejardhjes së ngulimeve arbëreshe të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës e të emrave vetjakë), “Proceedings of the Eighth International Congress of Onomastic Sciences”, Paris, 1966, f. 70-81; *Disa burra të shquar të arbëreshëve të Italisë* (Nikollë Keta, Dhimitër Kamarda, Vinçenc Dorsa, Mikele Markiano, Pal Skiroi, Nilo Borxha, Marko La Piana) në “Revista pedagogjike”, nr. 4, Tiranë, 1974, f. 140-146; *Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë* në “Studime filologjike” Akademia e Shkencave e RPSSH, XXIX(XII), nr. 2, Tiranë, 1975, f. 51-69; *Su alcuni antichi elementi balcanici nell’Italia Meridionale e in Sicilia* (Mbi disa elemente ballkanike të lashta në Italinë Jugore dhe në Sicili), “Rendiconti del’Istituto Lombardo di Scienze e Lettere”, Classe di Lettere. Milano, 1965, vëll. 99, f. 214-220; *Gli italo-albanese e le loro pallate* (Arbëreshët e Italisë dhe të folmet e tyre), I, “Zjarri” (Il fuoco), viti VIII, nr. 1-2, f. 18-24, Roma, 1976, pjesa e dytë, viti IX, nr. 1-2, f. 3-16, Roma, 1977 etj.

atdheu mëmë dhe me ndryshimet që pësoi në atdheun e ri, me historinë e lëvizjes kulturore gjatë Rilindjes europiane dhe asaj shqiptare, me historinë e gjuhës, me përhapjen dhe zhvillimin e të folmeve dhe me krijimin e të folmeve të reja në treva të ndryshme, me historinë e etnografisë, me historinë e folklorit, mitologjisë dhe traditës gojore në përgjithësi, me krijuesit letrarë dhe me letërsinë e shkruar, me traditën e emërtimit të njerëzve dhe me krijimin e një fjalori shtresues e motivues në përgjithësi. Le të theksojmë se jo rrallë duke hulumtuar, përgjithësuar e sintetizuar një varg problemesh e rezultatesh për arbëreshët e Italisë, Çabej, shpesh ka përfituar një pasqyrë të re dhe të rëndësishme edhe për arvanitasit e Greqisë dhe shqiptarët e kohës në Shqipëri.

Vetëm kështu, me një metodë të zgjeruar ose globale, siç shprehej ai, mund t'i afrohemi këtij problemi, sidomos “duke kombinuar dëshmitë gjuhësore me të dhënat historike e të etnografisë; trajtat dialektore dhe emrat e familjeve, të vendeve e të shenjtoreve lokale, të ngulimeve me dëshminë e dokumenteve, të regjistrave kishtarë të tyre, me traditën gojore të gjallë në Shqipëri e në Itali, me elementet e kostumeve, të dokeve e të zakoneve, me disa motive të përbashkëta të poezisë popullore, e të

tjera si këto”⁹². Pra, sikur edhe në studimet e tjera, studimeve arbëreshe, Profesor Çabej, iu qas me një metodë të rreptë shkencore, së cilës i është përmbajtur që nga fillimi, deri të tekstet e fundit. Kjo metodë përcjell si studimet e kësaj fushe, ku trajtohet zhvillimi i brendshëm i procesit historik, gjuhësor, kulturor e material i arbëreshëve të Italisë, si ato studime që në një mënyrë të hapët trajtojnë marrëdhëniet ndërgjuhësore të të folmeve të arbëreshëve dhe gjuhëve ballkanike. Po kjo mund të thuhet edhe për fondin e trashëgimisë indoeuropiane që ajo përcolli, duke i bartur të konservuara nga gjuha nënë.

Historia

Tema e shpërnguljes së shqiptarëve përtej detit, është njëra prej ngjarjeve më të rëndësishme, me të cilën janë marrë një numër i madh studiuesish të historisë, gjuhësisë, folklorit, etnografisë etj. Shkaqet e këtij interesimi lidhen me shumë arsye historike, etnokulturore dhe ndërgjuhësore, jo vetëm të kolonisë së arbëreshëve të Italisë, kolonisë së arvanitasve të Greqisë, e popullit shqiptar në trojet e

⁹² Eqrem Çabej, *Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë* në “Studime filologjike”, Akademia e Shkencave e RPSSH, XXIX(XII), nr. 2, Tiranë, 1975. Cit. nga SGJ, V, f. 73.

veta, por edhe të gjithë zonës Mesdhetare dhe Europës Juglindore e Qendrore. Pra, arsyet e këtij interesimi janë të shumta.

Kjo është koha e rënies së këmbanës së fundit në Ballkan. Pas vdekjes së Skënderbeut, Europës i bie të ndërmarrë shumë aktivitete qytetëruese (politike, ekonomike, ushtarake, fetare e kulturore) për t'i shpëtuar dy qendrat kryesore, që gjendeshin para rrezikut: Romën dhe Vjenën, e të cilat i synonte Perandoria Osmane.

Këtë dëbim Çabej e quan me shprehjet 'shpërngulje', 'shkuarje', 'ardhës' (në Itali), 'grup iksish'. Të dëbuarit, ka konstatuar ai, janë jo vetëm nga Shqipëria e Jugut dhe Morea, një koloni e madhe shqiptarësh në Greqi, sikur thuhet shpesh në shkrimet e përgjithshme historiografike, por po të zgjerohet koha e shpërnguljes së tyre, (kur më pak e kur më shumë), prej tre shekujsh (XV-XVIII) mund të konstatohet se fjala është për një shpërngulje, e cila ka përfshirë tërësisht pjesën më të madhe të Shqipërisë.

Kjo dyndje, në atdheun e ri, ka bashkuar dy bashkësi të krishtera ortodokse të etnikumit shqiptar, dhe dy bashkësi etnike shqiptare të ndara shekuj më parë, por që kanë ruajtur pa dallim elementet

esenciale të etnisë: gjuhën, kulturën materiale dhe shpirtërore të tyre.

Kjo degë e ndarë me shekuj e trungut shqiptar, deri në ditët tona, ka ruajtur të konservuar një pjesë të mirë të qytetërimit mesjetar shqiptar, i cili në rrymë të kohës është evoluar në Shqipëri, sidomos pas okupimit nga Perandoria Osmane, prandaj në hulumtimet shkencore kjo trashëgimi ka qenë një objekt i rëndësishëm studimi në aspektin krahasues.

Ashtu si edhe studiuesit e tjerë, të cilët kur merren me studimin e kulturës shpirtërore e materiale të arbëreshëve të Italisë, nisen nga një faktor i vetëm: historik - rënia e shtetit të Skënderbeut, edhe Profesor Çabej, në studimet e hershme nuk përjashton këtë rrethanë të rëndësishme. Mirëpo, më vonë, me plot arsye ai nisët nga një pikë më e hershme historike, madje nga një parahistori etnike e gjuhësore e Italisë Jugore, kur shkruan se “Disa indicie llojesh të ndryshme, na dëshmojnë për Italinë Jugore e për Sicilinë dynjake, pak a shumë në masë popujsh me burime prej Gadishullit Ballkanik në perioda të ndryshme të parahistorisë”⁹³. Këto

⁹³ Eqrem Çabej, *Su alcuni antichi elementi balcanici nell'Italia Meridionale e in Sicilia (Mbi disa elemente ballkanike të lashta në Italinë Jugore dhe në Sicili)*, “Rendiconti del’Istituto Lombardo di Scienze e Lettere”,

elemente Eqrem Çabej i shihte para se gjithash te “një numër i konsiderueshëm mbishkrimesh dhe një material onomastik i pasur”⁹⁴. Nga i gjithë ky material, shkruante E. Çabej, “sidomos, janë të rëndësishëm emrat personalë e gjeografikë, që na shfaqen në të dy anët e bregdetit. Janë të rëndësishme sidomos rezultatet e mbishkrimeve mesapike”⁹⁵. Mirëpo sikur edhe në studimet e tjera historike e aq më pak parahistorike problemi shfaqet edhe këtu. Pra, si të bëhet krahasimi i gjuhëve të lashta të onomastikës mesapike me gjuhën (këtë herë me gjuhën shqipe), dëshmitë e së cilës janë shfaqur aq vonë në krahasim me gjuhët fqinje dhe të rajonit përgjithësisht. Pavarësisht nga kjo, Çabej, sikur edhe në shumë raste të studimeve gjuhësore, këtu gjen mbështetje te një mendim i Francesco Ribezzos, i cili, për të njëjtin objekt studimi, që më 1942, mendonte se “vërtetimi përfundimtar qëndron në përkimin leksikor, fonetik e morfologjik midis mesapishtes dhe

Classe di Lettere. Milano, 1965, vëll. 99, f. 214-220; I botuar për herë të parë në gjuhën shqipe, në “Studime filologjike”, Akademia e Shkencave e RPSH-IGJL, Tiranë, 1975, XXIX(XII), nr. 3, f. 9-14, Cit. nga “Studime gjuhësore”, IV, f. 396.

⁹⁴ E. Çabej, po aty, f. 396.

⁹⁵ E. Çabej, po aty, f. 396.

atij thelbi të gjuhës shqipe, që është me gjurmë indoevropiane”⁹⁶.

Orientimi studimor i Çabejt nga ky fakt u jep përgjigje disa problemeve të mëvonshme, që kanë të bëjnë me shpërnguljen e madhe (*Moti i madh*), pas vdekjes së Skënderbeut. Dëshmitë e lartpërmendura tregojnë se shpërnguljet as nuk kanë filluar dhe as nuk kanë mbaruar këtu dhe në këtë kohë, ndërsa shpërngulja drejt perëndimit nuk është bërë vetëm si rezultat i trashëgimisë, që kishte lënë Skënderbeu në Italinë Jugore e Sicili. Përkundrazi, që më parë, shpërnguljet e tilla ishin vetëm një vijimësi e lidhjeve, që mbaheshin mes popujve, kulturave e lidhjeve tregtare në mes dy bregdeteve deri në shek. XV. Dhe jo vetëm kaq. Kjo dëshmon ndoshta edhe më shumë për një lidhje shekullore të fiseve ilire në të dy brigjet e Adriatikut dhe të Jonit⁹⁷. Kjo lëvizje historike këtë

⁹⁶ F. Ribezzo, *Italia e Iliria preromana*, “Italia e Croazia” (1942), f. 22. Cit. nga E. Çabej, Vep. e cit. në “Studime gjuhësore”, IV, f. 397.

⁹⁷ Le të kujtojmë këtu edhe mendimin e Gustav Majerit për një trashëgimi më të hershme edhe të arvanitasve në More, kur thotë se: “Shqiptarët jetuan në Greqi edhe para vitit 1349, kur përmenden në Peloponez”. Shih: Gustav Majer, *Shqiptarët dhe gjuha e tyre*, në: “Bota shqiptare” (Libër leximi për Kursin e Nalt të Shkollave të Mesme), Botim i Ministris s’Arsimit, Tiranë, 1943, f.126.

herë në masë më të madhe nuk ndodhi vetëm pas pushtimit të Shqipërisë dhe të Moresë, edhe pse vërtet kjo shtypje zgjati me disa shkëputje tre shekuj, ndërsa këtë periudhë Çabej, në tezën e doktoratës, e ka ndarë në tri perioda. Profesor Çabej, në këtë rast ka veçuar edhe një element jo fort të theksuar në studimet historike dhe kulturore. Shpërngulja e arbërorëve atje ishte edhe në interes të pushtetit të kohës, sepse shqiptarët “u përdorën për të ripopulluar krahinat jugore të shkatërruara nga tërmeti i vitit 1456”⁹⁸. Po në këto studime Çabej ka kundërshtuar një element, të përsëritur shpesh në historiografinë dhe kryesisht publicistikën shqiptare, e cila, madje shpesh përsëritet edhe sot: “në Itali u shpërngul shtresa më e mirë intelektuale, shoqërore dhe sociale e popullit shqiptar”. Përkundrazi, duke e veçuar këtë element gjithësesi të rëndësishëm, Çabej, e ka theksuar vëmendshëm faktin se, pas pushtimit të Shqipërisë nga Perandoria Osmane, në Italinë e Jugut u shpërngulën të gjitha shtresat shoqërore. Këtë fakt pastaj e ka dëshmuar edhe me elemente të onomastikës, ku patronimet që vijnë me etimologji nga jeta sociale (zejtarë) ose jeta rurale (blegtorë), zënë një vend të rëndësishëm në pasqyrën e përgjithshme të patronimisë shqiptare.

⁹⁸ E. Çabej, SGJ, IV, f. 14.

Duke e mbyllur pjesën historike të çështjes së shtruar, këtu po e paraqes edhe një element të vënë re nga Çabej, e të paraqitur në shkrimet e para, po sidomos në tezën e doktoratës. Fjala është për një shtresë (ose “pjesë të hollë dhe të pavlefshme shqiptaro-sllave” – sikur e quan Çabej), e cila u paraqit në shek. XV në bregdetin italian dhe e cila u shkri në shekullin XVII⁹⁹. Në shkrimet e mëvonshme Çabej nuk e ka shquar këtë “element të rëndësi-shëm”, por sigurisht për shkak se ishte në fillim të studimeve shkencore, dhe sidomos për arsye se ishte nën ndikimit e ndonjërit prej studiuesve të mëdhenj të kohës (Stadmyller, Selishqev e ndonjë tjetër)¹⁰⁰, Çabej rrëshqiti jo pak, duke i bërë të vetat

⁹⁹ Shih E. Çabej, *Italo-albanische Studien* (Studime italo-shqiptare). Dissertation zur Erlangung des Doktgrades an der Universität Wien. 1933, f. 8-62; *Shqiptarët në Itali të Mesme dhe në Napoli*, “Hylli i Dritës”, XV, Shkodër, 1939, Cit. nga SGJ, IV, f.14.

¹⁰⁰ Kam konsultuar studimin e Dr. Georg Stadtmüller (Breslau), *Përhapja e vendbanimit të popullit shqiptar në fund të ?mjeskohës dhe në kohën e tashme*, botuar në “Leka”, nr. VIII-XII(nr. i veçantë), Shkodër, 1937, f. 583-594, që fatkeqësisht, pavarësisht prej nivelit të lartë të hulumtimit, autori sjell edhe shumë të dhëna të pavërteta për gjoja shtrirjen e popullit shqiptar drejt veriut dhe verilindjes, në toka të banuara nga sllavët!; mos të flasim pastaj për një veper me ndikim në krejt studimet sllave të këtij shekulli,

disa dobësi të studiuesve të huaj që këto veçori ua përshkruanin shqiptarëve të kohës. Mbase kjo është arsyeja pse Çabej, në studimet e mëvonshme jo vetëm hoqi dorë nga këto veçori historike-gjuhësore,

mbase deri në ditët tona, të cilën autori i mësipërm e citon madje në krye të punimit të tij: A. M. Selisçev, *Slavjanskoe naselenie v Albani*, Sofija, 1931, të cilës mentori i tij me kohë ia pat bërë një recension të gjerë, prej rreth gjashtëdhjetë faqesh. Këtu po i jap vetëm dy pasues të shënuar nga disertacioni i Çabejt, të përkthyer nga dr. Skënder Gashi: “Si në Nakonë dhe në Kampania, ashtu na dalin shqiptarët edhe në kontet (= territoret e kontëve) të Molises dhe Apulias, të përzier me sllavë, kështu që një ndarje e prerë ndërmjet këtyre dy elementëve popullorë është e pamundshme. Dhe Çabej në vazhdim e citon historianin Vitale Tomaseco, *Storia della regia città di Ariano e sua diodesi*, Romë, 1794, f. 408: “Pas gjithë gjasësh edhe serbokroatët u shpërngulen të njëjtën kohë kur edhe shqiptarët nga Shqipëria Veriore (në mesjetë në Shqipërinë Veriore kishte shumë më tepër serbokroatë se ç’ka sot!), si dhe nga krahina fqinje e Zetës, sidoqoftë tradita në Itali i lidh shqiptarët dhe sllavët njëri me tjetrin, me ç’rast ata (italianët) kolonitë e themeluara nga të dy popujt në Itali lidhen me emrin e heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastriotit” (*Studime italo-shqiptare*, f. 24). Ose një konstatim jo serioz i Çabejt të madh më vonë “Arbëreshët janë një copë Ballkani, në truallin italian, njëkohësisht një përzierje romane-shqiptare. Emri i vendit është jo vetëm një fjalë e përcaktimit më përfaqësues të nocionit gjeografik, porse përmban një depërtim etnik, një element etnik, social e kultural, dhe siç do të shohim, një element i ndikuar thellë gjuhësisht nga italishtja. (*Studime italo-shqiptare*, f. 46).

por edhe njëra prej arsyeve pse ai nuk e botoi tezën e doktoratës, ndërsa një përpunim të plotë të saj arriti ta bëjë vetëm në shtratin e vdekjes.

Hulumtimi dhe studimi i prejardhjes së arbëreshëve të Italisë mbështetur në të dhënat e onomastikës, ka qenë dhe ka mbetur njëri prej problemeve më të vështira, por njëkohësisht edhe njëri prej modeleve, që parimisht ka dhënë më së shumti rezultate. Çabej, mendonte me të drejtë se: “emrat vetjakë janë në gjendje të vërtetojë me anë të paralelizmave etnografike e dialektore dhe me të dhënat e historisë dhe të traditës gojore. Aty është për të shënuar që konceptet dialekt dhe prejardhje gjeografike vërtet shpeshherë puthiten, por nuk janë përherë e njëjta gjë. Gjuha është diçka rezultative, përfundim dhe rezultat i fundit procesesh etnike dhe historike gjithënduarsh, i cili reflekton ato gjer në njëfarë shkalle, po kurrsesi nuk mund t’i pasqyrojë në shumësinë laramane të tyre. Emrat, përkundrazi kanë këtë gjë të përbashkët me burimet historike, që përmbajnë diçka të caktuar mirë në vetvete, duke na dhënë shpeshherë burimin lokal të një shpërnguljeje etnike ose të një lëvizjeje shtegtare?”¹⁰¹. Pra, atë që

¹⁰¹ E. Çabej, *Die Herkunftsfrage der Albanischen Kolonien im Italien im Lishte vornehmlich der Sprache und der Eigennamen* (Çështja e prejardhjes së ngulimeve arbëreshe të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës e të emrave vetjakë),

nuk arrin të saktësojë gjuha dialektore, gjeografia gjuhësore-historike, atë më përfaqësues arrin ta saktësojë toponimia, sidomos patronimia.

Veçoritë gjuhësore dhe historike të emrave të arbëreshëve në Greqi dhe Itali

Para se të paraqesim veçoritë e onomastikës shqiptare në Greqi dhe Itali, duke u nisur nga burimi i prejardhjes së popullatës, ose duke u kthyer gjurmëve deri te burimi i mundshëm, pra në Shqipëri, po e theksojmë një fakt domethënës, që e ka vënë re Çabej, edhe pse nuk i ka shpjeguar shkaqet. Ai shkruan se edhe arbëreshët e vendosur në Greqi edhe ata që u shpërngulën në Itali u ndeshën me vështirësi që ndihmonin asimilimin kulturor të të shpërngulurve. Në Greqi këtë e ndihmonte besimi i përbashkët ortodoks, ndërsa në Itali, ndonëse besimi ishte faktor ruajtjeje të vlerave gjuhësore, etnografike e historike, kushtet ekonomike ndikuan shumë në humbjen e vlerave etnike të tyre. Megjithëse në Greqi më shumë janë ruajtur emrat e lashtë të popullit shqiptar, edhe në Itali nuk kanë munguar emrat me

“Proceedings of the Eighth International Congress of Onomastic Sciences”, Paris, 1966, f. 70-81. Studim i botuar shqip për herë të parë në “Studime filologjike”, ASH e RPSSH, IGJL, nr. 2, Tiranë, 1972, f. 23-34. Cit. nga *Studime gjuhësore*, V, “Rilindja”, Prishtinë, 1975, f. 43.

karakter kombëtar, si: *Lekë, Nerënxa, Vasha, Zogaj*¹⁰².

Duke i shtruar edhe një herë shkaqet kundërtënese të një fenomeni të tillë, pyetjes së lënë të hapur të Çabejt i përgjigjemi kështu:

◆ Pavarësisht nga forca asimiluese, që kishte besimi i përbashkët ortodoks, ne do t'i shtonim edhe afitë kulturore e gjuhësore shekullore, arbëreshët e Shqipërisë në Greqi gjetën elemente të vjetra dhe të përafërta kulturore që i lidhnin grekët dhe shqiptarët. Pastaj, shqiptarët aty nuk shkuan si njerëz, që vendoseshin për të ruajtur elementin etnik, përkundrazi fjala ishte për një shtresë shoqërore, që pa dyshim ishte e hapur ndaj vendësve. Nga aspekti ekonomik ata ishin kryesisht një shtresë e lartë shtetërore dhe natyrisht, duke qenë bartës të vlerave të larta ekonomike dhe kulturore, por duke qenë pjesë përbërëse e vlerave kulturore të pushtetit të ri otoman dhe duke qenë individ e jo familje ose grupe qytetarësh, sado në fillim ata impononin vlerat kulturore, më tutje ata shumë lehtë fillojnë të bëhen pjesë e një shoqërie, e cila kishte një trashëgimi të

¹⁰² E. Çabej, *Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre*, në “Konferenca e Dytë e Studimeve albanologjike”, Tiranë, 12-18 janar 1968, Tiranë 1969 (1970), vëll. III, f. 107-115; Cit. nga *Studime gjuhësore*, V, “Rilindja”, Prishtinë, 1975, f. 50.

pasur shekullore dhe pa mundësi për tu brejtur nga një shoqëri, e cila veç në planin ushtarak e shtetëror, nuk kishte krijuar një sistem të lartë shoqëror–kulturore për të thonë;

◆ Ndryshe, ndërkaq ndodhi me iksit arbëreshë në Itali. Ata shkonin atje në rrethana shthurjeje ekonomike, sociale dhe shpirtërore. Ata, në atdheun e ri i nënshtroheshin shpejt jetës së re, sipas rrethave të krijuara nga vendësit dhe organizimi shoqëror e shtetëror i tyre. Fillimisht ata mund të shkonin të organizuar në shkallë familjare, fisnore e madje mbase edhe krahinore në një vend të caktuar. Prandaj, pas vendosjes së parë në token e re, ata shpejt, për shkaqe kryesisht ekonomike, u nënshtroheshin shtegtimeve të brendshme. Mund të thuhet madje, se pikërisht këto elemente të brendshme kanë qenë shkaktarët kryesorë të një shterimi më të theksuar të emrave me karakter kombëtar, krahasuar me elementin shqiptar në Greqi. Për të argumentuar këtë tezë ne po i referohemi përsëri Çabejt, i cili ka sjellë një numër të madh emrash që paraqiten jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Itali, në disa vendbanime, si: *“Baffa, Barbatì, Barci, Basile, Becci, Bellusci, Cadicamo, Candreva, Cucci, Amis, Dara, Dorsa, Dramis, Golemi, Italmi, Lala, Licursi, Lopes, Lucci, Manesi, Marchain, Masaracchia, Masi, Masci, Mates, Matranga, Mortati,*

Petta, Plescia, Rada, Reres, Ribecco, Schiró, Smilari, Staffa, Stamati, Suli, Tocci, Variboba etj".¹⁰³

Duke u nisur nga dy mendime të Norbert Joklit dhe Franc Shtajner, mbi parimet e emërtimit në gjuhën shqipe (të emrave dhe të vendeve), Çabej ka bërë një tipologji të përgjithshme për të ardhur te ai konstatimi që u bë më lart: se nuk janë vetëm shqiptarët e Shqipërisë Jugore dhe shqiptarët e Moresë, ata që u shpërngulën në Italinë Jugore dhe në Sicili, si dhe te një fakt me interes për qëllimin e temës sonë: se onomastika e të shpërngulurve në Italinë Jugore e Sicili bënë pjesë në onomastikën e përgjithshme shqiptare.

Është interesant sidomos mendimi i Franc Seinerit, kur thotë se: “në Shqipëri vetëm paria me një pjesë të inteligjencës qytetare kanë pasur emra familjarë të qëndrueshëm, se përkundrazi në masën më të madhe të popullsisë përdorej gati kudo një emër i vetëm, dhe se emri i dytë që i shtohej eventualisht të parit në vendlindje, gati përgjithësisht ishte emri individual i t’et”¹⁰⁴. Ne do të shtonim këtu

¹⁰³ E. Çabej, *Çështja e prejardhjes së ngulimeve arbëreshe të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës e të emrave vetiakë*, “Studime gjuhësore”, V, f. 44.

¹⁰⁴ F. Seiner, “Ergebnisse der Volkszählung in Albanien in dem von österreichisch-schungarischen Truppen 1916-1918

se këto patronime, që kanë ardhur nga emri i t'et, shpesh janë zgjeruar në shkallë të emërtimit të lagjeve dhe të fshatrave. Eqrem Çabej shënon nga *Acta Albania I dhe II* emrat teke Gjini e Gjoni, të cilët në traditën popullore janë ruajtur vetëm kur është fjala për ofiqet e personave të caktuar, por edhe antroponime të cilat janë shoqëruar me patronime, që në fakt janë emrat e prindërve, si p.sh. *Ginus Tanusius*, i cili erdhi e u bë mbiemër e më tej edhe emër familjeje, si, *Progon Mira*¹⁰⁵, etj. Shembuj të tillë historikisht të pranishëm dhe të sotëm mund të gjenden në Kosovë dhe më gjerë. Ndryshe nga emrat e fshatrave, sot pothuajse të gjithë emrat e lagjeve janë antroponime të patronomizuara dhe të etnonomizuara. Po të jepnim shembuj, do të delte një listë e tërë emrash të tillë. Po e shënojmë vetëm gjendjen e lagjeve të fshatit Makresh: lagjja e parë, Ferizajt ka marrë emrin e njërit prej tre vëllezërve, shtëpia e të cilit gjendet në hyrje të lagjes; lagjja e Zekajve është një emër tash më patronim për këtë vëllazëri; lagjja e Çupëve ose e Bajraj mban dy emra: njërin nga një patronimi i tyre e tjetrin, për shkak të natyrës së vendit ku gjenden, pra në një majë të zhveshur dhe të

besetzten Gebiete” (1922), f. 4., cit. sipas Çabejt, *Çështja e prejardhjes së ngulimeve...*, në “Studime gjuhësore”, V, f. 43.

¹⁰⁵ Shih, E. Çabej, vep. e cit., “Studime gjuhësore”, V, f. 44.

rrethuar me mal dhe kodra të larta. Semantikisht fjala është për çerthullin që në popull quhet çup, veçse jo qerthullin e zogut, por të lepurit, dhelprës ose të ujkut¹⁰⁶. Lagjja e Osmanajve po kështu është një emër, tani një patronim i vëllazërisë, sikur edhe lagjja e Gjemoviqe, Hyskajve (ky një antroponim zbusues, nga Hyseni), etj. Se kjo është një traditë historike tregon edhe emri i një lagjeje: Radeci, emër i njërit prej vëllezërve që sipas traditës gojore treqind vjet më parë është vendosur këtu. Në Kosovë nuk janë të shpeshta, por edhe nuk mungojnë, rastet kur patroniminë e banorëve të një lagjeje e përcakton emri i lagjes, që është vetëm një toponim i zakonshëm.

Një numër i caktuar i fshatrave, siç dihet, janë rezultat i patronimeve, antroponimeve apo antroponimeve dhe patronimeve njëkohësisht, i familjeve të organizuara, sidomos në Shqipërinë Veriore dhe në Kosovë, si: *Isnikajt* (Isniq-Pejë), *Drelaj* (nga antroponimi Drel Nikaj), *Stakaj*(nga antr. Stak), *Pepaj*(nga antr. Pepë), *Nokshiq*(nga antr. Nokë) etj¹⁰⁷.

Duke u nisur nga të dhënat e arkivave të ndryshme, të sjellë nga Ch. Hopf, J. G. Hahn dhe

¹⁰⁶ Çuk, edhe eufemizëm për organin gjenital të femrës.

¹⁰⁷ Nga arkivi i dr. Zymer Nezirit.

Franc Babinger, me referencë mesjetën shqiptare¹⁰⁸, Çabej ka regjistruar një patronimi të pasur shqiptare, që shfaqet edhe në Itali, si: *Arianiti, Basta, Bua, Dukagjini, Gropa, Kastrioti, Loshia, Matrënga, Muriqi, Muzaki, Skura, Span, Spata, Thopia*, e që pjesën më të madhe janë ruajtur atje gjer në ditët e sotme. Nga ato dyer, dihet se *Dukagjinët, Kastriotët e Spanët*, kanë qenë të Shqipërisë Veriore, *Arianitët, Gropajt, Matrëngët, Muzakët, Skurajt dhe Topiajt* të Shqipërisë së mesme, *Bastët, Buat, Loshajt, Muriqët, Spatët* të Shqipërisë Jugore¹⁰⁹. Elementë të tillë dalin edhe në Kosovë: *Dukagjini* (krahinë në Kosovë), *Kastriot-i* (patronim dhe antroponime të shumta në Kosovë), *Loshi* (Mujë Loshi, Istog), *Muriqi* (patronim në Rugovë), *Bua, Bualli* (Bullovit, lagje në Marec të Prishtinës), etj. Në Kosovë, sikur dihet rrethanat historike kanë penguar përgjithësisht krijimin e

¹⁰⁸ Unë kam konsultuar librin: Gjon Muzaka *Memorje*, Përktheu Dhori Qiriaz, “Botimet Toena”, Tiranë, 1996.

¹⁰⁹ Khs. Edhe Ch. Hopf, *Chroniques gréco-romanes* (1873) f. 270vv. (»Brevememoria de li discendenti di nostra casa Musachi») dhe f. 530vv. (»drurët gjenealogjikë»); J. G. v. Hahn, *Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar* (=Denkschr. D. k. k. Ak. D. Wiss. XVI, Vjenë 1869) f. 84 vv.; F. babinger, *Das Ende der Ariantini* (Bayer. Ak. D. Wis. Phil-hist. Kl., Sitzungsber., viti 1960, fash. 4. F. 6vv.). Cit. nga E. Çabej, *Çështja e prejardhjes së ngulimeve...*, në “Studime gjuhësore”, V, f. 44.

familjeve bujare në qytete, por ato janë krijuar kryesisht në zona rurale. Nga mesjeta do të dallonim familjen bujare të *Gjinajve*, e njohur sot si familja e Gjinollëve, pra me prapshitesën orientale –*olli*, nga emri i të cilëve besohet se është emërtuar qyteti i Gjilanit, ndërsa antroponimin e një banori e mban edhe emri i qytetit të Ferizajt.

Po me këtë formulë patronimet, që kanë ardhur nga emri i prindit shpesh janë zgjeruar jo vetëm në shkallë të emërimit të lagjeve, por edhe të fshatrave të tëra, në Italinë Jugore e Shqipëri, e deri vonë edhe në zonat e Shqipërisë Veriore edhe sot këto patronime përfundojnë në emra fshatrash, ndërsa një dukuri e marrjes së patronimeve nga emrat e vendbanimeve, sidomos të vendbanimeve nga janë shpërngulur, ka vazhduar të jetojë deri në ditët tona, madje edhe në traditën popullore edhe në atë të shkruar.

Dëftuesi më i mirë që onomastika arbëreshe e Italisë bënë pjesë në onomastikën e përgjithshme shqiptare, vihet re te familjet e ardhura rishtas, sidomos ajo popullsi rurale, që si emër të vetin mbajnë emrin e pandryshuar të vendbanimit të tyre, ose ua vuri rrethi i ri ku kanë zënë vend. Nga një shoshitje e emrave familjarë të arbëreshëve, e bërë mbi këto parime, shihet se një pjesë e mirë e këtyre

“na shpie në trevën ç’merr prej Vlore e gjer lart në Prevezë, në Epir, bashkë me hinterlandin përkatës, një trevë ku këta emra na dalin si emra vendesh”¹¹⁰. Eqrem Çabej ka dhënë një listë të zgjeruar të këtyre emrave dhe ne do ta zgjerojmë edhe me hulumtime të reja: “*Borscia, Borgia Borshi* (Itali), *Cacasi, Cameniti, Cravari* (Itali), *Krevarë* (në qark të Prevezës (Greqi), *Kravaricë* (Kosovë), *Kudhës* (në breg të detit e në Çark të Vlorës), *Cicci, Cudes* (Itali), *Damës* (Tepelenë), *Damis* (Itali) *Dara* (patronim, Itali), *Dara* (fshat, Greqi) *Dramis* (Itali), *Dramës* (Çamëri), *Gropa* (Kurvelesh), *Glava, Golemi, Groppa* (Itali), *Masaracchia* (Itali), *Mazërëk* (Çamëri), *Mazreku* (patronim, Kosovë), *Varibopi* (Mallakastër), *Variboba* (Kalabri), *Variboba* (More), *Koronë* (Gjirokastrë), ?*S. Demetrio Corone* (Kalabri), *Koronë* (More), Çamëri, *Manëza* (Shqipëri), *Manes* (Itali), Patronimi *Mani dhe Manaj* që del shpesh në Kosovë besoj të vije nga një antroponim zbnues *Osmani<Mani*, por disa mikrotoponime të kësaj rrënje nuk është e thënë të mos përbëjnë po këtë strukturë të përhapur në trojet dhe kolonitë arbërore. *Shkëmbi* (Piana degli Albanesi), *Shkëmbi* (Greqi), *Te Shkëmbi i ?Kavajes* (dhe një numër i madhë mikrotoponimesh në

¹¹⁰ E. Çabej, *Çështja e prejardhjes së ngulimeve...*, në “Studime gjuhësore”, V, f. 44.

Shqipër, sikur edhe në Kosovë, *Te Shkami i Bregit Lugit* (Makresh), *Kamenicë* (Itali), *Kamenicë* (Greqi), *Kamenicë* (qytet në Kosovë dhe fshati *Kamenicë* (Istog), *Kamenicë* (fshat dhe Krahinë në Jug të Shqipërisë); *Klilmnedi* (Greqi), *Klimenti* (Itali), *Krahina e Kelmendit* (Shqipëri), *Kelmendi* (patronim në Kosovë, në dokunte del edhe në shek. XII, si *Clementi Monte*, shih Marquet, 85 e tutje); *Malesinat* (Greqi), *Malsia* (Shqipëri Veriore që lidhet edhe me trojet shqiptare në Mal të Zi, sikur edhe etnonimi i kësaj ane malsor për etnonimin shqiptar), *Kuqi* (Greqi, Kucjon), *Kuqi* (Kosovë, rrethi Suharekës dhe Deçanit), *Llivadhostra* (Greqi), *Livadhia* (fshat afër Strugës (Maqedoni), *Bashi* (Greqi), *Basha* (patronim në Kosovë), *Kuqi* (Shqipëri Veriore), *Bardha* (Itali), *Bardha* (Greqi), *Bardha*, *Bardh* (antroponim) dhe *Bardhaniq* (Kosovë). Po të shtonim këtu edhe mikrotoponimet e shpeshta të dala në Greqi dhe Itali, të krahasuar me të njëjtat në Shqipëri, Kosovë dhe përgjithësisht trojet etnike shqiptare, si: *Lluka e Thellë*, *Guri i Glatë*, *Guri i Kuq*, *Pusi i Thellë*, *Mali i zi*, *Mali*, *Mali i Proj Madh*, *Mali Guri Çipuan*, *Guri Çbum*, *Kroj Madh*, *Gureza* (në Kosovë *Gurzina*), etj., numri i tyre do të dilte shumëfish më i madh¹¹¹.

¹¹¹ E. Çabej, *Çështja e prejardhjes së ngulimeve...*, në “Studime gjuhësore”, V, f. 45; Antonio Belusci, *Ricerche e studi tra gli Arberori dell’ Ellade- Da radici Arbereshe in*

Nga tradita popullore po shënojmë shembujt: *Gjymshit Makolli* (Marec-Prishtinë), i njohur në traditën popullore si *Shyt Mareci* dhe po kështu i regjistruar e paraqitur në historiografinë shkencore; *Hasan Alija* (Remnik-Viti), i njohur edhe si Hasan Remniku dhe shpesh i paraqitur me këtë patronim edhe në historiografinë shqiptare e serbe; *Sylë Dreshaj*(Vrellë-Istog) i njohur si Sylë Vrella, mjeshtër popullor i ortopedisë¹¹² etj.

Përfundim

Në tekstin tonë trajtuam një anë toponimisë shqiptare, në këtë rrafsh toponiminë e arbëreshëve të Italisë, me të cilën Çabej insistonte të vërtetonte tezën e tij se *onomastika e arbëreshëve të Italisë bën pjesë në onomastikën e përgjithshme shqiptare*. Këtë tezë besoj se kam arritur të vërtetoj dhe të plotësoj

Italia a matrici arberore in Grecia - testi e dokumenti, (Kërkime dhe studime ndër arbërorët e Helladhës, ΕΡΕΝΕΣ ΚΑΙ ΜΕΛΕΤΕΣ ΕΠΙ ΤΩΝ ΑΡΒΑΝΙΤΩΝ ΤΗΣ ΕΛΛΑΔΑΣ»), Centro Ricerche socio-culturali “G. Castriota”, Cosenza, 1994; B. Baliu, “Çështje të studimit të onomastikës në veprën e Çabejt“, (Tezë magjistrature), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2000.

¹¹² Begzad Baliu, *Emrat zbulues në Krahinën e Gallapit*, “Fjala jonë”, Prishtinë, 1994, f. 23, 24.

gjuhësisht, si nga aspekti historik ashtu edhe nga aspekti gjeografik.

***National homogeneity of the onomastics of
arberesh of Italy (According to Eqrem Çabej's
viewpoint)***

Resume

The interest of Eqrem Çabej for the arbëresh of Italy is related to the difficulties they faced in settling in a new country, the timeline and geographical extension of their settlement in Italy, the material and spiritual culture, the cultural movement, the language history and especially to dialects of different regions, the history of ethnography, folklore, and of oral tradition in general, the literary tradition, historic personalities, different scholars of different disciplines, writers, as well as to the creation of a diachronic and synchronic stratifying onomasticon.

This chapter deals with the toponymy of arbëresh of Italy, through which Çabej insisted to prove that “the onomastics of arbëresh of Italy is part of the general Albanian onomastics”. I think I have managed to linguistically prove and complete this thesis in the diachronic level, as well as regards the

geographical dispersion of Albanians in time and space.

||

NJË KONTRIBUT I VEÇANTË PËR STUDIMET ONOMASTIKE SHQIPTARE

Bahtijar Kryeziu, *Trajtesa onomastike*, “Shkëndija”, Prishtinë, 2010.

Në gjysmën e dytë të shekullit XX studimet albanologjike në hapësirën shqiptare kanë shënuar maja të larta arritjesh, jo vetëm në ato fusha ku kërkoheshin përqendrime për nevoja arsimore, po edhe në ato fusha ku përkushtimi shkonte përtej standardizimit të disa prej normave gjuhësore, apo identifikimit të disa prej gjedheve shënjuese në trashëgiminë materiale dhe shpirtërore të popullit shqiptar, duke përfshirë këtu jo vetëm hapësirën qendrore të gjeografisë shqiptare po edhe atë anësore të saj.

Nëse në qendrën më të madhe të studimeve në Tiranë, në albanologji përplotësohej, standardizohej dhe bëheshin sinteza të mëdha të projekteve normative (gramatika, fjalori i shqipes standarde, historia e popullit shqiptar, historia e letërsisë shqipe

etj), në Prishtinë bëheshin përpjekje që të shënoshin disa arritje albanologjike, të cilat përtej synimeve thjesht albanologjike dhe normative kishin edhe disa interesa të tjera largvajtëse, e kjo do të thotë përvijueshëm kombëtare.

Studimet onomastike në Kosovë janë një prej fushave që shënuan rezultate të veçanta dhe arritje të theksueshme, jo vetëm për faktin se dija për këtë degë të gjuhësisë shqiptare mungonte, po edhe për shkakun se këtë pasuri kombëtare, jo njëherë dhe jo vetëm një kohë, shkenca e përtej saj politika serbe e kishte keqpërdorur për interesa kolonialiste të hapësirës shqiptare nën ish-Jugosllavi. Në të vërtetë, hulumtimi, regjistrimi, botimi, diskutimi dhe studimi i toponimisë shqiptare në ish-Jugosllavi përtej një kërkimi albanologjik, ishte mbrojtje e hapur e shenjave gjuhësore, kulturore, historike dhe identitare e kufijve etnografikë të popullit shqiptar. Kësaj tradite dhe këtij brezi studiuesish i takon edhe Prof. dr. Bahtijar Kryeziu, veprën e të cilit këtu po e bëjmë objekt veçimi dhe vlerësimi.

Në këtë periudhë kontributi i studiuesit Bahtijar Kryeziu është i një rëndësie të veçantë, për dy arsye: e para, sepse përkushtimi i tij në fushë të albanologjisë është i natyrës profesionale dhe njëkohësisht jetësore; dhe e dyta, sepse ai ka mbledhur, sistemuar dhe studiuar toponiminë, mikrotoponiminë, ojkoniminë e madje edhe antroponiminë e njërës prej pjesëve më anësore të gjeografisë etnike të popullit shqiptar, studimi i së cilës nuk ishte i lehtë dhe pa pasoja politike e jetësore.

Dr. Bahtijar Kryeziu ka më shumë se tri dekada që merret me hulumtimin, mbledhjen¹¹³ dhe studimin e toponimisë dhe antroponimisë¹¹⁴ së Luginës së Preshevës, brenda së cilës sot identifikohet edhe Komuna e Bujanocit me rrethinë dhe madje edhe Krahina e Medvegjës, si krahinë etnografike brenda kufijve shtetërorë dhe administrativë të Serbisë.

Pra, kontributi i mjeshtrit tonë në fushë të onomastikës i kalon caqet, thjesht linguistike, e kjo do të thotë se ai merr përsipër të trajtojë edhe përbërës të tjerë të pasurisë etnike të popullit shqiptar dhe kulturave të tjera në këtë hapësirë, duke i parë ato kur e kur edhe në përqasje me përbërës të tjerë identitarë apo të përfaqësuara me të, si dhe të pasurisë gjuhësore dhe historike të popullit shqiptar¹¹⁵.

Vëllimi më i ri me studime në fushë të onomastikës i studiuesit tashmë të njohur në këtë fushë dr. Kryeziut, *Trajtesa onomastike* është një referencë e rëndësishme e kërkimeve të tij në këtë fushë dhe njëkohësisht një përpjekje për të sjellë përvojën e tij në studimin e emrave të vendeve dhe të banorëve të kësaj zone, duke hapur herë pas herë hapësirën e

¹¹³ *Mikrotoponima e fshatit Rogaçicë*, “Gjurmime albanologjike – seria e shkencave filologjike”, XIII, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1984.

¹¹⁴ *Onomastika e Hashanisë*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2000.

¹¹⁵ *Shpërngulja e shqiptarëve të Malësisë së Bujanocit para dhe pas luftës së Kosovës të vitit 1999*, “Rilindja”, Prishtinë, 25.5.2001.

kërkimit edhe në zonat rreth saj. Atë e përbëjnë qasje të karakterit historiko-gjuhësor, të përimit gramatikor, të strukturës fjalëformuese, të pasqyrimin sociolinguistik e etnik, një shembull ky i veçantë i kërkimit të mikrotoponimisë së dy vendbanimeve.

Përmbledhjen e veprës e përbëjnë tre kapituj: *I. Vështrime onomastike, II. Opinione dhe III. Materiale onomastike*, ndërsa hapet me studimin sintetik *Gjendja e kërkimeve onomastike në Luginën e Preshevës dhe Bujanocit*. Fjala është për sintezën historiko-gjuhësore mbi studimin e onomastikës së kësaj ane, që mund të bëhet model i arrirë i kësaj natyre edhe për hapësirat e tjera gjuhësore, etnografike dhe politike.

Nga studimi i tij mësojmë se Lugina e Preshevës një kohë shumë të gjatë ka qenë objekt i studiuësve serbë (gjuhëtarëve, etnografëve, gjeografëve e historianëve, si: Momčilo Zlatanović, Dragutin Djordjević, Tatomir P. Vukanović, Aleksandar Stojanovski, Vidosava Nikolić - Stojančević, Mihailo Dinić, Milivoj Pavlović, Jovan V. Jovanović, Petar Skok, Zvezdana Pavlović – Stamenković)¹¹⁶, por pak,

¹¹⁶ Momčilo Zlatanović, *Toponimija Preševske Moravice*, Vranjski Glasnik, XX, Vranje, 1987; Dragutin Djordjević, *Ašani u leskovačkom kraju*, Leskovač zbornik XVII, Leskovac, 1977; Tatomir P. Vukanović, *Tradicija o nomadskim stočarskim kretanjima Karakačana na jugu Srbije*, Vranjski glasnik XXVI-XXVII, Vranje, 1993-'94; Aleksandar Stojanovski, *Vranjski kadiluk u XVI veku*, Vranje, 1985; Vidosava Nikolić - Stojančević, *Turska imena u vranjskom okrugu u vreme oslobodjenja 1877-1878*,

tepër pak i studiuesve shqiptarë: Idriz Ajetit¹¹⁷, Rexhep Ismajlit¹¹⁸, Rexhep Doçit¹¹⁹, të cilët studimet në këtë

Leskovački zbornik VIII, Leskovac, 1968; Momčilo Zlatanović, *Ojkonimi vranjske kotline*, Leskovački zbornik, XXI, Leskovac, 1981; Mihailo Dinić, *Iz Dubrovačkog arhiva I*, Beograd, 1957; Milivoj Pavlović, *Toponimija okoline Vranja*, Vranjski glasnik, IV, Vranje, 1968; Jovan V. Jovanović, *Neki tragovi starog privrednog i društvenod života u Leskovačkoj kotlini*, Leskovački zbornik IV, Leskovac, 1964; Petar Skok, *Iz toponomostike južne Srbije*, Glasnik skopskog naučnog društva XV-XVI, Skopje, 1936; Momčilo Zlatanović, *Toponimija Preševske Crne gore*, Vranjski glasnik XIX, Vranje, 1986; Zvezdana Pavlović – Stamenković, *Nazivi izvora u oblasti Polanice i Klisure*, Leskovački zbornik XI, Leskovac, 1971.

¹¹⁷ *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit* (Principales caracteristiques du language des Albanais dans les zones linguistiques de Preshevo et Bujanovac), “Studime gjuhësore I (Dialektologji)”, Prishtinë, 1978, f. 53-79; *Kontribut për studimin e onomastikës mesjetare në territorin e Malit të Zi, Bosnjës e Hercegovinës dhe të Kosovës*, (Contribution à l'étude de l'onomastique medievale du Monténégro, de la Bosnie-Herzegovine et de la Kosovo), *Studia albanica* 1, Tiranë, 1975, 93-105.

¹¹⁸ *Mbi disa toponime në Serbi të Jugut dhe në Maqedoni të Veriut*, *Gjurmime albanologjike I-II*, Prishtinë, 1970.

¹¹⁹ *Shih veprat dhe studimet: Toponimia e fshatit Gmicë, Toponimet e Llapushës (Prekorupës), Toponime kosovare si vendbanime të hershme të zhdukura të tipit të fortifikuar dhe baritor, Antroponimia e shqiptarëve të Kosovës I, Iliro-*

fushë i kanë bërë kryesisht në mënyrë anësore, si dhe sidomos autorit tonë Bahtijar Kryeziu, i cili kërkimit në fushë të onomastikës në Luginën e Preshevës i është qasur në mënyrë më të thelluar. Pjesën më të mirë të studimit të tij autori ia kushton toponimisë dhe antroponimisë, si dhe përbërësve historikë, gjuhësorë, etnografikë dhe kulturorë të tyre në jetën e banorëve të saj. Fjala është për toponimet, mikrotoponimet, antroponimet, patronimet dhe ojkonimet: *Karadak, Hashani, Bujanoc, Preshevë, Qarr, Gjergjec, Kershovicë, Rakovc, Lopardincë, Samolicë, Qukark, Lilancë, Karrabat, Kepi, Rrahishtë, Shamak etj. dhe patronimet: Balovit, Bardhiqtë, Bernjashtë, Çukalitë, Dodajt, Dukajt, Hutajt, Kishalitë, Kolosjantë, Lumjantë, Ukajt, Vreneztë etj.*, si dhe përbërësit gjeografikë, historikë, etnokulturorë dhe sidomos gjuhësorë, në emër të të cilëve mjeshtri ynë ka sjellë etimologjinë e tyre.

Po mbi këto kritere dr. Kryeziu ka sjellë një sintezë të toponimisë dhe mikrotoponimisë së kësaj ane me burim sllav, si dhe një mori elementesh të tjera onomastike, e strukturën gramatikore të tyre, mbështetur edhe nga një fjalës i pasur i shqipes.

Një nga studimet e këtij vëllimi me pretendime posaçërisht të veçanta është edhe syzimi *Nga toponimia e Anamoravës*, një "tërthore" sikur e quan autori, që ka një lëndë të pasur onomastike, por e cila ende nuk është bërë objekt studimi në fushë të

shqiptarët dhe serbët në Kosovë (sipas onomastikës), *Onomastikë ilire-shqiptare në Ballkan, etj.*

onomastikës. Në studimin e tij, i cili mbase mund të jetë vetëm një syzim fillestar i një projekti më të madh, meqë dimë se studiuesi ynë merret me toponimet dhe ojkonimet: *Hogosht, Qarakovc, Kopërnice, Capar, Lopardince Shurdhan, Vaganesh, Firiçevë, Gjyrishec, Gjytet, Llukar, Majran, Rakovc* etj., si dhe variantet e tyre brenda kësaj hapësire apo në një hapësirë më të gjerë të fjalësit të shqipes.

Studimet *Hashania në dritën e mikrotoponimeve të vjetra shqipe dhe Elementi turko-oriental në toponiminë e Kosovës Lindore* janë dy tema të rëndësishme të këtij vëllimi, të cilat në një mënyrë apo një tjetër plotësojnë dhe thellojnë kërkimet e tij të mëparshme në monografinë *Onomastika e Hashanisë*. Brenda këtyre dy studimeve është trajtuar një dorë toponimesh të moçme shqiptare: *Ahishtë, Bjeshkë, Bria, Erganja Madhe, Çarr (Qarr), Elmishta, Firishta, Gropishta, Gurinat, Kepi, Kuplec, Kumga Imerit, Kungullar, Lethia Ukës, Ligata, Rrahishta, Te Balltaki, Te Bota, Bota Kuçe, Te Qafat, Të Çuka, Te Kodra etj.*, të rëndësishme edhe për plotësimin e hartës gjeografike shqiptare, pamjen homogjene të tyre, si dhe një dorë po kaq e pasur e toponimisë së proveniencës osmane në këtë krahinë etnografike të kufijve verilindorë të shqipes: *Karadak, Ballovani, Baçe, Bunari Baçes Madhe, Çardak-i(u), Çeshme-a, Dulan, Ikdili, Jaruga, Kalaja, Karolli Bugarit, Merçezi, Kolište, Marshalla, Medani Gat, Te Çadrat, Te Çeremnica, Te Huduti, Te Me(j)tepi, Sarmaxhiki, Tabet, Te Gjereni, Te Xhibra etj.*

Në tërësinë e kësaj përmbledhjeje mjaft të pasur

shkrimesh, studimi i Profesor Kryeziut *Struktura morfologjike-fjalëformuese e toponimisë dhe antroponimisë (patronimisë) së Malësisë së Bujanocit* padyshim plotëson më tej kërkimet gjuhësore të autorit tonë në këto tërthore. Nëse në studimet dhe veprat e tij të mëhershme, ishte përimituar gjerësisht struktura gjuhësore, kryesisht e mikrotoponimeve, në këtë vëllim një kapitull më vete i është kushtuar strukturës gjuhësore (fjalëformimit), kryesisht me burime antroponimike dhe patronimike. Fjala është për emërtimet tautologjike, emërtimet sinonimike, mikrotoponimet me fjalë të parme, emërtimet me fjalë të prejardhura, prapashtesimet e pasura të tyre me burim nga shqipja, sllavishtja dhe turqishtja: -aj(ë)-a, -ak(i), -al(i-a), -ar(i), -at(ë)-a, -ec(i), -esh, -ic(ë)-a, -in(ë)a/ -ine, -isht(ë)-a, -li, -(a)llar, -(a)nik, -njak, -nje, -ok(i), -os/jan, -ovit/oviç, -ull/ore, -ush, -xhik(i); kompozitat, togfjalëshat, emërtimet e vendeve me një fjali përshkruese etj.

Ka më shumë se dy dekada që me ngulm dhe me përkushtim albanologët po i përgjigjen pamjes historike të toponimisë së hapësirës shqiptare dhe po i kundërvihen përpjekjes së strukturave shkencore, politike, fetare dhe ushtarake vendore e ndër-kombëtare për imponimin e një pamjeje të re të emërvendeve të Kosovës. Këtë luftë, që në një mënyrë apo një tjetër, Serbia u përpoq ta imponojë në Kosovë nga gjysma e dytë e shekullit XIX, studiuesit shqiptarë janë përpjekur dhe vazhdojnë të përpiqen ta çrrënjosin individualisht, kryesisht dy dekadat e fundit të shekullit XX dhe në mënyrë të organizuar, në dekadën e parë të shekullit XXI.

Studimi i Profesor Bahtijar Kryeziut në fushë të onomastikës, *Çështje të standardizimit të toponimeve*, është një prej përgjigjeve dhe një prej kontributeve të studiuesve tanë në këtë ndërmarrje të madhe, e cila duket të mos mbetet vetëm në hapësirën e Kosovës. Kjo ndërmarrje që duket po i jep frytet e saj jo vetëm në Maqedoni, po edhe në Shqipëri, fillimisht nuk qe kuptuar drejt në Kosovë, e një dozë rezerve ndoshta hetohej edhe te autori i kësaj vepreje, por nuk u desh shumë kohë që projekti i *Komisionit për Standardizimin e Emërvendeve të Kosovës* të bëhet objekt përkrahjeje e pjesës dërmuese të popullatës së Kosovës, për implementimin e të cilit merita dje, sot dhe nesër do t'i takojë edhe dr. Bahtijar Kryeziut.

Nëse në studimet e mëparshme të këtij vëllimi ne shohim përvojën e sjellë të autorit në fushë të onomastikës si dhe thellësinë e kërkimit të disa prej temave që i kishte bërë objekt studimi edhe në vepra e trajtesa të tjera, studimi *Mbishkrimet në komunën e Gjilanit – çfarë janë sot?* paraqet një pamje të re në studimet tona në fushë të onomastikës, pavarësisht prej temës së saj. Fjala është për një hulumtim sa onomastik, po aq edhe sociolinguistik, kulturor e bashkëkohor. Nga një hulumtim shumë i gjerë që autori ka bërë në emërtimet e lokaleve zejtare, hoteliere-turistike dhe përgjithësisht ekonomike dhe nga tipologjizimi i tyre në kohën tonë, kuptojmë një varg raportesh kulturore, sociopolitike, socioekonomike, gjuhësore dhe psikologjike të banorëve të këtij qyteti në dhjetë vjetët e fundit. Prej emërtimeve të këtyre ne sot kuptojmë se si një pasqyrë gjuhësore

antroponimesh kryesisht orientale, e pranishme deri para tri dekadave të fundit, në objektet kryesisht zejtare: Autoservisi Bajrami, ...Ilmiu, ...Murtezi, ...Rexha, dhe llagape: Bllaca, Daku, Demi, Devaja, Dubova, Dërmaku, Leka, Kërçeli, Kastrati, Kastrioti, Korça, Sopi, Shkodra, Shkodrani, Rukovci, Mulaku, Te Hoti, Tërstena, Leci, Vinca, Qosja, Morina, Muja, Shala, Marevci, Spahia etj.; tashmë po përmbillet, krahas edhe me pasqyrën emërtuese bashkëkohore të fëmijëve shqiptarë gjatë kësaj kohe: Afërdita, Albana, Arbëri, Besarti, Fatlumi, Taulanti, Liridoni, Kushtrimi, Tringa, Linda, Jetoni, Fitorja, Fitimi, Valdrini, Luli, Blerta, Rilindi, Herolindi, Herolinda, Valmiri, Valoni etj.

Po kështu mund të thuhet edhe për fjalësin emërtues të lokaleve kryesisht me fjalë të proveniencës politike, kulturore dhe madje gjuhësore jugosllave: Sarajevë, Bashkim-Vëllazërim, Bosnje, Zagreb, Beograd etj. dhe po zëvendësohet me një fjalës bashkëkohor të proveniencës europiane dhe më gjerë: Amerika, Europa 2002, Ballkani dhe Ballkania, Brazili, Kalabria, Sicilia, Barcelona, Paris, Roma, Geneva (Gjeneva), Florida, Saraj, Venecia, Kalifornia, Riad, Verona, Venediku, San Paolo, San Remo, San Trope, Caffeteria Malibu etj.

Kapitulli i parë i këtij vëllimi mbyllet me një studim të përveçëm, së paku për dy arsye: së pari, se i kushtohet njërit prej personaliteteve emblematike në fushë të albanologjisë dhe së dyti, sepse merret me gjuhëtarin, i cili i ka korrur rezultatet më të thella në fushë të onomastikës, madje edhe atëherë kur kërki-

met e tij në këtë fushë kanë qenë të karakterit anësor. Në 90-vjetorin e lindjes së Profesor Idriz Ajetit, nxënësi i tij, ia kushton studimin *Ndihmesa e Profesor Idriz Ajetit në fushën e onomastikës*. E kuptueshme. Profesor Idriz Ajeti më shumë se dy dekada me radhë ka qenë mentori i tij i shumëfishtë, pikërisht në fushë të onomastikës, ka shkruar referatet e gradimeve dhe avancimeve të tij pikërisht në fushë të onomastikës. Me një fjalë ka shkruar fjalët përgëzuese dhe vlerësuese për të e për veprën e tij.

Në kumtesën e tij studiuesi Kryeziu ka vlerësuar dy angazhime jetësore të Profesor Idriz Ajetit: rolin e tij prej bardi të albanologjisë, e në këtë rast, në mënyrë të veçantë, mbrojtjen e albanologjisë nga spekulimet politike edhe nga institucionet më të larta shtetërore dhe akademike jugosllave, si dhe kontributin e tij në fushë të onomastikës. Te misioni i parë ka parë vlerat etike dhe etnike të Profesor Ajetit, ndërsa te i dyti, vlerat shkencore.

Pjesën e dytë të këtij vëllimi, *Opinione*, e përbëjnë tri recensione për veprat shkencore, të cilat i takojnë fushës së onomastikës. Fjala është për vlerësimet mjaft përmbajtësore dhe kritike, të shkruara me rastin e recensimit të tri veprave: të Rexhep Doçit (*Onomastika e Drenicës I*), Qemal Muratit (*Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë*) dhe Halit Sylejmanit-Maliqit (*Onomastika e Busavatës*). Sikur mund të shihet edhe prej titujve emërtues, e para është një monografi shkencore për krahinën etnografike të Drenicës, e dyta

është një fjalor toponimik për hapësirën shqiptare të Maqedonisë dhe e treta një vepër komplementare për njërin prej vendbanimeve të Kosovës Verilindore, Busavatën.

Vepra mbyllet me kapitullin *Materiale onomastike*, e cila përfshinë një material të pasur mikrotoponimik, mbledhur në fshatin e tij të lindjes, Roganë. Edhe si i tillë, ky fjalës përshkrues dhe madje ndonjëherë edhe vlerësues, është një kontribut i çmuar në fushë të onomastikës shqiptare.

Nuk mendoj se duhet kaluar pa u theksuar edhe fakti se ky vëllim është pasuruar edhe nga një bibliografi e pasur e studimeve onomastike, si dhe një varg pasqyrash e shkurtesash gjuhësore, të cilat librin e bëjnë lehtësisht të përdorshëm.

KËRKIME NË ONOMASTIKËN E GJEOGRAFISË ANËSORE TË SHQIPES

Mustafa Ibrahim, *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, botoi *Interlingua*, ISBN 978-9989-173-31-8, Shkup, 2010, f. 245.

Ka disa vjet që lexojmë studime e dëgjojmë kumtesa shkencore të njërit prej studiuesve më aktivë të brezit të ri, Prof. dr. Mustafa Ibrahimit. Paraqitja e tij në hapësirën shkencore shqiptare viteve të fundit përfshinte studime, kumtesa, vepra dhe materiale tereni nga disa fusha të dijës: dialektologji, leksikografi, folklor, etnografi, onomastikë, pra kulturë materiale e shpirtërore të shqiptarëve në Maqedoni. Duke qenë vjelës dhe studiues i të gjitha këtyre fushave nuk është e rastit që studiuesi Mustafa Ibrahim, ka disa vjet që studimet në fushë të sociolinguistikës i ka çuar përpara jo vetëm në nivel të hapësirës shqiptare në Maqedoni, por edhe në nivel të hapësirës akademike shqiptare përgjithësisht.

Pas një varg veprash në fushë të dialektologjisë, leksikografisë dhe folklorit, kohëve të fundit Mustafa Ibrahim ka botuar veprën *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, me të cilën ka plotësuar studimet albanologjike jo vetëm të këtij krahu të shqipes.

Ka disa dekada, për të mos thënë gjatë gjithë shekullit XX që studiues të huaj: kryesisht serbë, rusë, bullgarë e të tjerë, botojnë studime, materiale dhe vepra shkencore për gjendjen e identitetit të popullsisë dhe vendbanimeve në hapësirën shqiptare nën Maqedoninë e sotme, por deri vonë nuk kishim studime dhe vepra të autorëve shqiptarë për këtë hapësirë, nëse përjashtojmë ato tekste të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, të cilat botoheshin në shtypin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare të diasporës. Kujtojmë këtu Selishqevin, Blazhe Koneskun, Maksimilian Lamercin, Karlo Taliavinin, dhe vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XX studiuesit shqiptarë, Petro Janurën, Fadil Sulejmanin, Remzi Nesimin, Zihni Osmanin, Hamit Xhaferin, Vebi Bexhetin, Naim Bashën, Haki Ymerin dhe në mënyrë të veçantë studiuesit e leksikut e toponimisë: Qemal Muratin, Asllan Hamitin, Xhemaludin Idrizin, etj.

Libri i Mustafa Ibrahimit *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, është një vazhdim i suksesshëm i kërkimeve gjuhësore edhe për një arsye fundamentale. Kjo është hapësira etno-gjuhësore dhe etno-historike, ku përkiemet shqiptaro-sllave kanë marrë karakter edhe politik. Vëllimit i prinë një hyrje sintetike në të cilën

autori sjell disa nga arsyet pse kërkimet në fushë të onomastikës janë të rëndësishme jo vetëm për gjuhësinë dhe brenda saj onomastikën, por edhe për disa nga përbërësit e tjerë historikë dhe etnikë të popullit që e përdor dhe e ruan këtë pasuri gjithëkombëtare. “Vendbanimet shqiptare të këtij rrethi, shkruan autori, janë shumë të pasura me mikrotoponime, sepse duke u gjendur në një hapësirë të izoluar nga folësit e tjerë shqiptarë në Maqedoni, kanë ruajtur shumë fjalë të rralla dhe mikrotoponime, të cilat shumë rrallë ose aspak nuk hasen në të folmet tjera shqipe”. Prej parathënies së tij nuk është vështirë të shihet përkushtimi afatgjatë i autorit në mbledhjen e materialit në teren, në studimin dhe sistemimin e tij duke u nisur nga kërkesat shkencore dhe specializuese (fillimisht në interes të kërkimeve dialektologjike e leksikografike), për t’i sistemuar më në fund në një vëllim për specialistët e onomastikës dhe pse jo të historisë së gjuhës.

Libri përbëhet nga katër kapituj. Në kapitullin e parë është përmbledhur përshkrimi i vendbanimeve me popullsi shqiptare dhe mikrotoponimia sipas fshatrave; kapitulli i dytë, që në të vërtetë është boshti i gjithë vëllimit, specifikon ndarjen leksiko-semantike të mikrotoponimeve; kapitulli i tretë sintetizon mikrotoponimet nga pikëpamja strukturore – gramatikore; si dhe kapitulli i katërt paraqet analizat gjuhësore të mikrotoponimeve. Vëllimi mbyllet me të dhëna orientuese, teknike, përmbledhëse dhe sintetike, sikur janë: sqarimet për përdorimin e fjalorit, transkriptimi fonologjik, shkurtesat, burimet bazë,

fjalori mikrotoponimik, përfundimi, bibliografia dhe literatura.

Kapitulli i parë pasqyron disa nga përbërësit historikë, etnogjografikë e demografikë të komunës së **Prilepit**, e cila shtrihet në pjesën veriore të Pellagonisë (brenda së cilës gjenden fshatrat: *Cërnilishtë, Desovë, Gostirazh, Debresht, Lazhan, Peshtalevë dhe Zhitoshë*); të komunës së **Dollnenit**, e cila shtrihet në veri të Pellagonisë dhe përfshinë fshatrat shqiptare: *Zhitoshë, Cërnilishtë, Desovë, Gostirazhni, Peshtalevë, Lazhan dhe Debreshtë*; të komunës së **Krushevës**, e cila shtrihet në pjesën juglindore të Pellagonisë (e cila administrativisht mbulon fshatrat: *Presill, Alldançe, Borinë, Sazhdevë, Jakrenovë, Bellushinë dhe Nerovë*), si dhe zona e **Velesit** (me dy fshatrat e banuara me shqiptarë: *Jabollçishtë e Sogle*). Kjo, ndërkaq, në asnjë mënyrë nuk i përjashton fshatrat e tjera të banuara tash me popullsi të deklaruara etnikisht maqedonase, por që po të hulumtohen më thellë, mbështetur madje pikërisht në fushë të toponimisë, folklorit e etnografisë, nuk është vështirë të shihen gjurmë të rëndësishme të karakterit historik të etnisë shqiptare edhe në këto vendbanime. Jo vetëm brenda fshatrave me popullsi të plotë shqiptare, por edhe në fshatrat ku mbijetojnë arketipe gjuhësore, folklorike dhe madje etnologjike, ende mund të gjenden shenja të ekzistencës së popullsisë shqiptare, tashmë të sllavizuar, falë njësive mikrotoponimike, të cilat përtej njësive gjuhësore paraqesin njësi etnokulturore, materiale e shpirtërore dhe etnike të shqiptarëve, banorë shekullorë të këtyre vendbanimeve. Shembulli

më i mirë i kësaj njësie është identifikuar te etnonimi **Arbanas**, i cili dëshmohet që në vitin 1336 në rrethin e Prilepit. Dhe jo vetëm kaq. Në dokumentet mesjetare turke, sllave e të proveniencës perëndimore nuk është vështirë të gjenden topikët: *Arbanas*, *Arbanash* dhe *Arnaut* (Prilep), *Arbanasi* oronim (Prilep), *Arbanasi* (Dupjaçan), *Arbanasi* (Nebregovë - Prilep), *Latinska Crkva*, *Arnaut Xhamia* (Prilep), *Arnautska Maalla* (Konjari), *Arnaut Mahalla* (Prilep), *Arnaudska Zemja* (Prilep) etj.

Për të gjitha fshatrat dhe komunat autori ka dhënë paraqitje të detajuara të pozitës gjeografike, kufijve të tyre, strukturës etnike të popullsisë, fiseve kryesore, ojkonimeve, etimologjisë së emrit dhe etnikut, informatorëve dhe në fund mikrotoponimeve. Janë me shumë interes shpjegimet popullore për fiset. Duke mos qenë fise në kuptimin e banorëve të një krahine si në Kosovë dhe në Shqipërinë Veriore, por grupe të vogla familjare në nivel të barqeve, ato sjellin informacione shumë interesante për prejardhjen, për gjenealogjinë e tyre dhe sidomos për hipokoristikët patronimikë të tyre, të cilat vetëm pjesërisht mund të gjenden në hapësirën tjetër të onomastikës shqiptare. Është me shumë interes të shihet se në këtë fjalës të patronimisë shqiptare deri ku ka shkuar ndikimi sllav në strukturën leksikore, semantike dhe gramatikore të shqipes, dhe në ç'përmasë ka arritur të ballafaqohet e t'i qëndrojë këtij ndikimi një pjesë e saj.

Në këtë rrjedhë, autori ynë është përpjekur që të sjellë disa të dhëna dhe disa përfundime të tij apo të

tjerëve për etimologjinë e të gjitha vendbanimeve dhe të etnikëve të popullatës së tyre, ndërsa për prejardhjen gjuhësore të fiseve ka dhënë vetëm disa nga shpjegimet e rastit, sado me interes jo vetëm për lexuesit e rastit por edhe për specialistët e onomastikës. Tek ojkonomi *Cërnilishta* autori përkrahë konceptin e studiueses Olga Ivanova, duke e gjetur etimologjinë tek fjala Cernil(o): cern “niger” – i zi dhe prapashtesa –ishte (19); etimologjinë e ojkonomit *Desovë* e kërkon tek një traditë e vazhdimësisë ilire të emërimit të vendbanimit mbi baza patronimike me bazën Des+suf –ovo (*Desimir, Desislav, Despot*), si edhe *Perast* (<Pirusti), *Dukla* (<Dukleati) etj; etimologjinë e fshatit *Gostirash* e konsideron të errët, për shkak të lëvizjeve të mëdha në identifikimin e tij në literaturën dokumentare; ndërsa te ojkonomi *Debresh*, ai gjen patronimin e vjetër personal Debres; emrin e fshatit *Zhitosh* e konsideron të zgjidhur nga Petar Skok, nga shqipja Grun+suf. – ishte; te ojkonomi *Jakrenovë* gjen emrin patronimik Jak, i pranishëm gjerësisht tek shqiptarët; tek ojkonomi *Borinë* dhe trajta e tij në dokumentet turke Brina, autori ynë vjen në përfundim se fjala është për emrin vetjak shqiptar Biran; ndërsa etnonimin e ojkonomit *Nerovë*, i pranishëm gjerësisht në hapësirën gjuhësore shqiptare, e gjen te baza leksikore e shqipes “njeri” etj.

Pra, janë të pakta etimologjitë e fshatrave që për një arsye apo një tjetër nuk i diskuton dhe nuk nxjerr përfundime të caktuara, duke përfshirë këtu edhe diskutimet e studiuesve dhe literaturën dokumentare. Pavarësisht prej nivelit të diskutimit, e diskutimet në

fushë të etimologjisë gjithmonë lënë vend për dyshim dhe diskutim të vazhdueshëm, kërkimet në teren dhe në literaturë janë me interes të shumanshëm, prandaj edhe përfundimet e tij me interes të përgjithshëm.

Le të theksojmë vetëm disa nga ato fise më të vjetra dhe sikur shkruan autori me më shumë shtëpi: *Balovsi* (<hip.*Bajram*), *Cankovsi* (<hip.*Asan*), *Gjolekovsi* (të ardhur nga *Dardha*, vend në *Shqipëri*) (<hip.*Gjon + Lekë*), *Guxhovsi* (<nga *nofkë*), *Latovsi* (<hip. *Iljaz*), *Shitovsi* (<hip. *Rushit*), *Usovsi* (<hip.*Usein*), *Xhepovsi* (<hip.*Rexhep*) etj (*Cërnilishtë*); *Buzliovci*, dhe *Sharetët* (*Gostirash*), fshati ku sipas dokumenteve turke të shek. XVI, njeriu i parë që është regjistruar është *Gjon Arnauti*; *Manenvci* (*Peshtalevë*); *Arapoxhovce* (*Debresh*); *Deshatovci* (*Zhitoshë*); *Pulevci* (*Borinë*), *Kolaj*, *Mixhaj* (*Alldanqe*); *Pelli*, *Llupi*, *Rroshit*, *Shellgët* (*Jabollqishtë*) etj.

Brenda kapitullit të dytë janë me shumë interes mikrotoponimet e secilit fshatit veç e veç, si dhe sistemimi sipas gjendjes gjeografike, materiale, kulturore, fizike etj.: *Arat* (*Ara e Toskës*, *Bilkameni*, *Lethja*, *Ligata*); *Malet*: *Gropa e Shitit*, *Çuka*; *Kodrat*: *Kodra e Topit*, *Mullari*, *Tumba e Bashinecit*, *Vllahu*; *Krojet*: *Tinjët*, *Ujti i Xhumas*, *Ujti i Barth*; *Kullosat*: *Mullijt*; *Livadhet*: *Livadhi i Sulit*; *Lumenjtë*: *Ke Ezeroja*, *Vija*; *Përronjtë*: *Proj i Fellë*, *Proj i Balit*; *Mullinjtë*: *Mulljini i Bakjut*, *Mulljini i Parë*, *Mulljini i Dytë*, *Mulljini i Tretë*, *Mulljini i Katërt*, *Mulljini i Amzës*; *Udhët*: *Oudha e Gurishtës*, *Oudha e Kuqe*, *Oudha e Lethjs*, *Oudha e Qiraxhive*, *Oudha e Vra Muratit*; *Gurët*: *Bishti i*

Curve, Guri i Merizit, Guri i Ram, Guri i Sulit Dulit, Guri me Qallm, Guri me Tavan, Peshterja e Kaçakve; Korijat: Korja e Likës, Korja e Xha Mejdinit; Drunjtë: Ke Dardha Mace, Ke Fayri, Ke Lisi i Bogomillës, Ke Lisi i Shitit, Ke Lisi i Shyptarit, Ke Mollët e Koshit; Varret: Vorret e Kourive, Vorret e Katounit, Vorret e Xhyqqive; Vende: Ke Arkaçët, Ke Bryma e Milanit, Ke Shkolia, Ke Ujti i Dollës, Ke Ujti i Qolbët, Ke Vllahu, Manastirishçe etj. Pa dashur të hyj në këtë rrjedhë shumë të ndërlikuar diskutimi, sepse kjo do t'i jepte përmasë tjetër paraqitjes sonë, dua të theksoj qoftë edhe një fakt: ndikimin sllav në patroniminë islame, praninë bizantine të disa ojkonime dhe madje në emra fisesh dhe elementet e rëndësishme të proveniencës romane dhe katolike në disa forma dhe trajta patronimike e mikrotoponimike.

Kapitulli i dytë me titull Ndarja leksiko-semantike e mikrotoponimeve paraqet boshtin e veprës Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të Prilepit, Krushevës dhe Velesit. Makrostrukturën e tij e përbëjnë temat e përgjithshme, si: toponimia primare, me nëntemat: mikrotoponime të krijuara nga emra oronime, hidronime (Udha Batakut, Çeshmja e Bugarve, Çeshmja e Shkozës, Çeshmja e Teferiçit, Çeshmja e Xhamis, Ke Gura Vogël, Kallxherica, Kllajneci i Kryljut, Kroj ke Rrasat, Ke Liqeni, Proj i Muzgave, Prroj i Qafës, Prroj i Urës Gurt, Prroj i Manastirishtes, Ke Sulishtet, Ke Ujti i Qielbët, Ujti i Barth i Math, Ujti i Tharët, Zalli i Arës se Vjetër, Ke Bunari i Alilit etj); bota bimore (fitonime) si: Ahishtat, Përroi i Blinave, Bubishta, Dardhët e Shullonit, Dushku Kaurve, Ke Ithnat, Kinxhlët, Te Kumblla

Mbuth, Lisi i Shyptarit, Mollët e Tharët, Qafa Thanës, Vneshtet e Vjetra, Gurt e Shkopive; bota shtazore (fauna), si: Voret e Kualve, Dardha Mace, Gjurma Moushkës, Mali ke Brimat e Dhelplnës, Guri i oukut g Bell, Ara e Bxhetës, Gurst' e Gjarpnive, Bishti i Gurve, Gjurma Maushkës etj; mineralogjia (tokë, minerale, xehe), blegtoria, bujqësia, pylltaria, manifaktura, komunikacioni, objektet kulturore, raportet sociale, si dhe strukturat gramatikore të tyre: mbiemra në përbërje të mikrotoponimeve që përcaktojnë numërorë, folje, parafjalë, toponime sekondare (Vorret e Alldançes, Guri i Bogomayllës, Lisi i Bogomayllës, Oudha e Bellushjnës, Mali i Bellushçnës, Oudha për n'Berat, Korja e Buçinit, Qafa e Dollgovecit, Kullosa e Grazhdanit, Shullani i Jakrenovës, Ke Oura e Kostinces, Sllloqt me te Koshines, Gropat e Kurshovës, Dushku i Zhitoshes, Tumba e Bashinecit, Mali i Gabrovnjkut, Prroj i Ftosjnës, Ke Signalli i Kirividit etj.), baza apelative të mikrotoponimeve etj. Në qoftë se pjesa e parë, struktura leksikore, tematike dhe paradigmatiche e mikrotoponimeve paraqet pasurinë materiale dhe shpirtërore të kësaj ane, kryesisht mikrotoponiminë e mbështetur në gjendjen fizike të hapësirës gjeografike dhe botën bimore dhe shtazore të kësaj ane, në pjesën e dytë është trajtuar struktura gramatikore e kësaj pasurie gjuhësore, madje jo vetëm e shqipes. Pra, në qoftë se në pjesën e parë janë trajtuar oronimet, hidronimet, fitonimet, zoonimet etj., si: Bjeshka e Epër, Bjeshka e Poshtë, Briexhet e Kuq, Bryma Ukut, Qafa e Gradishtes, Zadgradishte, Grona e Fkell, Gropa e Kalushit, Ke Gropët, Guri i

Aneve, Guri i Askerit, Guri i Keq, Guri i Kuq, Guri i Math, Guri i Mullinit, Guri i Nishanit, Guri i Shpum, Guri i Shpunun, Guri i Verth, Guri i Zi, Guri Jeshil, Guri Kalas, Guri me Gjurm, Guri me Tavan, Guri Plak, Gurst' e Gjarpnive, Karpat e Sharetit, Kodra e Dushkut, Kodra e Topit, Kodra e Vneshtve, Lisi i Moth ke Kodra, Peshterja e Kaçakve, Peshterja e Kuqe, Peshterja e Plakut, Qafa Sherit, Qafa Thanës, Ara ke Rrasat, Ka Shkall, Udha në Skall, Shpella a Des, Shpella e Kalushit, Shullan i Korijave etj., në pjesën e dytë është diskutuar i gjithë inventari gjuhësor e gramatikor i tyre: mikrotoponimet si numërorë, si folje, si parafjalë etj.

Një fund është sjell edhe një nënkapitull mbi mikrotoponiminë sekondare, i cili përfshinë njësitë mikrotoponimike nga emra vendbanimesh, mikrotoponimet nga emra toponimesh, si dhe apelativat e mikrotoponimeve. Fjala është për një nga gjurmimet shumë interesante të toponimisë sonë, e cila është diskutuar që nga Norbert Jokli, sidomos në lidhje me ndikimet dhe praninë e elementit sllav në toponiminë dhe përgjithësisht leksikun e shqipes. Në të vërtetë, përtej aspektit ndikues dhe pranisë së elementit sllav në toponiminë e hapësirës shqiptare dhe përgjithësisht leksikun e shqipes, në këtë rast është polemizuar fuqishëm për praninë e elementit etnik sllav në Shqipëri, përkatësisht hapësirën etnike dhe etnografike shqiptare. Pikërisht te prania, respektivisht ruajtja e trajtave të vjetra dhe arkaike të shqipes në disa mikrotoponime të atij vendi apo të asaj krahine etnografike i kanë bërë të mendojnë studiuesit në etninë shqiptare të asaj zone, që për

shkaqe të caktuara historike është ndryshuar gjatë shekujve, dhe ka marrë trajtën sllave (serbe, bullgare apo maqedone), greke apo latine-italane. Studiuesi ynë Mustafa Ibrahim, ka radhitur një numer shemujsh, si: *Vorret e Alldançes, Guri i Bogom"llës, Lisi i Bogomayllës, Oudha e Bellushjnës, Mali i Bellushçnës, Oudha për n'Berat, Korja e Buçinit, Qafa e Dollgovecit, Kullosa e Grazhdanit, Shullani i Jakrenovës, Ke Oura e Kostinces, Sllloqt me te Koshines, Gropat e Kurshovës, Dushku i Zhitoshes, Tumba e Bashinecit, Mali i Gabrovnjkut, Prroj i Ftosjnës, Ke Signalli i Kirividit* etj, të cilat më parë se sa strukturën gjuhësore arkaike të vendbanimeve të kësaj zone, dëshmojnë për ndërlidhjen historike të tyre dhe të banorëve të tyre.

Në jetën materiale të banorëve të kësaj zone bujqësia dhe blegtoria historikisht ka paraqitur një pasuri të rëndësishme, prandaj është e kuptueshme pse trajtat e tyre kuptimore dhe gjuhësore autori i ka sistemuar në një plan më të gjerë. Në këtë rrjedhë, mikrotoponiminë me bazë jetën blegtorale autori e ka parë duke u mbështetur në emërtimin e sipërfaqeve bujqësore, objekteve blegtorale, ushqimin e kafshëve, bagëtinë dhe kafshët e tjera shtëpiake, pajisjen dhe objektet blegtorale, prodhimet blegtorale, sëmundjet dhe paraqitjet e tjera lidhur me bagëtinë etj., si: *Livadhet e Thata, Livadhet t'Reja, Livadhet t'Vjetra, Ledinka e Rrasave, Kullosat e Nezes, Kullosat ke Voret e Vjetra, Ke Mullarët, Shterpat e Epërme* etj., ndërsa mikrotoponiminë e lidhur me jetën bujqësore, e ka sintetizuar brenda temave: sipërfaqet bujqësore, objekte bujqësore etj, emrat që

lidhen me objekte bujqësore, prodhime dhe kultura të ndryshme bujqësore, puna me objekte dhe mjete bujqësore (*Ara ke Rrasat, Arët e Bales, Fousha e Lopve, Fousha e Gjan, Ke Kopshtinjët, Korçat e Trasha etj.*). Nuk e di a është e rëndësishme të thuhet se pikërisht mikrotoponimia e ngulitur e kësaj sfere të hershme dhe të përhershme, si: *Guri i Mullinit, Katër Mullit, Mulljini i Amdi Nurës, Mulljini i Kamer Taukes, Oudha e Borinës, Oudha e Ftojave, Oudha e Gurishtës, Oudha ke Lisi i Madh, Oudha e Progonit, Udha Kalas, Udha Kaurrit, Udha Manastirishtes, Oudha e Lugës etj.*, dëshmon për jetën sedentare dhe autoktone të kësaj popullate.

Brenda këtij kapitulli dhe madje brenda këtij vëllimi paraqitja e etnonimeve paraqet një temë dhe një pasuri më vete. E gjithë pasuria etnonimike është parë në dritën e strukturës përmbajtësore dhe gjuhësore të patronimeve familjare, nofkave dhe hipokoristikëve, emrave personalë (emra njerëzish), emrave mashkullorë myslimanë, emrave femërorë myslimanë, emrave mashkullorë të krishterë emrave femëror krishterë, emrave familjarë etj. Në këtë rrjedhë mund të thuhet se shumë prej etnonimeve dhe patronimeve e antroponimeve të prejardhjes myslimane apo të krishterë kanë karakter edhe historik (të identifikueshëm gjerësisht edhe në dokumente të hershme: defterë e krisobula), prandaj prania e tyre në këtë vëllim shpreh edhe njëherë pasurinë tonë materiale e shpirtërore të shprehur edhe përmes emrave familjar. I këtij krahu historik janë edhe mikrotoponimet e klasifikuara në grupin e traditës kulturore. Shembujt e kësaj natyre nuk janë

të paktë. Ata dëshmojnë për pamjen gjeografike të terrenit, prejardhjen historike, etnike, kulturore, fetare e gjuhësore të popullatës së saj (*Te Kumblla M'buti, Katunishta, Kodra Katunit, Oudha e Mallës Poshtë, Lama e Xha Musajt, Ke Shpja e Barth, Vendi në Mes Katounit, Ke Xhenemi i Grave, Kish e Vjetër, Kisha Madhe, Villashka Çërkva, Ke Manastirishtja, Udha e Voreve, Voret e Katundit, Voret e Shqiptarve, Kallxherica*) etj.

Njohës i mirë dhe i specializuar i të folmes së Pollogut, studiuesi Mustafa Ibrahim, ju ka bërë një vështrim të gjithanshëm edhe përbërësve fonetikë dhe morfologjikë të mikrotoponimisë së Pollogut. Në monografinë e tij ai ka veçuar: sistemin zanor, redaktimin e zanoreve, sistemin e bashkëtingëlloreve, grupet e bashkëtingëlloreve, fenomenet fonetike etj., duke dhënë edhe shembujt konkretë për të gjitha rastet. Po në këtë kapitull autori ka trajtuar disa nga veçoritë e strukturës morfologjike: mikrotoponimet njëgjymtyrëshe, mikrotoponimet pa ndajshtesa, mikrotoponime të krijuara nga emrat (nga emra të përveçëm, nga emra bimore dhe shtazorë), mikrotoponime të krijuara nga mbiemra, mikrotoponime të krijuara nga folje etj. Mikrotoponimia e kësaj ane na del mjaftë e pasur edhe me kompozita dygjymtyrëshe dhe shumë-gjymtyrëshe: (emër + emër, emër + mbiemër), si dhe me mikrotoponime të formuara me togfjalësha: emër + emër personal, emër familjar ose nofkë; emër dygjymtyrësh sipas lumit; konfiguracioni i vendit + kafshë; bimë + pjesë e ligjëratës; burim + emër i një cilësie; forma toponomastike në formë fjalish etj.

Sikur ndodh përgjithësisht në të gjitha botimet e këtij lloji, në kapitullin e fundit autori ka sjellë pasqyrën e shtresës leksikore të toponimeve, dal nga sistemimi i tyre sipas ndikimeve gjuhëve fqinje. Pasi që në shumë raste etimologjinë, përkatësisht strukturën e prejardhjes gjuhësore të toponimeve e ka diskutuar brenda kapitujve të tjerë, në këtë kapitull autori ka nxjerrë gjithë inventarin e bazës apelative gjuhësore të mikrotoponimisë së zonës së Pollogut. Fjala është për ato mikrotoponime, në bazën e të cilave gjendet një fjalë e shqipes apo një fjalë e huazuar, sado përvoja e gjertanishme e studimeve etimologjike ka dëshmuar disa herë se prejardhja apelative e një mikrotoponimi, apo edhe prejardhja etimologjike e një njësie bazë (leksikore) nuk nënkupton njëkohësisht edhe trashëgiminë gjuhësore e aq më pak etnike të tij, as etimologjinë e huaj gjuhësore të rrjedhojave të asaj fjale. Mbështetur në këto parime, autori ka konstatuar mikrotoponimet e huazuara me bazë apelative greke, sllave, turke, arumune, fjalësin ndërkombëtar dhe atë më bazë fjalësin e shqipes.

Mbështetur në numrin më të madh apo edhe të vetëm të një njësie mikrotoponimike, si dhe në arritjet e gjertanishme të dijes shqiptare në studimet gjuhësore-historike dhe etimologjike, studiuesi ynë Ibrahim ka ardhur në përfundim se disa nga mikrotoponimet e kësaj ane kanë bazë apelative nga greqishtja (*kalluxher, manastir, livada, qeramidhe, drom*); sllavishtja (*breg, dromak, gllava, goll, gradishte, zagor, megje, poljak*); turqishtja (*bash, jeshil, tepe, çeshma, bunar, çiflig, gjoll, istikamë, kadi,*

kapi, mëhallë, padar, pazar); arumunishtja (*kukull, kolibë, Straga*); leksiku ndërkombëtar (*rakida, proso, kanal, zhiravë, konop, signal, tunel*); por numri më i madh i tyre ka bazë në njësinë leksikore të shqipes (*bjeshkë, brymë, çukë, gurë, karpë, kepi, kodër, majë-a, lugu, mal-i, qafë, rrafshinë, rrahu, rrasa, shpat, shpellë, shul, shulla* etj).

Sigurisht bazat e tilla apelative nuk janë gjithnjë as të drejtpërdrejta as të padiskutueshme, por në rastin e këtij vëllimi dhe të kësaj zone, rëndësia e përcaktimit të tyre lidhet edhe me dijen e gjertashme të albanologjisë në përgjithësi dhe të etimologjisë e të onomastikës në veçanti. Kjo ka të bëjë në mënyrë të veçantë me shtrirjen hapësinore të njërive leksikore, prandaj edhe mikrotoponimike të fondit të tyre, e cila njëkohësisht përcakton edhe përmasën e tyre në strukturën anësore apo të brendshme të gjeografisë gjuhësore të shqipes.

Prej mikrotoponimisë së pasur dhe të vendosur këtu në mënyrë sintetike nuk është vështirë të shihet një element fundamental i saj: homogjeniteti gjithëkombëtar i saj. Ata që kanë lexuar toponiminë e Shqipërisë së sotme, Kosovës, Malit të Zi, Çamërisë dhe madje të arbëreshëve të Italisë, nuk e kanë vështirë të shohin edhe këtu shtratin historik e etnik të saj, nënshtresën mesjetare dhe antike (ilire) shqiptare, si dhe elementet mbishtresore të gjuhëve ballkanike (greke, bullgare e serbe), orientale (turke) e oksidentale (latine) në strukturën gjuhësore e semantike të saj. Është pothuajse e pamundur të lexosh korpusin onomastik të cilësdo prej krahinave

etnografike historike apo të sotme shqiptare dhe të mos gjesh struktura gjuhësore (leksikore, morfologjike dhe madje sintaksore e frazeologjike) dhe semantike të onomastikës së vendbanimeve të Pollogut. Struktura të tilla që në vetvete paraqesin njësi etnokulturore dhe gjuhësore gjithëkombëtare paraqesin afërsi kontekstesh historike, gjeografike, fizike etj., në një mënyrë apo një tjetër mund të gjenden edhe në hapësirën tjetër shqiptare, në trajtën: *Ara e Toskës/Ara e Gegës, Lethja/Lejthishta, Ligata/Ligatina: Gropa e Shitit/Gropa Çikes, Çuka/Suka, Kodra e Topit/Kodra e Topave, Mullari/ Mullari, Tumba e Bashinecit/Tuma, Vllahu/Te Vllahu; Ujti i Barth/Ujt e Zi; Livadhi i Sulit/Livadhi Gjakut; Vija/Jazi; Proj i Fellë/Prroni Thellë, Mulljini i Parë/I Pari Prru, Mulljini i Dytë/I Dyti Prru, Mulljini i Tretë/ i Treti Prru, Oudha e Kuqe/ Udha e Zezë, Oudha e Lethjs/Udha e Shkozës, Oudha e Qiraxhive/Udha e Pazarxhive, Oudha e Vra Muratit/ Tek u Vra Ahmeti; Guri i Merizit/Guri Unazes, Peshterja e Kaçakve/Shpella e Kaçakve; Ke Lisi i Shitit/Te Lisi Shytit, Ke Mollët e Koshit/Te Bregu i Koshit; Ke Shkolia/Te Shkolla, Ke Ujti i Qielbët/Te Ujt e Trubullt, Ke Vllahu/Te Maxhupi, Manastirishçe/ Munishtiri etj.*

Le të jetë kjo edhe një prej arsyeve pse vepra e Mustafa Ibrahimit, *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të Prilepit, Krushevës dhe Velesit* në kohën tonë paraqet interesa të shumëfishta: gjuhësore, shkencore edhe kombëtare. E para, se qëllimi i tij parësor është botimi i një vepreje me të gjitha referencat e dijes së sotme shkencore, e dyta, botimi i saj dhe ndikimi që mund të ketë në rrjedhat tona

shkencore; dhe e treta, shqiptarët ende vazhdojnë të përballen me pasojat e gabimeve të brendshme historike në ndërtimin e identitetit kombëtar në gjithë hapësirën etnike. Prandaj botimi i këtij vëllimi me një material të pasur të gjeografisë etnohistorike anësore të hapësirës etnike shqiptare, në këto rrethana merr edhe karakter të rëndësishëm kombëtar.

Prishtinë, dhjetor, 2010

FITONIMIA DHE ZONIMIA E DUSHKAJËS

Skënder Hoxha, "Fitonimia dhe zoonimia e Dushkajës", Art poetika, Pejë, 2010.

Në hartën e vogël të Republikës së Kosovës mund të gjenden shumë krahina etnografike të vogla apo më të mëdha, për të cilat nuk mjafton një jetë njeriu për të gjurmuar pasuritë materiale e shpirtërore të vendit dhe të banorëve të tyre. A është kjo arsyeja pse, kërkimet në këto zona, të njohura para se gjithash si krahina etnografike, historike, gjuhësore dhe folklorike e etnologjike, janë gjurmuar prej fqinjëve tanë, shumë dekada apo vjet para se të na okuponin; madje që nga fundi i shekullit XIX e fillimi i shekullit XX, deri në fund të shekullit XX, kur u kurorëzua lufta jonë çlirimtare, e përkrahur edhe nga demokracia e përbotshme.

Prej pasurisë së tyre të njohur a të panjohur deri më tash, sot mund të kuptojmë se për studimet shteruese të tyre nuk mjafton as vetëm një jetë

studiuesi, as vetëm një jetë institucioni dhe as vetëm një jetë brezi. A është prandaj, kjo arsyeja pse studiuesit sot i lakmojnë kolegët e tyre që bëjnë hulumtime, kërkime, vlerësime dhe sinteza për eposin e krahinës së Rugovës, për trashëgiminë historike të krahinës së Drenicës, për pasurinë e fitonimisë dhe zoonimisë së Maleve të Sharrit, për sintaksën e krahinës së Gallapit, e të tjera e të tjera.

A është kjo arsyeja pse e lakmojmë studiuesin Skënder R. Hoxha, veprën e të cilit po e përurojmë sot. A është kjo arsyeja pse studiuesin e kësaj vepreje e vendosim në rrugën e dobishme të asaj lagjeje, që me përkushtim e ka vjelë dhe e ka inventarizuar një pasuri të madhe e të papërsëritshme të botës materiale e shpirtërore. Në të vërtetë me hulumtimin e krahinave etnografike shqiptare janë marrë edhe studiues të tjerë para studiuesit S. Hoxha, por natyra e këtyre kërkimeve jo rrallëherë është kushtëzuar prej orientimeve historike dhe politike të shteteve të caktuara, prej pengesave që teknokracitë qeveritare të kohës bënin në hulumtuesit dhe studiuesit e kësaj lënde. Kjo është arsyeja pse Rugova e Mark Krasniqit e Zymer Nezirit dhe e Gërkoviqit nuk është as e hulumtuar as e vlerësuar në përmasa të njëjta; pse toponimia e politizuar e Kosovës e Atanasije Urosheviqit nuk është e atyre përmasave në të cilën ngrihet toponimia

diakronike e Kosovës e Skënder Gashit etj. Ky ishte edhe synimi i studiuësve shqiptarë (Idriz Ajetit, Mark Krasniqit, Zymer Nezirit, Skënder Gashit etj.), që përmbysjen e koncepteve të paraardhësve të tyre (Jovan Cvijiqit, Atanasije Urosheviqit, Kosovka Ristiçiqit etj.) e kishin qëllim primar.

Kur hulumtuesi ynë, autor i veprës që po e përurojmë, filloi kërkimet në krahinën etnografike të Dushkajës, po këtë qëllim kishte: ta inventarizonte gjithë pasurinë gjuhësore të krahinës së Dushkajës, ta studionte atë dhe ta sistemonte në tërësinë e studimeve onomastike shqiptare. Në ndërdijen e tij, padyshim, si edhe te të gjithë bashkëkohësit e tij, kjo iniciativë ishte përgjigje Atanasie Urosheviqit dhe shkollës serbe të Jovan Cvijiqit gjatë gjithë shekullit XX. Sigurisht kjo është arsyeja pse kërkimet e tij do të bëhen rrënjësore, të thella, të shumanshme dhe shumështrësore. Dhe kjo do të jetë arsyeja pse kërkimet e tij në fushë të onomastikës nuk do të përfundojnë as me një studim për konferencën shkencore, as me një monografi të karakterit etnogjuhësor dhe as vetëm me një vepër të karakterit deskriptiv.

Vepra “Fitonimia dhe zoonimia e Dushkajës” përveç *Parathënies* dhe një *Hyrjeje* të shkurtër,

fillimisht është ndarë në dy tërësi të mëdha: *I. Fitonimet dhe II. Zoonimet.*

Pjesa e parë, *Fitonimet* zë vëllimin më të madh të kërkimit e tij dhe sigurisht edhe pasurinë më të madhe të kësaj krahine. E kuptueshme. Një krahinë etnografike, banorët e së cilës jetojnë shekuj me radhë nga bujqësia, është e kuptueshme që referencat e tyre të përditshme edhe për orientim, t'i kenë emërtuar me emrat e bimëve, luleve, prodhimeve bujqësore dhe sidomos pemëve, që në njëfarë mënyre paraqesin shenjat 'e paluajtshme' orientuese në natyrë. Në të vërtetë edhe brenda tyre do të mund të sintetizoheshin tipat e ndërtimit të këtyre mikrotoponimeve, me të cilat do të përcaktoheshin edhe vlerat e të jetuarit të popullsisë sedentare shekuj me radhë.

Nëse mikrotoponimet *Livadhet e Atavave, Kodra e Amanit, Fusha e Dredhëzave apo Roga e Dredhëzave, Mali i Firajave, Grahoda* etj., paraqesin pasurinë e brendshme natyrore të kësaj krahine, mikrotoponimet *Lugjet e Amanit, Prroni Laknave, Brija e Pasul's*, dëshmon për mënyrën e jetesës së banorëve të kësaj ane.

Një tipologji krejt e përgjithshme do të na jepte sisteme të ndryshme fitonimesh: gjuhësore, historike, etnografike, trajta dialektore, sociale, shumëgjuhë-

sore etj. Një numër i madh mikrotoponimesh të ndërtuara mbi një bazë të gjerë të fjalësit fitonimik, si: bostanishtë, grah, kashtë (Kashjak), lakën, linithtë, Maravç, qepë (Llukac), oriz, pasulë, rasatë, sanë, spirrak, shavar, thekën, ahishtë, arrë, bli, bojli, dardhë, dud, dushk, fiq, glli, frashër, krekcë, kshtajë, kumull, lajthi, lis, mllakë, murriz, plep, qarr, qurrshi, rrush, vneshtë, shelnik, shkumëz, shkozë, shtog, thanë, ferrë, therrë, verr, vidh, vjosë etj., dëshmojnë të kaluarën historike të kësaj zone, të jetës rurale të banorëve të saj, të mënyrës së akceptimit të tyre në kohë të ndryshme dhe simbolikën që merrnin ato, të mënyrës së shqiptimit dialektor të tyre, të ndikimit periferik të leksikut sllav në raste tepër të veçanta etj.

Po kështu bën të thuhet edhe për pjesën e dytë të këtij libri: *zoonimia*. Ndonëse nuk shquhet për pasurinë lëndore që kjo krahinë ka në fushë të fitonimisë, apo për pasurinë që kanë, bie fjala krahina e Rugovës dhe masivi gjeografik i Maleve të Sharrit, ajo megjithatë ka një pasuri të prekshme dhe me interes për shtrirjen dhe homogjenitetin e kësaj lënde në studimet onomastike përgjithësisht. Mikrotoponimet zoonimike: *Gryka e Aryshës, Fërkema Atit, Ledina e Lugit Blet's, Udha Dhëne, Arat e Rexhë Dhisë, Kroni Gucit, Kodra Rras's Gjarpive, Gryk's Gjeraqin's* etj., dëshmojnë për tipare etnoghjësore dhe historike të jetës së banorëve të kësaj krahine, të

cilat dikur i kishte, por sot, për shkaqe historike, etnopsikologjike dhe kulturore, nuk i ka, por ja i ka ruajtur përmes gjurmëve të zoonimisë. Janë disa qindra zoonime të cilat marrin mbështetje në fjalësin zoonimik të shqipësisë, si: arushë, at-i, bec, bletë, dhen, dhi, guc, gjarpër, gjeraqinë, hut, kajushë, kalë, karvan (i deleve), kie, lepur, lopë, maçok, maz, pulë, pupëz, sokol, shotë, tarak, thi, vath, vjedull, zog etj., dhe dëshmojnë për pasurinë materiale, mendore e kuptimore të banorëve të kësaj krahine.

Pa dashur të merrem me sisteme etnolinguistike dhe historiko gjuhësore, të fitonimeve dhe zoonimeve të krahinës së Dushkajës, të pazakonshme në paraqitjet publike të këtyre veprave, dua të theksoj vetëm faktin se të gjitha njësitë, nuk janë paraqitur thjesht si një inventarizim leksikor, ashtu sikur ndodh në shumë nga botimet e kësaj fushe, as thjesht vetëm si një inventar leksikor me shënime përgjithësuese dhe përshkruese, por secila veç e veç janë paraqitur edhe me referenca historikisht të njohura në gjuhësinë shqiptare, të cilat së bashku dëshmojnë përkushtimin e autorit që këtë vepër ta sistemojë dhe t'i jap vlera shkencore.

Dua të theksoj në fund të kësaj fjale përmbledhëse se vepra “Fitonimia dhe zoonimia e Dushkajës” është botimi i parë i këtij lloji dhe i vetmi

tash për tash në studimet onomastike në shkallë monografie, në ndërkohë që vendet dhe popujt e tjerë këto korpuse tashmë i kanë botuar në formate dhe në përmasa të tjera shkencore të avancuara. Sigurisht kjo dëshmon më së miri përkushtimin dhe synimin e autorit të saj, që veprën e tij ta çojë përpara edhe me kërkime të reja, të cilat nuk do ta pasurojnë vetëm bibliografinë e tij, por edhe bibliografinë e gjuhësisë shqiptare.

Prishtinë, 3. 3. 2011



BAZA EPIKE E LETËRSISË SHQIPE DHE LIRIZMI I VONUAR I SAJ

Letërsia shqipe ashtu si edhe historia e popullit shqiptar janë të ndërlidhura e të ndërthurura shumëfish e pashkëputshëm me ngjarje historike. Prej “Historisë së Skënderbeut” të Marin Barletit e deri në ditët tona, letërsia shqipe vazhdon të merret me ngjarje të mëdha dhe me heronj të situatave të ndryshme. Mbase duke trashëguar *paradigmën heroike* të eposit të saj, për të mos thënë trashëgiminë homerike të saj, letërsia shqipe është marrë, më parë se sa me ngjarjet, me heronjtë dhe epokat si tërësi. Nuk është e rastit që të gjitha ngjarjet dhe situatat historike të periudhës ilire në letërsinë shqipe janë përqendruar te Mbretëresha Teutë, të gjitha ngjarjet dhe betejat kundër pushtimit të Perandorisë Osmane te emri dhe veprat e Skënderbeut, të gjitha ngjarjet dhe atmosfera e shteteve të para autonome shqiptare në fillim të

shekullit XVIII te figura komplekse e Ali Pashë Tepelenës. Kështu ka ndodhur madje edhe për ngjarje dhe personalitete të shekullit XX (epokën e shpalljes së Pavarësisë, Luftën e Dytë Botërore dhe kështu pothuajse po ndodh edhe me Luftën e fundit të Kosovës), ku në të gjitha ngjarjet dhe situatat reflekton figura emblematike e komandantit kur heroik, kur tragjik, kur politik, e kur madje thjesht emocional, Adem Jashari.

Pavarësisht se në të gjitha periudhat janë shkruar më shumë se një gjini dhe një lloj letrar, veprat epike vazhdojnë të dominojnë nga fillimi e deri më sot. Po t'i referohemi letërsisë së periudhës së humanizmit do të gjeni veprën historike-epike të Marin Barletit "Historia e Skënderbeut"; po t'i referoheni periudhës së letërsisë biblike do të ndeshemi me poezitë me temë mitike nga legjendat e Hasit të Bogdanit "Sibilat"; po t'i referoheni letërsisë së periudhës së romantizmit shqiptar do të shohim se krijuesi më i madh i kësaj periudhe më parë se sa me lirikat e tij të veprës "Lulet e verës", përfaqësohet me poemën epike "Istori e Skënderbeut", e kur e kur me poemthin gjithashtu epik "Bagëti e Bujqësia"; po te lexohet krijimtaria letrare e letërsisë së periudhës prej romantizmit e deri te realizmi, kur pasuria gjinore dhe e llojeve letrare në gjysmën e parë të shekullit XX është shumë e theksuar, veprat më të mira

shquhen ato me bazë eposin shqiptar apo natyrën folklorike dhe madje folklorizante të saj. Shikoni se si veprat me patos epik të periudhës së romantizmit edhe në gjysmën e parë të shekullit XX, kur në parim janë tejkaluar paradigmat romantike, në krye të veprave më të mira të letërsisë shqipe shquhet vepra epike e Gjergj Fishtës “Lahuta Malcis”, vepra folklorizante e Andon Zako Çajupit “Baba Tomori”, veprat me temë epike dhe folklorike të Mitrush Kutelit, Ernest Koliqit, ndërkohë që vihej në pyetje lirika e Lasgush Poradecit dhe heshtej poezia lirike e Asdrenit. Nuk dua ta kaloj faktin se në këtë periudhë është shkruar dhe botuar edhe proza, e veçanërisht romani, i cili nuk është liruar prej bazës historiciste, dhe kur e kur ka marrë elemente sentimentale, e cila nuk ia ka shtuar në asnjë mënyrë frymën lirike të saj, pavarësisht se ndryshe nga periudhat e tjera, lirika e kësaj periudhe mund të thuhet se ka shënuar prirjen më të lartë të saj.

Po kështu mund të thuhet edhe për periudhën e fundit, e kjo do të thotë për gjysmën e dytë të shekullit XX, kur përjetimit krijues shumë herë historicist, i është shtuar edhe përjetimi krijues ideologjik dhe folklorizant. Prej vlerësimeve historiko-letrare të letërsisë së kësaj kohe, mund të thuhet se kjo është periudha më e pasur e gjinive dhe llojeve letrare në letrat shqipe. Por kjo nuk na jep të drejtë të

themi se kulmet e saj sipas vlerësimeve të kritikës letrare i shënon lirika. Pra, mund të thuhet se bëhet po ai gabim që ishte bërë dekada me radhë në gjysmën e parë të shekullit XX. Në kohën kur shkruhej kulmi i lirikës së shqipes me Asdrenin, Lasgushin, Nolin, Migjenin e të tjerë, shkrimtarë kombëtarë shpalleshin shkrimtarët e vonuar të romantizmit shqiptar Gjergj Fishta, Ernest Koliqi etj! Dhe bëhej kjo për arsye më parë jashtëletrare se sa estetike.

Kjo ndërkaq mund të thuhet jo vetëm për konceptet e kritikës letrare por edhe për prirjen e krijuesve të periudhës së dytë. Në krijimtarinë letrare në Shqipëri ku mbizotëronte koncepti ideologjik dhe madje folklorizant, jo vetëm proza po edhe poezia gjithnjë e më shumë krijohej mbi bazën epike të letërsisë popullore. E kam fjalën kryesisht për ato vepra, të cilat brezi i kësaj kohe i ka vlerësuar përfaqësuese të saj: poemën “Nënë Shqipëri” të Dritëro Agollit, “Shqiponjat fluturojnë lart” të Ismail Kadaresë, poezitë e Azem Shkrelit, Din Mehmetit e të Ali Podrimjes e të tjera krijime. Po kështu mund të thuhet edhe për dramën, e cila përtej poezisë merr karakter krejtësisht shoqëror, ideologjik, folklorizant dhe historicist: “Cuca e maleve”, e Loni Papës, “Toka e jonë” e Kolë Jakovës, “Trimi i mirë me shokë shumë” e Sylejman Pitarkës e kështu me radhë.

Çka të thuhet pastaj për romanin e këtij shekulli, mendimi kritik për të cilin që më parë e ka konsideruar me statutin e veprës epike, për shkak se brenda saj ke kërkuar të trajtohet hapësira, koha dhe universi si *një botë në botë* (Eko). Pavarësisht nga kjo, proza shqipe, në të vërtetë romani, nuk e ka parë me përparësi shtresën lirike të tij, e të mos flasim për përbërësin e lirizmit, si një vlerë qendrore të tij.

Letërsisë shqipe, ndërkaq i mungon gjerësisht ana joepike, përkatësisht herodotiste e saj. I mungon në kuptimin e gjerë të fjalës si përvojë a periudhë historike, por jo edhe si vlerë, përkundrazi. Përballë Skënderbeut të Barletit qëndron vepra e Beçikemit, përballë poezive përkushtuese të Budit qëndrojnë poezitë sado pak etno-lirike të Bogdanit; përballë eposit të Jeronim de Radës, qëndrojnë lirikat e Serembes; përballë eposeve të Naim Frashërit qëndrojnë po lirikat e tij; përballë eposit të Fishtës qëndrojnë poezitë e Lasgush Poradecit e kështu me radhë.

Prej saj, më parë se sa referencat heroike të këtyre periudhave do të mund t'i njihnim në histori dhe t'i shijonim estetikisht zhvillimet materiale dhe shpirtërore: sociale, ekonomike, etnohistorike të ilirëve, përkatësisht arbërorëve apo shqiptarëve të këtyre periudhave. Prej temave dhe qasjeve në këto

periudha, ngjarje dhe situata etnike dhe historike do të mundë të mësonim më shumë për tkurrjen historike të paraardhësve tanë gjatë antikitetit të vonë, për sulmet sllave gjatë mesjetës, për dramën e madhe të pushtimeve osmane dhe shpërnguljeve përtejdetit, për shpërnguljen e madhe nga Sanxhaku i Nishit dhe dramën e madhe të kalimit në Turqi, për shpërnguljet masive në gjysmën e parë të shekullit XX dhe për trenat e shpërnguljes së shqiptarëve nga Kosova në fund të shekullit XX.

Kam menduar se sado romani do të ketë bërë hapa më cilësorë në këtë drejtim, sado shtresa lirike e tij nuk e shtron doemos edhe të veçantën për përmasën e domosdoshme estetike të tij. As proza e kësaj kohe nuk është liruar prej prirjeve mitologjike, etnografike, folkloristike dhe madje historiciste të trajtimit të temave, duke nisur këtu nga personazhi e deri te ambienti. As veprat e shumta të realizmit socialist, si “Shembja e idhujve” e Skënder Drinit¹²⁰,

¹²⁰ **Lulja:** Floku i saj hahej për bukuri me diellin. Kush ishte më i artë? Syri i saj hahej me lumin. Kush ishte më i kaltër? Dhëmbët e saj haheshin për bardhësi me gurëzit e lumit që i ka shpërlarë ujët e borës. Kurumi i saj përzihej me hijet e lisave të drejtë dhe ishte vështirë ta ndaje nga ato. Zëri i saj u ngjallte lakmi zanave dhe shtojzovalleve. (221). S. Drini, “*Shembja e idhujve*”.

as ato romane, që sipas mendimit të kritikës letrare sadopak e kanë tejkaluar përqendrimin e saj brenda këtyre koncepteve si “Lumi i vdekur”¹²¹ dhe “Lulja e kripës”¹²² të Jakov Xoxës; asnjëri prej romaneve më

Martini: Veshur me tirq. Thembrat e tij ishin të mëdha të veshura me opinga lope...(24) Ku gufonin muskujt e fuqishëm të pulpave në belin e hollë që gati e këpuste në dysh. Veçse caliku fshihte një pjesë të asaj shpine të gjerë, supet, shpatullat e fuqishme ishin krejt të lira dhe tregonin një gjallëri të pazakontë. Ndërrimi i thembrave bëhej me aq rregull dhe përpikmëri (25). Një mendje fëmije në një trup vigani...“ Kështu mendoj udhëtari (26). Po malësori nuk kishte vetëm mendje fëmije, po edhe fytyrë të tillë (27). Në ata sy të kaltër e të thellë tani më nuk dukej as tmerr, as frikë nga e panjohura (27). Nga Kalca. Sa mbaj mend brez pas brezi... Martin më quajnë, Martin Kaloshi (27).Tani opingat me lëkurë lope sikur shfrynin me tërbim pas tokës, fërkoeshin rënd, si çeliku në gurë stralli (29). Dhe ai alamet Martini, që e kishte frikë edhe ariu në pyll, vërtitej si flutur, shkelte lehtë në truallin e kthinës dhe përpiqej të zbatonte urdhëratë sa më shpejtë (32). Tani ishte bërë burrë, i kishte dal mjekra... *S. Drini* , “*Shembja e idhujve*“, 1974:107.

¹²¹ **Vita:** Vajzë myzeqare, e ndershme dhe me moral të fortë; e bukur; sy të zi; këmbë të gjata; fustan të grisur... *Jakov Xoxa*, “*Lumi i vdekur*”: 54.

Adili: Djalë kosovar me një plis në kokë që i jepte nder; veshur me tirq; vrullshëm; trim; me bukuri të një djali të kujdesshëm...*Po aty*

¹²² **Gruaja e Mallkimit:** Shtëpia e Gruas së Mallkimit ndodhej hequr me një anë nga fshati peshkatar (40) E ndara

ishte shumë e pastër dhe çdo gjë në vendin e vet. Gruaja qe veshur me një fustan portokalli, të gjatë e pala-pala, i cili derdhej gjer te kockat e këmbeve të zbathura (40). Ishte e veshur kokë e këmbë në të zeza dhe mbante në dorë stapin e vet të trashë që e detyronte krruljen e të merrte trajtën e një gruaje kurrizdale. Nga goja e saj, si nga gryka e një mitralozi vazhdonin të dilnin mallkime të fuqishme, drejtuar Arhondit të madh të Naforës (42). Gruaja kishte një trup të gjatë e të ajthëm, si gjithë naforiotet. Ajo ishte e prirë pakëz përpara si hënë që mezi ndihet. Edhe në këtë qëndrim ajo nuk dilte jashtë rregullsisë se grave naforiotë që thyheshin se vogëli mbi gratë tërbunjeshin nëpër ullishta dhe qe nuk kishte ç'tu bënte me baritja drejt mbi Bulevardin e Ujit e të Dashurisë që të mos u binin shtambat nga koka (135). Fytyra e gruas ishte e bardhë si karta dhe nga thinja e flokëve ajo dukej edhe me e bardhë. Përjashta me diell ajo nuk dilte dhe lëkura i kishte marrë ngjyrën e ullinjve të papjekur mirë, të regjur me thinje. Vetëm sytë i kishte shumë të zinj e shumë të gjallë, si ullinjtë e papjekur në degë. Ata të shihnin së thelli, si nga thelloma e detit, e qetë përjashta dhe e vrudullushme përbrenda nga rrymat nënujësë (136). Gruaja kishte rënë në gjumë të thellë. Fytyra e saj, e bardhë dhe pa asnjë relief, si rudhe varri, qetësohej nën hijen hirit të bardhë të nusërisë varur te kryet e shtratit, një të zgjatur dore. Buzët e thara nga lodhja e mallkimeve te vazhdueshme ngjiteshin e hiqeshin vazhdimisht nga frymëmarrja dhe dukej sikur shpërthenin andej pa pushim urime. Vetëm herë pas herë trembej në gjumë dhe fërkonte duart, duke i quar larte dhe duke i hapur përpara syve të mbyllur. Pastaj i ulte menjëherë dhe rrehej t'i fshihte poshtë çarçafi, siç bënte kur qe zgjuar dhe i fuste nën përparësë (146). Vijat e fytyrës se saj kishin harruar qysh kur të buzëqeshnin, ajo nuk qeshte as në gjumë (150). *Jakov Xoxa, "Lulja e kripës", 1983: 150.*

të mira të Kadaresë, i shquar për lirizmin e pranishëm brenda tij “Kronikë në gurë”, dhe romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”¹²³, madje as romanet që kritika i ka konsideruar për përbërësit e shquar modern dhe madje postmodern si “Vdekja më vjen prej syve të tillë”¹²⁴ e Rexhep Qosjes apo “Oh” i Anton Pashkut,

¹²³ **Stalla e viçave të kooperativës:** Ndihej era e këndshme e barit të thatë. (57) *Ismail Kadare* “Gjenerali i Ushtrisë së vdekur”, *Botimi i katërt-Prishtinë, 1980.*

Nik Martini: Malësor i panjohur, i thjeshtë (163); Doli dhe luftoi i vetëm në katër pika të ndryshme, gjersa u lodh dhe u këput. Vdiq. Nuk ka varr as shenjë as kryq. Vetëm një këngë ka për të.(165); *Ismail Kadare* “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, *Prishtinë, 1980.*

Plaka Nicë: Fytyrë thatime, të verdhë me sy te çakërritur plot me lot, trup fare të vogël, të imët (210); Ishte plakë e shushatur, mbetur qyqe se në luftë batalioni i kolonelit Z. i kishte varur të shoqin dhe pastaj koloneli Z. i mori vajzën e saj në çadrën e tij dhe vajza ishte katërmbëdhjetë vjeçe u mbyt në pus pa arritur akoma në shtëpi. *Ismail Kadare* “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, *Prishtinë, 1980: 212.*

¹²⁴ **Trashja:** Trashja kishte rreth dyzet vjet por, kush e di, mund të kishte më shumë apo më pak: budallenjve s’mund t’u caktohet saktësisht mosha vetëm prej pamjes së jashtme për shkak se ata, shpesh, mund të duken më të rinj ose më të shtyrë në moshë se ç’janë në të vërtetë. Emri që kishte u përgjigjej jashtëzakonisht mirë vijave të jashtme aq sa edhe cilësive të saj shpirtërore: ishte e trashë, *si thesi i mbushur miell*; i kishte këmbët *si shtylla e Teqes së Madhe*; i kishte llërët *më të trashë se qafa e buallicës së Makës*; i kishte vithet

e gjëra, *si të mushkës së Ramizit të Nurës*; i kishte cicat e mëdha *si të lopës së Canit të Kastratit*. Pjesët e trupit të saj, megjithëse për ne atëherë të zmadhuara pa masë, tani më duket se kishin njëfarë harmonie të çuditshme, që dëshmonin se në rini kishte qenë shumë e pashme. Trashja e fëmijërisë sime kishte një palë buzë të trasha e të plasaritura, në pjesën më të madhe të kohës të mavijosura që, kur bënte vapë, mbuloheshin prej një shtrese shkrumbi që rridhte vazhdimisht si një lumë i vogël jargësh të verdha dhe i shpërndahej mjekrës dhe qafës vija-vija bojëkafe. (22); Ajo na i paskësh kofshët si dëbora të bardha dhe si dardha të forta; ajo na i paskësh gjinjët e plotë, të njomë, si molla e pjekur; ajo na i paskësh buzët e ëmbla si sheqeri i Shkodrës; ajo na e paskësh barkun e ardhur si fletët e pjeprit; ajo na qenkësh e nxehtë si furra e Hajros së Boshnjakut. Dhe, ç' ishte kryesorja ajo dinte të sillej e të mbështillej, duke bërë oh, oh, oh si ta kishte kaluar rininë në ndonjërin prej atyre haremeve turke dhe arabe, ku gratë e mësojnë njëra tjetrën, në çastet e kotësisë, se si të jenë më tërheqëse për sultanin, apo sheikun e tyre të çmuar.(19); Trashja, vërtet, lahej shumë rrallë, zakonisht kur nuk ishte e zënë me ndonjë punë që ishte e detyruar ta bënte, por kur vendoste t'u hynte këtyre telasheve në lumin e afërm, atëherë lahej me një kujdes të zhuganëve. Me një të pastruar ajo hiqte shkrumbin, jargët, zdralin që ia kishte pllakosur lëkurën dhe gjithë këtë pisllek e hiqte me rrënjë dhe për disa muaj të ardhshëm. Lahej me sapun të teshave kur i zbutej zemra dikujt t'ia falte, por, herëve më të shpeshta, me hi të qarrit, që ia tëhollonte lëkurën si maza e qepës. Flokët e saj të zbehta, të kripura me pluhur, fije të sanës, kashtë, lesh, baltë, tani shkëlqenin si pendlat e korbit. Edhe ngjyra e fytyrës i ndryshonte: më parë e zezë si jevge, tani bëhej e kuqe në të bardhë. (24); (...). Prej pamjes së saj rrezatonte njëfarë pafajësie që i stolis vetëm fëmijët dhe ajo, hëpërhë, dukej më e re se

ç'ishte në të vërtetë. (24); Trashja kishte lindur ugruzezë, se njeriut, shpesh, me çastin e lindjes i fillojnë të bardhat ose të zezat e jetës. Ishte bijë e një familjeje të madhe, agallarësh, të lodhur prej madhësisë së vet. Kishte tre vëllezër, katër motra, dy xhaxhallarë, dy teze dhe tri halla. I ati i kishte vdekur kur kishte qenë e re, vajzë trembëdhjetëvjeçare, por shtëpia akoma thirrej sipas emrit të tij, meqë kishte qenë një prej njerëzve të shquar të Vajazanit. E ëma, Nafia, ndërkaq, i kishte vdekur tre vjet pas të atit, duke e lënë në kujdesin e të vëllezërve, meqë të motrat iu kishin martuar me kohë. Trashja kishte mbetur ashtu në shtëpinë prindore, si virgjëreshë, mbasi askush s'kishte ardhur ta kërkonte për shkak të shenjave të sëmundjes, që iu kishte shfaqur që në vegjëli. Me vdekjen e prindërve, sëmundja e Trashes ishte keqësuar më tepër, por askujt prej burrave të shtëpisë nuk i kishte shkuar mendja që ta dërgonte te mjeku, megjithëse i kishin thirrur hoxhallarët që t'i shkruanin hajmali apo edhe t'i frynin. Nuk e kishin mjekuar, ndoshta, pse besonin se kurrfarë mjeku nuk do t'i ndihmonte, ndoshta pse në atë kohë edhe nuk kishte ndonjë mjek të mirë, që dinte diçka për sëmundjet e tilla të njerëzve që në pamje duken të shëndoshë si topi e, ndoshta, gjë që mund të ishte më e vërtetë, pse u dhimbseshin të hollat që do të shpenzoheshin rreth saj në ato vite kur ishte qesat i madh. Fqinjët thoshin se ata nuk ishin aspak të interesuar të shërohej teveqelja e trashë, që i kishte turpëruar dikur me barkun e saj të fryrë, por që ishin të interesuar ta përcillnin sa më parë në atë jetën tjetër. Është për të besuar se për këtë shkak ia kishin shtuar zullumin Trashes. (24); Trashja hante vetëm dhe nuk përbënte farë softe të tretë, së cilës do të duhej shërbyer si dy të tjerave. Vetëm kur kishte fasule apo lakra pa mish, edhe Trashes i çohet si edhe të tjerëve, sado në enë dhe me lugë të tjera. Thuaja, gati gjithmonë, për bajram e ramazan, për natë të

madhe e synetllëk, asaj ia mbushnin një kalenicë, të gjetur diku skaj mureve të avllisë, me lëng të verdhë që do ta digjte edhe gurin e thatë, nëpër të cilin notonin disa grimca të rralla djathi. Sot, besoj, se për këtë shkak Trashja ishte gjithnjë e etshme, pinte ujë kudo haste dhe ndalej të pshurte më shpesh se pleqtë e lodhur, që kalonin nëpër meranë e Mulla Jusufit. / Edhe pse për lëkurën e saj shpenzohej më së paku, Trashja bënte disa punë, të detyruara, që s'i bënte askush tjetër, mashkull apo grua, në atë shtëpi. Ajo, në të vërtetë, edhe nuk bënte punë grash se, thoshin, *nuk di lopa të punojë ç'punojnë gratë.* / Trashen e shihnim shpesh duke çuar drithë në mulli dhe barra e saj ishte më e madhe se e Arifit të Hamallit, që ishte i fortë si demat e Aqifit të Kasapit. Ia mbushnin një thes të dhirtë me gjashtëdhjetë-shtatëdhjetë kilogram grurë, apo më shpesh, misër, ia shtrëngonin grykën mirë e mirë me një lak liri, ia vinin në shpinë duke ia lidhur me një konop në atë mënyrë që do të mund ta zgjidhte vetëm mullisi kur të mbërrinte, ose ndokush tjetër po t'i ndodhte të rrëzohej diku rrugës, çka nuk i ngjante shpesh, ndonëse i kishte ngjarë ndonjëherë. Kështu, një të shtunë korriku e kishin ngarkuar më tepër se zakonisht duke ia vënë, siç kishte konstatuar kandari i mullisit, tetëdhjetë e dy kilogram dhe e kishin nisur në pikë të zhegut kur të tjerët nuk duronin lehtë as nën hije. Trashja kishte mbërritur deri afër livadhit të Mulla Jusufit dhe, kur kishte provuar ta kalonte kapërcyellin, ishte rrëzuar me thesin përmbi. / Trashja gati gjithmonë kishte ndonjë plagë apo vurratë tjetër të keqe, të freskët, në trup: herë farë fshikëze në ballë, herë farë vregne në këmbë, herë njërën buzë të ënjtur e herë njërin sy të mavijosur. Kur kalonte Trashja nëpër meranë e qytetit, dhe i dalloheshin njollat e gazepit në trup (...) (26); Kur i qemë afruar vendit të kundërmimit patëm vërejtur se mbi një kodër të vockël dheu, që kishte trajtën e varrit, ishte një kufomë e kalbur, rreth së cilës bënë rojë sorrat,

nuk i kanë përjashtuar shtresat mitologjike dhe historike të fatit të popullit shqiptar, sado si i pari ashtu edhe i dyti, brenda tyre kanë shtresa të pasura të përpunimit të tyre estetik dhe përmasa të fuqishme të elementeve lirike në ndërtimin e temave, motiveve dhe personazheve të tyre.

Pa dashur të merremi me analizën e tyre, dua që në këtë ese hyrëse të sjell vetëm shembujt e disa prej veprave më të realizuara të romanit shqiptar, në prizmin e ndërtimit të përmbajtjes dhe pamjes epike të personazheve të tyre, pa hy ne detaje dhe njëkohësisht të paralajmëroj faktin se këtë gjendje tashmë e ka tejkaluar proza e Fatos Kongolit dhe sidomos romani univers, por jo edhe epik i letërsisë shqipes, “Bijtë e askujt” i Rexhep Qosjes.

që ishin ngritur në qiell teksa na kishin diktuar. Ishte kufoma e Trashes. *Rexhep Qosja*, “*Vdekja më vjen prej syve të tillë*”, Rilindja,, Prishtinë, 1974: 32.

POEZIA: PËRMASA, SHENJA DHE KUFIJ ONOMASTIKË

Ideja që dua të reflektoj këtu fillon me fëmijërinë time të hershme, kur më parë se sa të lexoja prozën apo poezinë lirike, dëgjoja vargjet epike të babait, në të cilat kishte shumë heronj mitesh e legjendash, por më duket më shumë heronj historikë. Derisa me heronjtë sikur isha mësuar, gjatë këtyre dëgjimeve më shumë më bënë përshtypje vendet: toponimet dhe ojkonimet e tyre.

Përbërësit e parë ishin krahina, krajli, lugje, bjeshkë zanash, lëndina, ishin vende ku fshiheshin, luftonin apo vdisnin heronjtë e këngëve të babait dhe në vetvete shprehnin botën e pakapshme të narratorit popullor, kufijtë sa të afërt po kaq të largët të tyre etj., ndërsa përbërësit e dytë të këtyre këngëve, si: Miskovin (Moskva), Bagdadin, Berlinin, Stamollën (Stambolli) etj., i identifikoj në librat e historisë, vit pas viti.

Cilët ishin këta heronj, këto vende dhe këto hapësira në këngët e babait dhe si janë reflektuar ato në kontekstin historiko-letrar?

Kam zgjedhur t'i përgjigjem kësaj pyetje në këtë takim planetar të krijuesve, jo pse përgjigje të tilla nuk meritojnë, bie fjala, historianët, gjeografët dhe madje astronomët, po pse mendoj që kufijtë e krijimtarisë letrare më parë se sa të parëve (historianëve, gjeografëve e astronomëve) ju dedikohen krijuesve (poetëve) edhe atë në tri përmasa: a) mitike, b) historike; dhe 3) shpirtërore.

Le t'i referohemi vetëm një tipologjie përgjithësuese të tyre në poezinë shqipe: Kufijtë e poezisë legjendare janë kufij mitologjikë dhe historikë:

a. nga *Lugjet e Verdha te Përtejdeti, Bagdadi* dhe madje *Miskova*;

b. kufijtë historikë të poezisë së shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX janë *Stamolla, Berlini, Roma* etj., ndërsa kufijtë e poezisë së Rilindjes Kombëtare, përkatësisht letërsisë së romantizmit shkojnë nga kufijtë toponimikë në kufijtë historikë dhe referencat e tyre: *pellazgët* (të identifikuar kryesisht me mitet e njohura, si mite greko-romake), *Iliria* (e identifikuar me personalitetin

e *Teutës*); *mesjeta* (si Periudhë e Skënderbeut) etj.; dhe

c. poezia e shekullit XX, e cila shkon nga kufijtë e identitetit historik-identitar te kufijtë shpirtërorë të krijuesit.

Le t'iu referohemi në këtë rrjedhë disa prej shembujve më përfaqësues të saj.

a. Rapsodi i eposit shqiptar e konsideronte shkuarjen e heroit të tij, *Mujës* në *Moskë*, si një “zbritje” nga *Bjeshka* në një qytet të zakonshëm: “E me zort *Muja* gjogun ai u ka marrë (...) Kenka ra tu krajli i *Miskovit*, / rrash me tok' kullat ia ka ba, (...)/ Shum e mallin me vedi si e ka marrë”. (Z. Neziri, 2001: 145).

b. Poeti dhe ideologu i shquar i gjysmës së parë të shekullit XX, Fan Noli në poezinë revolucionare të tij “Anës lumenjve”, duket se i perceptonte dy kufij të idealeve të tij revolucionare, njërin kombëtar e tjetrin planetar. Në një version të poezisë së tij kishte vargjet: “Zgjuhuni dhe bjeruni / katundarë dhe punëtorë / që nga *Shkodra* gjer në *Vlorë*”, ndërsa historianët e letërsisë thonë se në një version tjetër të saj përcaktonte kufij të tjerë të zhvillimit të revolucioneve proletare: “që nga *Moska* gjer në *Vlorë*”.

c. Poeti emblematic i poezisë shqipe Lasgush Poradeci, idealet e tij atdhetare i rindërtonte duke përcaktuar hapësirën gjeografike dhe ridimensionuar kufijtë e saj kështu:

“Duke nisur udhëtimin mes-për-mes nër Shqipërinë

Drini plak e i përmallshëm po mburon prej Shënd-Naumi”,

ndërsa poeti Dritëro Agolli, te poema epike “Nënë Shqipëri”, i vendos kufijtë shënjuës të tij

“Që nga Bistrica e gjer te Valbona” (1980:63).

d. Tradita popullore gjithashtu ka krijuar referencën shënjuëse të orientimit proeuropian të popullit shqiptar në prag të Kongresit të Berlinit, me vargjet:

“O Abdyl shite pasurinë

shko në Berlinë

shpëto Shqipërinë”.

e. Përcaktimit të kufijve referues të tij nuk ka arritur t’iu ikën as liriku i shquar i brezit të tij, Fatos Arapi, i cili në poemën për krahinën etnografike të tij, Drashovicën, kufijtë e saj i mbindërton në këtë formë:

“Ja toka ime e ashpra e buta / një krisme pushke pastaj lahuta”.

Do të doja që kufijtë gjeografikë të shkrimtarëve dhe bardëve popullorë t'i bashkoj me kufijtë mitikë të Homerit dhe Dante Aligerit për “shtatë palë qiej” e “shtatë rathë të ferrit”, dhe me mallkimin e urimin popullor të shqiptarëve “për shtatë pash nën tokë” e “për këta shtatë palë qiej”, bashkë me një varg të poetit Ali Podrimja, *Mora rrugën të takoj njeri*, si një varg i dhembjes së pafundme njerëzore, që nuk përcakton kufijtë gjeografikë e historikë, dhe i cili këtu na e mundëson kalimin nga poezia epike me kufij historikë e gjeografikë, te poezia lirike e kufijve shpirtërorë.

Një kalim kërkues nga kufijtë historikë a gjeografikë të poezisë epike në kufijtë shpirtërorë të poezisë lirike, në këto raste nuk do të ishte shqetësues për lirikën, për të mos thënë ‘kohë e keqe për lirikën’ (Brehti) sikur koha nëpër të cilën po kalojmë të më kishte dhënë të drejtë. Shoqata e shkrimtarëve Pegasi, me anëtarësi ndërkontinentale i ka dhënë detyrë vetes ta sfidojë këtë botë e ta bëjë të lumtur me poezinë, në të vërtetë me poezinë lirike, ndërkohë që sot letërsia si vlerë e popullarizuar mezi po mbahet ende nga përfaqësuesi i saj më me ndikim: romani, sepse në plan të parë ka zënë vend eseja dhe trajtesa politike-filozofike e shoqërisë së hapur dhe e globalizmit.

A do të mundë të mbijetojë lirika në kohën e fërkimeve të mëdha kulturore, gjuhësore dhe identitare, madje në një kohë të tranzicionit global, kur popujt e vegjël po kushtëzohen që të rrinë edhe me shpinë nga historia?

A do të mundë të mbijetojë lirika, në të vërtetë, a ka kuptim lirika pas Srebrenicës dhe Kosovës, në një kohë që trashëgiminë tonë të shekullit XX, vetëm romani do të mundë ta trajtonte në kompleksitetin e tij, ndërsa edhe ai po e humb fuqinë e tij dhe po ia zë vendin eseja, trajtesa filozofike dhe madje kujtimet e memoaret?

A do të kenë hapësirë shkrimtarët që në çerdhen e identifikuar me emrin e Pegasit të fluturojnë në hapësirën e lirë, nëse ajo sot po mbulohet me satelitë përgjues për aq sa mbulohej dje me aeroplanë luftarakë?

A do të mundë t'i vije muza e Ankreontit shkrimtarit të sotëm, të lodhur prej trandjeve shoqërore në të cilën tashmë ka hyrë shoqëria njerëzore e shekullit XXI? A do të mundë të çlirohet shpirtërisht prej kujtimeve që ka trashëguar dhe filozofisë me të cilën po përpiqen ta ndërtojnë mirëqenien e tij?

Poeti i shekullit XXI do të sfidohet më në fund edhe me rrezikun e humbjes së gjuhës, prandaj që tash, sikur po krijohet përshtypja se poezitë, përkatësisht lirikat e baladat e tyre, do të jenë reliktet e fundit të gjuhëve të tyre.

E di se do të thoni se ky është një parashikim shumë i errët për poetët, aq më tepër lirikët si ju, që jeni mbledhur për ta veçuar atë, lajmësin më të fuqishëm të planetit.

E di se nuk do të jeni të gatshëm të pranoni ballafaqimin me një parashikim të tillë, derisa gjenden ende poetë që propozohen apo marrin Çmimin Nobel. E megjithatë, do të thosha nuk janë poetët (përkatësisht lirikët) ata që sot bëjnë ndikim në ndryshimin e kësaj bote. Sikur ka kaluar koha e Brehtit, Lorkës, Jeseninit, fjala dhe vepra lirike e të cilëve ka ndikuar në ndryshimin e botëve, në një kohë kur sundonte dora e hekurt e nacizmit dhe stalinizmit, sado poezia e Brehtit, Lorkës apo Jeseninit edhe sot nuk ka humbur asgjë nga vlera e saj estetike.

Le të na e mbajë prandaj besimin kjo e dyta. Le të na mbajë të qëndrueshëm në rrugëtimin tonë, përkatësisht fluturimin tonë planetar, guximi i tyre qytetar dhe sidomos vlera estetike e krijimtarisë së tyre, pavarësisht ndikimit letrar që mund ta ushtrojmë ne sot.

Kufijtë e krijimtarisë sonë, në të vërtetë, kufijtë e lirikës sonë nuk janë as gjeografikë as historikë. Ata janë kufij shpirtërorë të botës sonë pa kufij, pa revolucione dhe pa referenca kulturi.

Ndoshta dikush do të thoshte se propagandojmë lirikën e shoqërisë së hapur, në të vërtetë të globalizmit.

Jo!

Për poetin kufijtë e lirikës së tij janë kufij që lindin dhe përfundojnë në shpirtin e tij: lirik. Nëse fluturimi i tij ndodh në hapësirë, kjo ndodh jo pse fluturojnë mendimet e tij, po pse fluturon vetë poeti, një arsye e plotë për t'u identifikuar me Pegasin.

Prishtinë, prill, 2012

POEZIA SI PËRJETIM HISTORIK DHE ESTETIK

*(Rreth dy vëllimeve me poezi të Sabile Keçmezit –
Bashës)*

Në vend të hyrjes

Çështja e parë me të cilën jam ndeshur kur kam vendosur të shkruaj një paraqitje për poezinë e Sabile Keçmezit – Bashës, ka qenë shumësia e saj në jetën tonë kulturore. Në kafën e mëngjesit, tek po u flisja kolegëve për paraqitjen që do t'i bëja poezisë së saj, më ka rastisur t'i dëgjoj jo më pak se tri njohje të angazhimit intelektual, krijues e profesional të saj: brezi më i vjetër e kujton poeten që formohej në fushë të dijes politologjike, brenda historisë, e kjo do të thotë se konceptet politike i shikonte me sytë e historianes; një brez më i ri, e identifikonte me krijuesen që merret paralelisht me studime historike të periudhës së re dhe me poezi, mbase si reagim kundër pamjes së zyrtë të historisë sonë; ndërsa një brez tashmë më i ri më fliste për poeten, e cila 'duket se merret dhe e njeh edhe historinë' shumë mirë, sepse më parë sesa me kujtesën historike, të cilën e

reflekon në krijimtarisë letrare, merret me dokumentin, si dëshmi e përhershme e historisë. Parametra të tillë vlerësimi sigurisht nuk e thonë, e aq më pak e reflektojnë, gjithë përmasën hulumtuese, vlerësuese dhe përcaktuese të biografisë së saj, e megjithatë përmbajnë elemente të cilat duhet nderuar në jetën tonë kulturore dhe shkencore.

Biografia letrare

Sot është vështirë t'ia përcaktosh vendin z.Sabile Keçmezi-Basha më shumë si krijuese apo studiuese në rrethet shkencore dhe kulturore, dhe ky nuk është qëllimi ynë, në një kohë që vepra e saj shkruhet, botohet e vlerësohet paralelisht, pavarësisht nga njëra apo tjetra fushë.

E, megjithatë, që në fillim dua të identifikoj pikërisht këtë rrjedhë. Profesoresha e historisë Dr. Sabile Keçmezi-Basha fillimet e saj krijuese i bëri në një kohë krijimi të karrierës dhe jetës së saj familjare. Ndoshta kjo është arsyeja pse veprat e saj fillestare poetike janë më intime, familjare, sociale, duke filluar me krijimet letrare të poezisë për fëmijë, e kjo do të thotë se fillimisht qëndronte larg prirjes për të parë botën me sytë e intelektuales dhe aq më pak të historianes. Fillimisht temat e krijimtarisë letrare të saj ishin të ndërlidhura përgjithësisht me temat jetësore, si dhe të përshkruara me elemente etnografike, të cilat shpalosen që në titujt e ballinave të veprave të saj: *Nusja e gurtë* (poezi), "Rilindja" 1989 dhe *Dy lule ka mami* (poezi), "Pionieri" 1993; për të përmbysur e errësuar idilën e saj jetësore, që vinte si rezultat i prishjes së imazhit për botën që e rrethonte, me

titullin e vëllimit poetik *Kohë epileptike* (poezi), “Jeta e Re” 1996. Në këtë mënyrë krijuesja e ëndrrave fëmijërore dhe rinore, bëhet bartëse e paradigmave të temave të mëdha shoqërore dhe pse jo edhe kombëtare, me poezitë e vëllimit *Ëndrrat e trishta* (poezi), “Rilindja” 2000, me romanin *Nata pa kornizë*, LSHK 2008 dhe me dramën *Hadi*, një vepër fundamentale e reflektimit të dhunës në Kosovë dhe përjetimit të saj si univers historik. Në këtë rrjedhë, bota e saj krijuese e shtrirë brenda shprehësisë unike të krijeses do të stabilizohet vetëm me botimet e viteve të fundit: *Malli për Itakën* (poezi), LSHK 2008, *Kodi i pritjes* (poezi), LSHK, Prishtinë 2010, *Metaforë iberike*, (poezi), LSHK, 2011 dhe me vëllimin poetik *Kujtesën e ka kapur skleroza* (poezi), LSHK, 2011, dy prej të cilave po i paraqesim këtu, jo për të vlerësuar gjithë përjetimin dhe transponimin estetik të poetes, tashmë të shpërfaqur përtej krijimtarisë letrare të brezit të saj, po edhe për të përudhur e saktësuar referencat më të reja të poetikës së poezisë së saj.

Kujtesa, etnografia dhe historia

Vëllimi me poezi *Kujtesën e ka kapur skleroza*, ndoshta më shumë se poezitë e vëllimeve të tjera, përmbledh ato preokupime jetësore, konceptuale, krijuese dhe estetike të periudhës së parë dhe të dytë të krijimtarisë së saj letrare, në të cilat aq dendur shpërfaqen kujtesa, etnografia, historia dhe bota shpirtërore, që janë njëkohësisht disa nga përbërësit më të pranishëm të poezisë së saj. Në këtë vëllim që më shumë se sa dialog është komunikim i brendshëm me kipsin e saj si subjekt dhe me

lexuesin njëkohësisht, bëhet biografia e kujtimeve të saj (e pasuruar me ornamente etnografike: *unaza* (Vizatoj unazën / në gishtin e djathtë, 10); *fustani i nusërisë* etj., dhe biografia e atdheut të saj, e pasuruar gjithashtu me shenja të gjeografisë e të historisë së tij:

- *Arbëria* (Në Arbëri këto ditë / Ka pasur shumë furtunë /Dhe ka rënë skrrotinë e keqe, 34);
- *Kosova* (Përtej Oqeanit / Më shkruante ATHDHEU/ (...) Nga Kosova, 69);
- *Çamëria* (Kipci i Bilal Xhaferrit/Nëpër zaje të përflakura/Do të udhëtojë për Çamëri, 16);
- *Kufiri* (Për çdo ditë të lume/ Ma luan kufirin, 8);
- *Molla e Kuqe*: (Kujtesën e ka kapur skleroza/ Dhe harruar ka sytë e Atdheut/ Te Molla e Kuqe, 7);
- *Rozafa* (Arkitektura e shpirtit përimitohej / e Rozafa më qante në prehër..., 7) etj).

Prej poetes, që në përditshmërinë e saj identifikohet me profesionin e historianes së historisë bashkëkohore, pjesë e së cilës ndonjëherë është bërë edhe vet, edhe nuk mund të pritej një mesazh tjetër. Vëllimin e përbëjnë ndarjet *Kujtesën e ka kapur skleroza*, *Udhët e atdheut*, *Emrat që mungojnë*, *Anatomia e pritjes*, *Mëkati pa mëkat* dhe *Atdheu më shkruan letra*.

Cikli i parë i poezive shtron problemin e zbehjes së kujtesës dhe ridimensionimin e saj në rrethana të caktuara, duke përfshirë këtu edhe brejtjen e kësaj ndërgjegje për tërësinë që tashmë kthehet në shenja

referuese për objekte, identitete, monumente gjeografike, kufij etnografikë, ndërlihdje historike etj. Ky komunikim me historinë, ngjarjet, kontekstet, si dhe ndërlihdjet me përvojën dhe situatat e sotme individuale dhe kolektive. Në ciklin e dytë tema bartet në situatën aktuale, por motivi i shikimit të saj mbi përvojën historike ruhet dendur. Tashmë nuk ridimensionohet historia, por rrethanat e reja që e përbëjnë, përkatësish e rindërtojnë historinë: uni, hapësira gjeografike, vendlindja e tkurrur brenda një rruge dhe një kafeneje, si referenca ndaj përgjegjësisë historike: *Veriu, Kroi i Vitakut, Prishtina, lagjja "Elita", kujtesa e babait* etj. Po këtë rrjedhë ka edhe cikli i tretë i poezive, veç se tani nuk identifikohen objektet, shenjat historike a gjeografike, por kryesisht situatat dhe përvoja vetjake apo rrethanat e brendshme: kujtesa për situata të përgjithshme, zhvillimet shoqërore dhe sidomos rivlerësimi për përvojën historike, për të mos thënë mungesa e shenjave dhe ndikimi i tyre në ndërdijen tonë.

Cikli *Anatomia e pritjes* sikur lidh përvojën e temave të cikleve të mëparshme dhe të ndonjë sugjerimi për temat që do të pasvijjnë në ciklet e mëpastajme *Mëkati pa mëkat* dhe *Atdheu më shkruan letra*, shoqëruar edhe me diskursin më emocional, për të mos thënë më lirik dhe më intim. Në ciklin e mëparshmëm historia bëhet strumbullar i identifikimit dhe i rrëfimit, ndërsa në ciklet në vazhdim historia e ruan statutin e shenjës, ndërsa intimitja dhe lirizmi deri në vetërrëfim përshkojnë gjithë zhvillimin e strukturës poetike të poezive. Poezitë e këtyre cikleve, si ato: *Desha të vij mbrëmë, Për pak ndodhi*

mosardhja apo *Eh, sa shumë besova*, qofshin veç e veç, qofshin si tërësi, plotësojnë mesazhet e poezive me karakter kryesisht reflektiv dhe refuzues për të kaluarën, apo poezive me prirje nostalgjike për veten dhe 'tjetrin'.

Si të tilla poezitë e këtij vëllimi përfaqësojnë një tërësi motivesh përmbajtësore, strukturash ndërtuese dhe përmasash kuptimore, jo vetëm të këtij vëllimi po edhe të atyre që ka shkruar më parë dhe madje edhe të atyre që do të botojë më vonë.

Dalja nga hapësira historike e etnikumit

Vëllimi i fundit me poezi *Metaforë iberike* hap horizontin kërkues në poezinë e shkrimtares Sabile Keçmezi-Basha. Nuk është fjala këtu vetëm për kërkimet motivuese apo temat e karakterit jasht-historik të etnisë. Nuk është fjala as për kërkimet e brendshme që dalin si pjesë e largimit nga përvoja kombëtare e temave historike, një temë kjo mjaft e pranishme në poezinë e saj, por për reflektimin e dy botëve, dy kulturave dhe transponimin e tyre nga njëra te tjetra dhe përballë njëra-tjetrës.

Vëllimin *Metaforë iberike* e përbëjnë ciklet: *Pse me pikëpyetje*, *Atdheu më shkruan letra*, *Metaforë iberike*, *Të kujtohet baba* dhe *Kujtesë e grisur*. Shikuar nga aspekti i kërkimit dhe sidomos i strukturimit të tekstit poetik edhe ky vëllim poezish është vazhdim i vëllimit të mëparshëm, qoftë me mënyrën se si i percepton situatat e çastit, qoftë me mënyrën se si i transponon rrethanat paralele.

Cikli i parë hapet me tema dhe situata që ndërlidhin marrëdhëniet e krijueses me përvojën historike dhe bashkëkohore - me Kosovën, përkatësisht me lirinë e saj si proces dhe si përgjegjësi e ndërdijshme jona ndaj saj. Dhe, si për të përmbushur përgjegjësinë ndaj saj, autorja ndërlidh largimin e saj nga Kosova në një ambient tjetër - Spanjë, përkatësisht Iberi, po kaq afrues, me disa poezi (*Kosova dhe Andora*, 12; *Kur të nisesh për udhë* 15) dhe me referenca të tjera etnohistorike e gjeografike (*Kuq e zi*, 16; *Në Katalonjë mbrëmë / çdo gjë ishte e kuqe*, 13), të cilat bartin tash jo vetëm kiptin e narratores, autores apo edhe të heronjve të saj, po edhe gjithë atdheun (*Në Andora / Atdheu im kishte ardhur para meje*, 12), për ta bërë të mundur vazhdimin e kërkimit të unit të saj, si të ishte brenda ambientit të Kosovës.

Pasi ka identifikuar disa nga shenjat bazike të njohura qoftë përmes historisë, qoftë përmes fushave të tjera të qytetërimit iberik, të cilat këtu, jo vetëm i ruajnë shenjat historike a simbolike, po disa herë marrin edhe karakter përfrues dhe ridimensionues, që autorja t'i kthehet edhe njëherë temës, të cilën e gjejmë edhe në vëllimin e parë: komunikimin me atdheun në distancë (*Atdheu më shkruan letra, Vetmi, Desha të vij mbrëmë*), një motiv ky përgjithësisht i munguar viteve të fundit, pavarësisht letërsisë shqipe të krijuar dendur në mërgim.

Cikli *Metaforë iberike* hap gjerësisht temën e kërkimit qytetar, intelektual, krijues dhe estetizues të botës iberike në poezinë e Sabile Keçmezi - Bashës.

Në letërsinë shqipe nuk mungojnë temat e mëdha apo të thella të fytyrës Lindore a Perëndimore (europiane a orientale), kryesisht në udhëpërshkrime të ndryshme (për *Arbëreshët e Italisë, Kinën, Lindjen e Afërt* etj.) apo vepra në fushë të prozës (romanet *Hasta la Vista, Koncert në fund të dimrit* etj), por zor të gjesh një vepër letrare, përkatësisht një vëllim me poezi, që ta ketë paraqitur me kaq përkushtim fytyrën qytetëruese dhe estetike të një vendi a të një popullit sikur është vëllimi *Metaforë iberike*.

Pamjen përkushtuese të temave dhe mesazheve të tyre në veprën poetike të Sabile Bashës e përcaktojnë që më parë poezitë: *Gernika, Në Barcelonë, La Rambla..., Andora, Kur të shkoni në Andorë* etj. Fillimisht ato sjellin mesazhin e kërkimit, kërkimit kryesisht deskriptiv të temës (*Mos më thuaj se ke bredhur nëpër botë/ Po që se nuk ke gjezdisur/ rrugëve të Barcelonës fosforeshente, 27*), që do të përshfaqet në gjithë librin nga udhëtimet e saj në Spanjë, për të hyrë më tej edhe në botën estetizante të përjetimit të këtij udhëtimi (*O zot, / Mos më fol për çmendurinë / Po që se nuk ke qeshur e qarë/ me Salvador Dalin/ duke pirë kafënë / në mëngjese të murrme, 27*).

Në këtë rrjedhë të poezisë së saj autorja ka sjellë jo vetëm ambientin iberik (një dysi historiko-estetike të tij), si një vend i veçantë i Europës Perëndimore, ku bashkohen fuqishëm tragjikja dhe liria, pasqyruar njëkohësisht edhe në situata të tilla apo të përiferata me ambientin e Kosovës dhe me botën shpirtërore e materiale të krijueses sonë.

Poezitë e këtij vëllimi janë përshkuar me shenja gjeografike e historike të hapësirës iberike, si dhe me simbole kombëtare, letrare e krijuese të këtij ambienti: Andora, Gernika, Barcelona, Pikaso, Salvador Dali, Van Gogu, Don Kishoti, Franko, Kosta Brava, Konti i Monte Kristos, Servantesi, Lorka etj, të cilave iu përgjigjen po kaq shenja referuese e identifikuese të atdheut dhe shenjave historike e etnike të krijeses:

- *Kosova* (Kosova e dyzuar qëndron / Në kornizën e Gernikës, 46);
- *Mic Sokoli* (... Stër-stër gjyshi im/ Kishte synuar ëndrrën e kuqe/ Në fushën bukanike / Në gjoksin e Mic Sokolit, 28);
- *Gjyshi* (Gjyshi im / Shumë kishte dashur / (...) Të ledhatonte Gernikën / Me fije bari, 29);
- *Adem Jashari* (Bisedova gjatë / Me Gernikën / Nëse kishte vend / Për të nxënë / Adem Jasharin, 31);
- *Onufri* (Dua ta takoj Onufrin / Më tha / Në kuqezi / Te Shegët mistike, 50);
- *Doruntina* (Kush të solli/ /Në Katalonën plakë / Doruntinë e lodhur ..., 57) etj.

Poezitë e këtij vëllimi do të mundë të shquheshin këtu edhe për dy arsye të tilla: e para, se kanë shënuar jo vetëm një përmasë shumë më të gjerë kërkimi të krijeses, të cilën e gjejmë më pak në vëllimet e mëparshme, për të mos thënë se ajo jo vetëm ka ruajtur temën e përhershme të kërkimeve të

gjertashme, por e ka shtrirë atë edhe në përmasa më të gjera universale; dhe e dyta, sepse autorja jonë ka arritur të ruajë me sukses një standard domosdo të përfillshëm të ndërtimit artistik të gjithë poezisë së saj brenda të gjitha cikleve. Këtë ndjesi e krijojmë qoftë edhe vetëm prej njëres prej poezive më të bukura të saj *Gernika*, në të cilën janë realizuar disa nga vargjet më emblematike të poezisë së saj.

Në vend të përfundimit

Dy vëllimet e fundit me poezi të shkrintares Sabile Keçmezi-Basha, *Kujtesën e ka kapur skleroza* (2011) dhe *Metaforë iberike* (2011) shënojnë një hap cilësor në krijimtarinë artistike të saj. Përmasa e këtij vlerësimi mbështetet në disa nga premiset e krijimtarisë së saj dhe të krijimtarisë artistike të poezisë së sotme shqipe përgjithësisht. Në radhë të parë poezia e saj e këtyre dy vëllimeve vazhdon temën dhe intencën e kërkimit, të cilën e ka filluar edhe në dy vëllimet e mëparshme, por tash me realizime shumë më të arrira artistike; ndërsa në radhë të dytë, tema si edhe ambienti i kërkimit zgjerohet jo vetëm në përmasa të gjeografisë kombëtare por edhe në përmasa të reflektimit me tema dhe raporte të tyre gjeografike universale. Kjo ka të bëjë edhe me shenjat përkatësisht simbolet e poezisë së kësaj vepre, të cilat shfaqen e ridimensionohen jo vetëm brenda kodit kombëtar të përjetimit të tyre, por edhe në përqasje me referencat e tyre historike, etnografike, gjeografike e gjuhësore të popujve të tjerë.

Me të gjitha këtë elemente, si dhe me përbërës të tjerë brenda saj, poezia e botuar së fundi e shkrimtares dhe historianes njëkohësisht, Sabile Keçmezi-Bashës, përvijon një arritje të re dhe një horizont të ri të pritjes nga lexuesi, gjithsesi.

Prishtinë, qershor 2011

Prof.asc.dr. Begzad BALIU

Onomastikë dhe identitet

Recensues

Prof. dr. Bahtijar Kryeziu

Shtëpia botuese *Era*, Prishtinë, 2012

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

811.18'373.2(048)

Baliu, Begzad

Onomastikë dhe identitet / Begzad, Baliu . - Prishtinë :
Era , 2012 - 242 f. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-04-071-6